

1 E hënë, 11 maj 2026

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit paraqiten përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 09.37

5 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Znj. Sekretare e seancës,
6 ju lutem paraqitni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2023-12, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni
10 Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit.

11 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ju lutem prezantoni kush
12 është i pranishëm në sallën e gjyqit, duke filluar me
13 Prokurorinë.

14 Z. HAFETZ: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës.
15 Unë jam Josh Hafetz. Së bashku me mua sot është Line Pederson,
16 Ella Palsenberg dhe një kolege tjetër.

17 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mbrojtja, sipas rendit të
18 aktakuzës.

19 Znj. Menegon.

20 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës.
21 Unë jam Sophie Menegon, së bashku me mua këtu është Megan
22 Hirst, Lirim Greicevsci, po ashtu Sacha Benheim-Laffont dhe
23 Axelle Schembri në fund.

24 Z. REES: [Përkthim] Përshëndetje. Unë jam Mbrojtësi i
25 Bashkim Smakajt. Së bashku me mua është Huw Bowden, Derrick

1 Gooden dhe Matilda Falchetta Hainsworth.

2 Z. EDWARDS: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës.

3 Unë jam Iain Eduards. Me mua sot është Alexandra Baer, Eva

4 Kalb dhe stazhieri i ri i yni, Alex Cumming.

5 Z. YOUNG: [Përkthim] Përshëndetje. Unë quhem David Young.

6 Unë përfaqësoj z. Fazliu, që na ndjek përmes videolidhjes. Unë

7 ndihmohem sot nga dy kolegë të tjerë.

8 Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Unë jam Alexander Admiraal, jam

9 Mbrojtja e z. Kuçi.

10 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit. Për

11 procesverbal, dëshiroj të them z. Thaçi na ndjek përmes

12 videolidhjes, sikurse na ndjekin përmes videolidhjes edhe z.

13 Smakaj dhe z. Kuçi.

14 Sa i takon z. Kuçi, dëshiroj që të theksoj kërkesën e

15 rishikuar të z. Kuçi për të ndjekur në distancë përmes

16 videolidhjes këtë seancë gjyqësore, të parashtruar më datën 6

17 maj 2026, mbi bazën e heqjes dorë të marrjes pjesë këtu në

18 sallën e gjyqit e cila është e përditësuar siç shprehet në

19 Shtojcën 1 të F9001, unë e miratoj këtë kërkesë të këtij të

20 akuzuari.

21 Ne jemi mbledhur sot për të dëgjuar dëshminë e

22 Dëshmitares DHT-03. Përpara se të vazhdojmë, dua të pyes znj.

23 Menegon. Znj. Menegon a ka ndonjë kundërshtim që t'i drejtohem

24 me emër dëshmitares?

25 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Jo, nuk ka kundërshtim.

1 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Dhe kjo dëshmitare është
2 Helen Fraser.

3 A jemi gati që të vazhdojmë?

4 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Po, jam gati që të vazhdojmë.
5 Megjithatë dëshiroj të them që kam dërguar një kërkesë për
6 nevojë për nxjerrje të dokumentacionit nga Prokuroria dhe
7 dëshiroj që të kërkoj që këto material të mund të nxirren
8 sipas rregullës 103 deri në përfundimin e pyetjes të
9 dëshmitares prej meje.

10 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Prokuror, ka ndonjë
11 përgjigje?

12 Z. HAFETZ: [Përkthim] Përderisa kam qenë në Gjykatë, në
13 sallën e gjyqit, nuk e kam parë kërkesën, tha znj. Menegon që
14 ka dërguar sot paradite, sot në mëngjes, domethënë, kërkesën.
15 Kështu që do ta lexoj dhe do t'i përgjigjem sot brenda ditës.

16 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull.

17 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Thjesht dëshiroj të them për
18 procesverbal, që kjo është një kërkesë e cila është dërguar në
19 mëngjes të dielën. Ndërkohë që kam dërguar një email tjetër
20 për të rifreskuar kujtesën e Prokurorit sot paradite. Dhe
21 kërkoj ndjesë, po thjesht doja ta sqaroja këtë gjë.

22 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull.

23 Tani dëshiroj të them që ekspertja ka kërkuar që të ketë
24 një kopje të raportit, një letër për të shkruar dhe diçka, një
25 stilolaps për të shkruar. Dua të di nëse ka ndonjë kundërshtim

1 nga palët lidhur me këtë gjë.

2 Z. HAFETZ: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

3 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mirë atëherë, do të

4 vazhdojmë në këtë mënyrë që ka kërkuar dëshmitarja.

5 Znj. Sekretare, ju lutem sillni dëshmitaren në sallë.

6 Ndërkohë që dëshmitarja sillet në sallë, a mund të

7 konfirmoj që nuk ka ndonjë objektiv nga ekipet e tjera të

8 Mbrojtjes për të bërë pyetje për dëshmitaren, synonit që të

9 bënit pyetje për dëshmitaren, apo jo?

10 Z. REES: [Përkthim] Jo, nuk synojmë ta bëjmë këtë gjë.

11 Z. EDWARDS: [Përkthim] As ne.

12 Z. YOUNG: [Përkthim] As ne.

13 Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Edhe ne konfirmojmë.

14 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

15 [Dëshmitarja hyn në sallën e gjyqit]

16 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mirëmëngjes, Profesoreshë

17 Fraser. Më dëgjoni apo jo?

18 DËSHMITARJA: [Përkthim] Po, ju dëgjoj.

19 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit që keni ardhur

20 për të dhënë dëshmi në sallën e gjyqit dhe mirë se keni

21 ardhur. Ju jeni thirrur si eksperte për të dëshmuar në

22 çështjen nga Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit dhe

23 të tjerëve. Ndërkohë do ju bëjmë pyetje nga Mbrojtësi i z.

24 Thaçi.

25 Dhe do ju kërkoja që t'i dëgjonit pyetjet plotësisht dhe

Dëshmitarja: Helen Fraser (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Menegon

Faqe 5

1 mundohuni t'i jepni përgjigje të drejtpërdrejta këtyre
2 pyetjeve. Po ashtu mundohuni që të bëni një pauzë midis
3 përfundimit të pyetjes dhe fillimit të përgjigjes sepse po
4 përkthehet gjithçka që thoni këtu, kështu që për këtë
5 arsyeshme që të bëni një pauzë për saktësinë e përkthimit.

6 Profesore Fraser, a e keni deklaratën solemne përpara? Do
7 ju kërkoja ta lexonit deklaratën solemne që keni përpara.

8 DËSHMITARJA: [Përkthim] E ndërgjegjshme për rëndësinë e
9 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj
10 solemnisht se do të bëj analizën e ekspertit sa më mirë të
11 jetë e mundur si dhe do të them konstatimet e mia plotësisht
12 dhe në mënyrë të saktë.

13 DËSHMITARJA: HELEN FRASER

14 [Dëshmitarja përgjigjet përmes përkthimit]

15 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, Profesore
16 Fraser. Tani ky betim është i detyrueshëm për ju dhe do doja
17 që t'ju kujtoja se tani pasi keni dhënë betimin është vepër
18 penale në qoftë se juve do jepni dëshmi të rreme përpara
19 Trupit Gjykues.

20 Znj. Menegon, vazhdoni me pyetje për dëshmitaren.

21 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit.

22 Pyetje nga Znj. Menegon:

23 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

24 PY. Dëshmitare, mirëmëngjes. Bashkë jemi takuar më herët.

25 PË. A është e mundur që të ngrihet pak zëri se nuk dëgjoj

Dëshmitarja: Helen Fraser (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Menegon

Faqe 6

1 mirë?

2 PY. Më dëgjoni mirë tani, Dëshmitare?

3 PË. Po, tani është në rregull.

4 PY. Ne jemi takuar dhe më përpara bashkë, megjithatë do

5 prezantohem dhe një herë. Unë quhem Sophie Menegon, jam

6 Mbrojtëse e Specializuar për Hashim Thaçin dhe sot do t'ju bëj

7 disa pyetje në emër të z. Thaçi.

8 Ju lutem na thoni se si quheni.

9 PË. Helen Fraser.

10 PY. Çfarë profesioni keni?

11 PË. Unë jam kërkuese në linguistikën forensike.

12 PY. A mund të na thoni se ku punoni aktualisht?

13 PË. Unë punoj në Universitetin e Melburnit në Australi.

14 PY. Sa kohë keni që punoni si eksperte në fushën e

15 transkripteve forensike?

16 PË. Përreth 25 vite, pak a shumë.

17 PY. Në rregull.

18 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Znj. Sekretare, do ju kërkoja që

19 të paraqisni në ekran dokumentin DHT12286-01239.

20 PY. A e keni shkruar ju këtë raport, Dëshmitare, që mban

21 datën 27 mars 2026?

22 PË. Po.

23 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Znj. Sekretare, dëshiroj që t'ju

24 kërkoj që të paraqisni në ekran faqen 1201308.

25 PY. A është shkrimi juaj ky, Dëshmitare?

Dëshmitarja: Helen Fraser (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Menegon

Faqe 7

1 PË. Po.

2 PY. A është e saktë përmbajtja në këtë pjesë të jetëshkrimit
3 tuaj

4 PË. Po.

5 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Znj. Sekretare, do ju lutesha të
6 paraqisni në ekran në të djathtë një dokument tjetër që
7 përfundon me 01284.

8 PY. Znj. Dëshmitare, a është kjo letra e udhëzimeve
9 mbështetur në të cilën keni shkruar raportin e 27 marsit 2026?

10 PË. Po.

11 PY. A ju kujtohet që ju janë dhënë disa dokumente së bashku
12 me këtë letër udhëzimi?

13 PË. Po, më kujtohet.

14 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Znj. Sekretare, do ju lutesha të
15 paraqisnit në ekran, në të djathtë të ekranit përsëri,
16 dokumentin 61, DHT12085-01208.

17 PY. Znj. Dëshmitare, a është kjo lista e dokumenteve që kemi
18 bashkëlidhur dhe jua e kemi dërguar dhe që ju keni marrë si
19 bazë për shkrimin e raportit tuaj?

20 PË. Po.

21 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Znj. Sekretare, paraqisni në
22 ekran, ju lutem, tani faqen 120883 në të majtë të ekranit.
23 Pra, është faqja që përfundon me 1288 në fund. Kjo është faqja
24 e raportit. Mendoj se është faqja 3. Ju lutem kaloni pak më
25 poshtë. Vazhdojmë me faqen tjetër. Mund të kaloni një faqe më

1 përpara?

2 PY. Dëshmitare, në raport thuhet që ka tre materiale dhe
3 thotë që:

4 "Ky raport lidhet me dokumentet e mëposhtme të cilat më
5 janë dhënë mua përmes postës elektronike nga Mbrojtja e Thaçit
6 në periudhën nga 31 janari 2015 deri më 18 mars 2026."

7 A është e saktë që dokumentet e para, tre dokumentet e
8 para ju janë dërguar në dhjetor të 2025-s, jo në janar të
9 2025-s?

10 PË. Po. Është një gabim shkrimi.

11 PY. Këto dokumente që janë në ekran a mendoni që janë çështje
12 që ne ju kemi dërguar që duhet që të mbështeteshit në raportin
13 tuaj?

14 PË. Po.

15 PY. A keni për të bërë ndonjë sqarim lidhur me këto
16 dokumente?

17 PË. Jo.

18 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Tani kërkojmë që dokumentet në
19 letrën e udhëzimit dhe dokumentet që janë bashkëlidhur kësaj
20 letre të pranohen në prova materiale dhe kërkojmë gjithashtu
21 që të gjitha këtyre dokumenteve t'ju jepet një numër prove
22 materiale.

23 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Prokuroria ka kundërshtim?

24 Z. HAFETZ: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim megjithatë
25 do të presim vendimin tuaj lidhur me pranimin.

1 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Këto dokumente do shënohen
2 për identifikim.

3 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Po edhe shtojca e dokumentit
4 udhëzues të shënohet për identifikim po ashtu.

5 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull. Të tri
6 dokumentet do shënohen për identifikim. Do marrin një numër
7 prove provizore.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
9 Gjykatës. Dokumenti i parë është raporti që ka numrin
10 DHT120186 deri në 101309. Ky dokument do të marrë numrin
11 provizor të provës 1D00136.

12 Dokumenti i dytë ishte letra e udhëzimeve, apo jo?

13 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Po. Letra e udhëzimeve, që është
14 DHT1201281 deri në 1284.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
16 numrin e provës 1D00137.

17 Po dokumenti tjetër cili ishte?

18 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Dokumenti tjetër është letra e
19 udhëzimeve që mban numrin DHT1201285-01285.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Dhe ky
21 dokument do të marrë numrin e provës 1D00138.

22 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Do them për procesverbal që
23 natyra e kushtëzuar e pranimi të këtyre dokumenteve i
24 nënshtrohet vendimit të mocionit të Mbrojtjes së Thaçit për
25 pranim të provave të DHT03 të 23 prillit 2026, që është

1 parashtimi F00876.

2 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
3 Gjykatës.

4 PY. Në faqet 3 të raportit, ju thoni që keni interes
5 kërkimor, pra, keni shfaqur interes kërkimor në fushën e
6 transkripteve forensike dhe se keni botuar artikuj, keni folur
7 si lektore në konferenca të shumta dhe që keni bërë shumë
8 raport ekspertësh.

9 A mund të na thuash diçka më tepër lidhur me këtë temë?

10 PË. Po. Unë kam filluar të kem interes lidhur me këtë temë
11 atëherë kur kam filluar të jap mësim lektore në fonetikë dhe
12 linguistikë dhe kur më kërkuan që të jepja prova eksperti sa i
13 takon transkriptit të versioneve në audio që ishin të
14 pashqeshme, në veçanti regjistrime të fshehura dhe për të
15 dhënë dëshmi në procese penale. Unë jam përfshirë në shumë
16 çështje ku kam qenë e shqetësuar që provat mund të ishin
17 përdorur në mënyrë të tillë që mbase mund të ishin çorientuese
18 për procesin. Dhe për këtë arsye më është zgjeruar kureshtja
19 dhe interesi im për këtë temë me kalimin e viteve.

20 PY. A mund të thoni se për çfarë lloj çështjesh gjyqësore
21 keni dhënë aktekspertiza si eksperte?

22 PË. Po. Këto janë përgjithësisht aktekspertiza në çështje
23 penale dhe veçanërisht ka qenë aktekspertiza në Australi.

24 PY. Dhe sa shpesh keni dhënë ju dëshmi si eksperte?

25 PË. Unë kam shkruar raporte për shumë vite, kam shkruar

1 raporte për pak a shumë një qind çështje gjyqësore. Unë jam
2 kërkuese në natyrë, nuk është se jam eksperte profesionale sa
3 i takon dhënies së dëshmive në Gjykatë, megjithatë kam dhënë
4 dëshmi të shumta në shumë herë për Gjykatën, por në natyrë, në
5 thelb jam kërkuese.

6 PY. Me aq sa dini ju, konstatimet janë marrë si bazë nga
7 Gjykata?

8 PË. Po.

9 PY. Me aq sa dini ju, a është marrë, domethënë, çfarë procesi
10 gjyqësor, çfarë paneli ka marrë parasysh aktekspertizën tuaj?

11 PË. Në Australi ne kemi juri gjykimi dhe, domethënë, Trupi
12 Gjykues është i përbërë prej jurive prej shumë personave.

13 PY. A ka ndonjë rast kur nuk është marrë parasysh
14 aktekspertiza juaj ose kur është rrëzuar ajo?

15 PË. Jo.

16 PY. Po sa i takon viteve të para ose të hershme të
17 ekspertizës tuaj, të fushës tuaj të ekspertizës?

18 PË. Në vitet e para të ekspertizës time, në përgjithësi ka
19 pasur probleme me linguistikën forensike. Jo, nuk ka qenë
20 problemi i imi personal, por e kam fjalën për sa i takon
21 linguistikës forensike që zakonisht nuk shikohej si një
22 disiplinë e ngushtë dhe specifike. Dhe shpesh herë ka qenë
23 qëndrimi që nuk duhej ndonjë juri e veçantë për linguistikën
24 forensike. Por situata ka ndryshuar. Sepse për shkak të
25 botimeve të shumta në fushën e linguistikës, të fonetikës,

1 tani në Australi ne e kemi si të përcaktuar mirë faktin që
2 linguistika forensike është pjesë e ngushtë ekspertize dhe
3 linguistët zakonisht e japin dëshminë përpara Gjykatës,
4 përpara trupave gjykuese.

5 PY. A njihet kjo në Australi apo në përgjithësi edhe në vende
6 të tjera në botë?

7 PË. Me aq sa di unë, po edhe në Australi edhe më gjerë në
8 botë.

9 PY. A jeni përfshirë si eksperte në çështje që përfshinin
10 dokumente voluminoze në audio dhe në video?

11 PË. Po.

12 PY. Faleminderit. Tani dëshiroj të bëj disa pyetje lidhur me
13 aspekte të caktuara të raportit tuaj që të na i sqaroni ato
14 dhe disa elementë të rëndësishëm të këtij raporti. Në faqen 6
15 të raportit, ju na shpjegoni se si ka pasur zhvillim të
16 provave forensike me kalimin e viteve dhe këtu citoj, është
17 që:

18 "Rasti klasik është që dëshmia e dëshmitarëve okularë
19 tani njihet si goxha më pak e mbështetshme sesa ka qenë
20 identifikuar më përpara."

21 Na e shpjegoni pak çfarë keni dashur të thoni,
22 Dëshmitare, lidhur me këtë?

23 PË. Po. Në seksionin e parë të raportit tim, unë flas lidhur
24 me sfondin e përgjithshëm të shkencës forensike në
25 përgjithësi, jo konkretisht për linguistikën forensike dhe jam

1 përpjekur që të përcaktoj sfondin ose të jap kontekstin më të
2 gjerë. Dhe ndërkohë me kalimin e viteve kemi zhvillim të kësaj
3 disipline të ngushtë dhe diçka ka qenë bazuar më përpara, ka
4 qenë marrë më seriozisht më përpara është që në qoftë se ti
5 shikon diçka, ti më vonë thua që, "Kam parë këtë" ose "atë"
6 dhe dëshmia juaj si dëshmitar okular është besuar më tepër.
7 Domethënë, se ne kemi një ide se si punon, se si funksionon
8 pjesa vizive. Domethënë, ideja është që ti shikon diçka, ti e
9 përpunon këtë panoramë vizive ose këta elementë vizivë,
10 domethënë, dhe ajo çfarë ti mendon që shikon është vërtetë ajo
11 çfarë ti e shikon, ky ka qenë zhvillimi i parë ose kjo ka qenë
12 situata vite më përpara.

13 Megjithatë, me kalimin e viteve, me përmirësimin e
14 hulumtimeve, është zbuluar që perceptimi vizual është shumë
15 herë më i komplikuar se ajo çfarë mund të na paraqitet në
16 pamje të parë dhe, ndërkohë, pavarësisht që dikush mund të
17 jetë i bindur që situata ka qenë X ajo çka ka parë me sytë e
18 vet, pavarësisht kësaj historia ka treguar që ka pasur shumë
19 vendime fajësie për shumë persona të cilët kanë shprehur
20 perceptimet e tyre vizuale. Domethënë, degët e ekspertizës
21 janë zhvilluar, janë evoluar dhe tani perceptimi viziv është
22 një çështje e thjeshtë dhe është një çështje e cila, në fakt,
23 ka marrë më tepër kompleksitet me kalimin e kohës.

24 PY. [Nuk ka përkthim].

25 PË. Po. Dëshmitarët okularë zakonisht merren në pyetje sipas

1 procedurave të caktuara, të veçanta që kanë për synim të
2 shmangin apo të zvogëlojnë mundësinë e gabimit.
3 PY. Faleminderit. Do të doja të flasim për natyrën, llojin e
4 të folurit dhe se si funksionon perceptimi i të folurit, pra,
5 njerëzor.

6 Në faqen 7 të raportit tuaj, ju shpjegoni dhe theksoni se
7 kjo shkon përtej, thjesht identifikimit dhe asocimit të
8 fonemave të caktuara.

9 Po mund ta shpjegoni këtë?

10 PË. Po. Fonetika është një tingull i të folurit dhe është i
11 ngjashëm me një shkronjë të alfabetit, pra, në një tekst të
12 shkruar. Kur dëgjojmë një fjalim kemi përshtypjen se gjuha e
13 folur është një sekuencë fonemash në të njëjtën mënyrë siç
14 është teksti i shkruar që është sekuenca e shkronjave. Çdo
15 shkronjë është e ndarë nga shkronjat e tjera dhe të njëjtat
16 shkronja mund të përsëriten disa herë dhe kjo është e ngjashme
17 në çdo kohë.

18 Gjuha e folur është një vijim i shprehur me tingull,
19 tinguj të vazhdueshëm njëri pas tjetrit dhe ata nuk mund të
20 ndahen aq lehtë nga njëri-tjetri për të krijuar kuptimin e
21 fjalës.

22 PY. Në faqen 7 të raportit tuaj, ju i referoheni
23 informacionit që nga poshtë-lart dhe nga lart-poshtë.

24 A mund ta përshkruani këtë shprehje dhe ta ilustroni?

25 PË. Pra, pasojat, ajo që po përpiqesha të thoja për sa i

1 përket llojit të fjalimit, sipas asaj të dihet nga të gjithë,
2 pra, që është njohuri e zakonshme, duket se ne kur dëgjojmë
3 një fjalim, ne thjesht dëgjojmë secilin tingull nga secili
4 individ, i vëmë ato së bashku për të krijuar fjalët, pra, në
5 të njëjtën mënyrë siç bëjmë kur lexojmë një tekst të shkruar.
6 Fakti se këto fonema nuk ekzistojnë në mënyrën se si paraqiten
7 do të thotë që nuk mund të jetë mënyra se si perceptimi i
8 fjalimit funksionon. Pra, kemi një kuptim më të ndërlikuar të
9 perceptimit të fjalimit në të cilën perceptimi kombinon
10 informacionin nga dy burime të ndryshme.

11 Një formë e informacionit që ne e quajmë nga poshtë-lart,
12 informacion, pra, vjen nga burimi i vetë fjalimit, sinjali
13 akustik, pra, vala e tingullit në qoftë se mund të themi
14 kështu dhe kjo përfshinë disa lloje të ndryshme të
15 informacionit që na mundësojnë neve të interpretojmë atë që po
16 dëgjojmë. Por nga poshtë-lart, informacioni që vjen nga
17 poshtë-lart vetëm është i pamjaftueshëm. Ne themi se
18 informacioni nga poshtë-lart përcakton, por në mënyrë të
19 pamjaftueshme, perceptimin e fjalëve që ne dëgjojmë.

20 Pra, me qëllim që të dëgjojmë fjalët, na duhet edhe një
21 burim tjetër informacioni, i cili në mënyrë të zakonshme quhet
22 informacion që vjen nga lart-poshtë. Ky informacion vjen nga
23 mendja e dëgjuesit dhe mund të përfshijë gjithçka që dëgjuesi
24 di për fjalimin apo atë që po dëgjojnë.

25 PY. Faleminderit. Sa prej këtij të kuptuari të fjalimit vjen

1 nga secila prej këtyre burimeve të informacionit?

2 PË. Kjo varet nga natyra e fjalimit dhe nga lloji i sinjalit
3 audio. Për shembull, marrim skenarin kur po dëgjojmë diçka që
4 nuk është personalisht, pra, nuk është përballë, nuk është
5 kontakt personal. Marrim situatën kur dëgjojmë një incizim
6 audio, pra, nuk kemi kontekst, thjesht dëgjojmë incizimin
7 audio pa kontekst, pra, dekontekstualizuar.

8 Mund të përkufizojmë qartësinë e këtyre incizimeve audio.
9 Unë përdor një përkufizim me tre terma, tre mënyrësh, njëri
10 është audio i qartë dhe kjo është audio kur folësit flasin në
11 mënyrë të qartë dhe të ngadaltë. Incizimi është i incizuar me
12 cilësi të lartë, pra, kushdo që flet atë gjuhë mund ta dëgjojë
13 këtë incizim dhe ta dëgjojë qartë përmbajtjen e tij.

14 Përkufizimi i dytë është i paqartë. Pra, ky -- kërkoj
15 ndjesë, kujtova se dikush tha diçka.

16 Pra, audio e paqartë është një situatë ku ndoshta folësit
17 flasin në mënyrë bisedë të lirë, jo të qartë. Flasin
18 njëkohësisht. Mund të mos jenë afër mikrofonit. Mund të jenë
19 duke lëvizur. Mund të ketë një zhurmë në sfond. Pra, shumë
20 gjëra që e bëjnë të vështirë për të dëgjuar atë që po thuhet.
21 Karakteristika e rëndësishme e audios së paqartë është se në
22 qoftë se dëgjoni thjesht është e vështirë të dëgjohet se çfarë
23 po thuhet. Por në qoftë se je dëgjues me aftësi të veçanta dhe
24 ua jep të njëjtën audio dëgjuesve që janë të trajnuar për këtë
25 gjë dhe u kërkon atyre të shkruajnë atë që po dëgjojnë, mund

1 t'ju duhet pak kohë, ndoshta do t'u duhet ta dëgjojnë disa
2 herë, por përfundimisht mund të arrijnë të njëjtën përmbajtje.

3 E treta kategori, që do të doja të përmend këtu, është e
4 padallueshme. Pra, kjo ka dhe më shumë faktorë që e bëjnë atë
5 të ndërlikuar dhe incizimin të paqartë. Kur dëgjoni për herë
6 të parë mund të thoni, uf, sa e vështirë qenka, është e
7 pakuptueshme, nuk jam në gjendje të kuptoj, të dëgjoj asnjë
8 fjalë, kjo është shumë e vështirë për t'u kuptuar. Por
9 karakteristika më e rëndësishme e audios së padallueshme është
10 se përmbajtja nuk është vetëm -- nuk mund të nxirret vetëm
11 duke dëgjuar atë, pra, nga informacioni që vjen nga poshtë-
12 lart. Kjo ndikohet shumë edhe nga informacioni nga lart-poshtë
13 që ka dëgjuesi. Pra, në këtë situatë, në qoftë se i jepni një
14 incizim nga gjashtë vetë, për shembull, dëgjues të cilët i
15 dëgjojnë këta, ata do të dëgjojnë diçka të ndryshme varësisht
16 nga mënyra se si janë parainformuar për të kuptuar audion.

17 Pra, për t'ju përgjigjur pyetjes tuaj në përmbledhje,
18 roli i informacionit nga poshtë-lart krahasuar me
19 informacionin nga lart-poshtë varet në shkallë të gjerë nga
20 qartësia apo sa e pastër është audio. Pra, me një audio të
21 pastër, informacioni nga poshtë-lart mund të jetë i
22 mjaftueshëm në qoftë se keni një person që flet gjuhën në të
23 cilën po dëgjon dhe dëgjuesit, pra, flasin gjuhën në fjalë. Në
24 rastin e informacionit të paqartë dhe të padallueshëm duhet
25 dhe informacioni nga lart-poshtë.

1 PY. Pra, në praktikë cilët faktorë mund të ndikojnë
2 perceptimin e fjalimit, e kam fjalën për faktorët audio,
3 faktorë të fjalimit apo të folësve?

4 PË. Kjo ka të bëjë me faktorët që e bëjnë një fjalim të
5 qartë, të paqartë apo të padallueshëm dhe ne mund t'i ndajmë
6 këta në disa faktorë të ndryshëm. Disa prej tyre i përmenda
7 shkurtimisht kur i bëra përshkrimin e tyre.

8 Një prej tyre janë faktorët e fjalimit. Dhe ky është
9 lloji i fjalimit. Pra, bëhet fjalimi në dialekt të cilin ju e
10 kuptoni apo personi e kupton? A është fjalimi i qartë,
11 shprehur në mënyrë të qartë nga folësit të cilët po
12 përkujdesen për atë që po thonë në mënyrë që të jetë e lehtë
13 për t'u kuptuar? Tjetra a është fjalim i natyrës formale apo
14 jo?

15 Pastaj ka të bëjë me cilësinë. Pra, varet ku është
16 vendosur mikrofoni, a ka zhurma në sfond, pajisjet për të
17 incizuar, programin informatikë a janë të programuar siç duhet
18 apo jo.

19 Pastaj faktorët e folësit kanë të bëjnë edhe me faktin
20 nëse folësi -- ndoshta e ngatërrova pak me fjalimin dhe
21 folësit. Pra, nëse folësi po mbikëqyr, po monitoron atë që po
22 thuhet, po thuhet, për të kuptuar se ata po bëjnë një incizim
23 që dikush do ta dëgjojë më vonë.

24 PY. Faleminderit. A është e mundur që t'i përmbledhim këto
25 tre nivele të cilësisë së audios, pra, audio e pastër është e

1 lehtë për t'u kuptuar nga njerëzit që e kuptojnë gjuhën në të
2 cilën po thuhet, audio e papastër, e paqartë e cila duhet të
3 dëgjohet disa herë, dhe audio e padallueshme që është e lehtë
4 për t'u keqdegjuar apo dëgjuar gabimisht përmbajtja e saj?
5 PË. Është e saktë. Karakteristika e rëndësishme e audios së
6 padallueshme. Fjalimi i paqartë është i vështirë për t'u
7 dëgjuar, por është e mundur pa njohuri nga lart-poshtë që të
8 arrihet një kuptim i besueshëm në të cilin mund të mbështetesh
9 duke dëgjuar disa herë. Ndërsa audio e padallueshme mund të
10 përkufizohet si e lehtë për t'u keqdegjuar apo dëgjuar në
11 mënyrë të gabuar dhe nëse keni informacionin e pasaktë apo që
12 të çon në drejtim të pagabuar dhe që vjen nga lart-poshtë.
13 PY. Faleminderit. A mund të shpjegoni cili është komenti që
14 keni bërë në faqen 7 të raportit tuaj lidhur me ndikimin, pra,
15 prirjen për të dëgjuar diçka?
16 PË. Po. Pra, ndikimi në thelb është zbatimi, përdorimi i
17 njohurisë nga lart-poshtë të cilën e përkufizua më lart. Ky
18 është një informacion që ne kemi, personi ka për llojin e
19 fjalimit apo presupozimet, pritshmëritë që mund të kenë lidhur
20 me përmbajtjen e fjalimit, kush janë folësit e kështu me
21 radhë. Pra, ky ndikim është zbatimi, përdorimi i kësaj
22 njohurie dhe rëndësia e fjalës "ndikim" është se kjo njohuri
23 apo këto pritshmëri apo informacioni fillon të përdoret
24 përpara jush përpara se të dëgjoni, të keni filluar të dëgjoni
25 fjalimin. Pra, kjo është fillimisht.

1 PY. Në raportin tuaj ju bëni dallimin e ndikimit kontekstual
2 dhe të brendshëm?

3 PË. Ndikimi kontekstual është ai për të cilin folëm deri
4 tani. Pra, është informacioni paraparak apo pritshmëritë që ju
5 keni lidhur me atë që do të dëgjoni nga konteksti, pra,
6 kuptimi, të kuptuarit e një situate, ajo që ju mendoni që po
7 ndodhë.

8 Në situatë normale kemi shumë ndikim kontekstual. Ndërsa
9 ndikimi tekstual nuk është gjithmonë i pranishëm apo që
10 përdoret.

11 Ndikimi kontekstual nuk është i saktë, pra, nuk ka të
12 bëjë me pritshmëritë e sakta apo të hollësishme. Është i
13 përgjithshëm dhe ndoshta një pritshmëri e vagullt e llojit të
14 përmbajtjes që personi pret të dëgjojë. Ndërsa ndikimi
15 tekstual ju jep juve një pritshmëri apo presupozim lidhur me
16 fjalët e sakta që ju mund të dëgjoni apo personi mund të
17 dëgjojë.

18 Përvoja më e zakonshme për njerëzit është kur shihet një
19 film apo në televizor, video ku audio është e cilësisë së
20 dobët dhe keni nëntitujt. Nuk e kam fjalën për nëntitujt që
21 përkthejnë në gjuhë tjetër. E kam fjalën nëntituj që janë të
22 shkruar në të njëjtë gjuhë, të gjuhës që po dëgjohet,
23 zakonisht kemi përvojën se këta nëntituj ju ndihmojnë për të
24 kuptuar. Pra, ky është shembull i ndikimit apo prirjes
25 tekstuale për të kuptuar diçka, për t'i kuptuar fjalët që po

1 thuhën. Dhe kjo është ajo që njerëzit, pra, arsye për të cilën
2 njerëzit i konstatojnë shumë të dobishme, që ndihmojnë shumë
3 nëntitujt kur dëgjojnë një audio të cilësisë së dobët.

4 PY. Në raportin tuaj ju thoni se ndikimi tekstual është edhe
5 më i fuqishëm sesa ndikimi kontekstual, në faqen 8. A mund të
6 shpjegoni pse?

7 PË. Po. Mendoj se është e saktë kjo. Nëntitujt është ndihmë
8 shumë e fuqishme. Pra, kur audio është e paqartë, fuqia e
9 ndikimit tekstual është më e fuqishme sesa informacioni që
10 vjen nga poshtë-lart. Dua të theksoj këtu se po flas për
11 incizime audio të padallueshme, të padëgjueshme. Nuk po flas
12 për perceptimet e fjalimeve të tjera. Po flasim për incizime
13 audio që janë të padallueshëm. Është shumë e lehtë që të
14 keqorientosh dikë, një person, që të dëgjojë fjalë që nuk janë
15 të sakta duke ju dhënë atyre, duke krijuar një ndikim
16 kontekstual të pasaktë. Dhe kjo është një forcë, pra, një
17 ndikim i fuqishëm në perceptimin e fjalimit.

18 PY. Sa, në çfarë shkalle pranohen këto parime që lidhen me
19 shkencën forensike sa i takon ndikimit?

20 PË. Jo vetëm të forensikës. Në linguistikë, më në
21 përgjithësi, këto parime janë të mirëpranuara, vërtetuara dhe
22 kanë ndoshta që në vitet 1950, pra, kur fillimisht u paraqitën
23 këto çështje. Dhe kam dhënë disa diskutime, disa komente në
24 raportin tim. Aty parimet e përgjithshme janë jashtëzakonisht
25 të mirëpranuara, të përcaktuara në linguistikë dhe në

1 psikologji. Pra, kemi një fushë të linguistikës forensike e
2 cila bashkon të dyja psikologjinë dhe linguistikën. Parimi i
3 përgjithshëm është se perceptimi i fjalimit përfshin të dyja,
4 pra, informacionin që vjen nga poshtë-lart dhe atë që vjen nga
5 lart-poshtë dhe ndikimi kontekstual dhe tekstual kanë efekt të
6 fuqishëm në perceptimin e fjalimit dhe kjo është tejet e
7 pranuar dhe e mirë përcaktuar dhe e vërtetuar.

8 Pra, ka ndryshime të shumta sa i përket shpjegimit teorik
9 të këtyre vëzhgimeve, konstatimeve. Ka patur shumë dhe mund të
10 ketë debate. Ne kemi konferenca të tëra lidhur me këto tema ku
11 njerëzit të paraqesin teori të ndryshme shpjegime, rezultatet
12 eksperimentale, të gjitha llojet e gjërave.

13 Por, parimet e përgjithshme të cilat sapo përshkrova janë
14 të mirëkuptuara dhe të mirëpranuara.

15 PY. Ndikimi për të dëgjuar diçka është ndryshe nga anshmëria
16 konjunktive kur në rrethanat dhe këto konceptet mund të jenë
17 të mbivendosura për njëri-tjetrin?

18 PË. Anshmëria konjunktive është e ndryshme nga ndikimi. Ato
19 shpesh ngatërrohen me njëra-tjetrën, por mendoj që është e
20 dobishme, shumë e dobishme dhe e rëndësishme që t'i mbajmë të
21 ndara në mendjet tona kur flasim për perceptimin e fjalimit
22 dhe për mbështetëshmërinë e perceptimit në rrethana të
23 ndryshme.

24 Pra, ndikimi, sapo përshkrova ndikimin, i cili është
25 përdorimi i çdo lloj informacioni kontekstual apo tekstual për

1 të kuptuar një gjë të caktuar. Ndërsa anshmëria është ndoshta
2 më specifike, më konkrete dhe ka të bëjë në rastet kur kemi më
3 shumë pritshmëri apo një synim, një qëllim për të përdorur një
4 informacion të caktuar që e kemi dëgjuar, përmbajtjen e një
5 audio për të arritur në një përfundim në qoftë se është kjo
6 ose për të vërtetuar, për të provuar diçka.

7 Pra, kjo është anshmëri kur ne kemi një prirje për të
8 interpretuar një fjalim që nuk kemi dëgjuar akoma apo një
9 përmbajtje me qëllim që të vërtetojmë një gjë të caktuar në
10 një mënyrë apo në një tjetër.

11 Pra, është e rëndësishme që të kuptojmë se ndikimi
12 funksionon edhe pse në qoftë se nuk kemi fare anshmëri, mund
13 të jeni tërësisht, për shembull, person tërësisht i pavarur
14 dhe neutral. Ajo është e pranishme, pra, ndikimi dhe kur jeni
15 i anshëm. Janë dy gjëra të ndryshme që po ngatërrohen me
16 njëra-tjetrën në një farë shkalle.

17 PY. Faleminderit. Tani do të doja të shohim një video të
18 shkurtër.

19 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Znj. Sekretare, është DHT1201624
20 deri në 01624, me shënimin 42. Dhe titulli është "Si
21 perceptojmë fjalimin njerëzor", nga Ryan Rhodes dhe është
22 cituar në faqen 9, poshtëshënimi 12 i raportit tuaj. Vetëm
23 minutat e para, ju lutem.

24 [Luhet videoincizimi]

25 Zëri: "Dua thjesht të dëgjoni ca dëgjoni, a kuptuat gjë

1 në këtë? Do ta dëgjojmë dhe një herë.

2 "Njeriu me gazetë në drekë".

3 Tani është e qartë dhe ju e kuptoni shumë mirë që është e
4 qartë. Ta dëgjojmë edhe një herë atë në fillim që ishte
5 komplet i padëgjueshëm, i pakuptueshëm. Edhe tani është i
6 pakuptueshëm? Tani i dëgjoni fjalët? Pra, është interesante
7 sepse ajo që dëgjojmë ndikohet jashtëzakonisht shumë nga ajo
8 që presim të dëgjojmë, pra, dëgjojini fjalët".

9 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

10 PY. Profesor Fraser, a mund të na shpjegoni se çfarë përpiqet
11 të tregojë kjo video e shkurtër lidhur me ndikimin tekstual?

12 PË. Ky është një shembull i ndikimit tekstual, ku diçka që
13 njerëzve iu duket e pakuptueshme, e padëgjueshme, njerëz që
14 nuk mendojnë që po dëgjojnë një fjalim në videoklipin e parë.
15 Dua të theksoj se në fund është e njëjta video, saktësisht e
16 njëjta video. Të njëjtët persona mendojnë që tani është audio
17 e ndryshme. Dhe në fakt është e njëjta audio. E vetmja gjë që
18 ka ndryshuar është se kemi më shumë kontekst, informacion
19 tekstual dhe për shumë njerëz kjo e bën më të qartë kuptimin e
20 fjalimit. Pra, nuk ka dallim në informacionin nga poshtë-lart,
21 po ka një dallim të madh në informacionin që vjen nga lart-
22 poshtë.

23 PY. Pra, kjo video përdor një teknikë. A mund ta sqaroni cila
24 është kjo teknikë?

25 PË. Kjo nuk është audio forensike. Ky demonstrim është

1 përdorur për një kohë të gjatë tashmë. Mendoj se ka ndodhur në
2 fund të viteve 1980 që është zhvilluar si teknikë. Dhe quhej
3 fjalimi me shenja të valëve. Pra, incizimi, ata incizojnë disa
4 fjali në cilësi të lartë në studio, në incizim në studio dhe
5 pastaj në mënyrë sistematike e përkeqësonin cilësinë e audios
6 në mënyrë që të dëgjohej vetëm sasia e informacionit minimal
7 dhe të mbahej në të. Në fakt, ata që e bënë këtë në mënyrë
8 specifike për të eksploruar marrëdhënien midis informacionit
9 nga poshtë-lart dhe nga lart-poshtë.

10 Gjëja e rëndësishme këtu se fillon si incizim i cili
11 pastaj është përkeqësuar apo zvogëluar në informacionin nga
12 lart-poshtë. Dhe është e rëndësishme të tregohet se si
13 informacioni nga lart-poshtë dhe të paturit e informacionit
14 paraprak funksionon.

15 Ajo që nuk marrim nga ky shembull është mundësia e të
16 dëgjuarit në mënyrë të ndryshme. Ne kemi thjesht fjalë që na
17 janë dhënë neve si ndikim, pra, informacion tekstual dhe kjo
18 është sepse hulumtuesit i dinë fjalë që janë thënë aty. Ata
19 kanë vendosur, caktuar fjalitë, kanë incizuar fjalitë, e kanë
20 përkeqësuar cilësinë dhe kështu me radhë. Në audio forensike
21 askush nuk e di të sigurtë se çfarë është thënë. Dhe audio
22 është degraduar, pra, përkeqësuar jo në këtë mënyrë
23 sistematike, por është degraduar në mënyra që janë përshkruara
24 më parë me të gjitha gjërat që përmenda që mund ta zvogëlojnë
25 informacionin nga poshtë-lart në një mënyrë kaotike si mund të

1 themi.

2 PY. Pra, i njëjti parim i ndikimit tekstual zbatohet dhe në
3 këtë rast? Për shembull, për shkak të cilësisë së dobët të një
4 incizimi?

5 PË. Po. Dhe kjo është më pak e kontrolluar. Cilësia e dobët e
6 incizimit, bashkë me të gjithë faktorët që përshkrova më
7 herët, siç e thashë, nuk është degraduar, përkeqësuar në
8 mënyrë sistematike. Dhe, në fakt, kërkimet tona --dhe janë
9 bërë disa eksperimente të kësaj natyre. Dhe zakonisht njerëzit
10 thjesht japin fjalët që janë thënë në të vërtetë, por në qoftë
11 se jepni fjalë që nuk janë të sakta mund të bëni, mund të çoni
12 thjesht, shumë lehtë njerëzit t'i orientoni që ata të dëgjojnë
13 diçka ndryshe edhe nëse është e degraduar në mënyrë
14 sistematike.

15 Pra, një prej eksperimenteve kryesore që kemi bërë për të
16 treguar se si duke iu dhënë një kontekst, duke dhënë një
17 shtyrje, një shtyrje apo një informacion paraprak njerëzve me
18 tekste të ndryshëm dhe ndikim tekstual të ndryshëm mund t'i
19 krijoni që njerëzit të kenë përvojë të dëgjuarit të njëjtës
20 video në mënyrë komplet të ndryshme, tërësisht të ndryshme.

21 Pra, një eksperiment tipik është, për shembull, që fillimisht
22 ju nuk e lëshoni që të dëgjohet fjalimi me shenja të valëve
23 dhe kjo është një lloj specifik i gjërave që përdoret për
24 eksperimentimin dhe zhvillimin e teorive. Po flas për audio më
25 realiste, pra, forensike. Dhe nëse dëgjonit atë herën e parë pa

1 informacion fare, njerëzit dëgjojnë atë që dëgjojnë.
2 Ndonjëherë asgjë. Ndonjëherë disa gjëra të ndryshme. Dhe
3 pastaj ju i jepni atyre një informacion me një lloj teksti,
4 ata do të ndikohen nga ky tekst për të dëgjuar të njëjtën gjë
5 ose fjalë të ngjashme me atë që kishin dëgjuar më parë. Dhe
6 pastaj ju i jepni atyre dhe diçka më shumë dhe njerëzit
7 mendojnë se përmbajtja ishte e gabuar dhe ata, në fakt, iu
8 sugjerohet atyre që të dëgjojnë edhe përmbajtje të ndryshme,
9 pra, mund të bëni që ata të ndërrojnë tërësisht perceptimin e
10 tyre të kenë një përvojë dhe të thonë, ou, isha gabim herën e
11 parë dhe tani jam i sigurtë që është kështu që po e dëgjoj,
12 duke harruar që ata kishin të njëjtin nivel besimi për atë që
13 po dëgjonin pak minuta më parë. pra, kjo është mënyra se si
14 ndikon informacioni tekstual për të patur dhe për të thënë në
15 një mënyrë me besim që kemi dëgjuar atë që kemi dëgjuar.

16 Pra, këto ishin përvoja të parehatshme për njerëzit.

17 Është diçka e zakonshme që ndodhë.

18 PY. Faleminderit. A është e saktë të themi, siç e thatë edhe
19 ju, që kur gjërat e pavlera, pra, mbeturinat hyjnë, dalin,
20 pra, në qoftë se një përkthyes me gojë ka një informacion dhe
21 është i prirur që duke patur informacion kontekstuar apo
22 tekstual të gabuar që pastaj transkripti të jetë i gabuar, i
23 ndikuar?

24 PË. Nuk them që duhet të jetë detyruesisht i gabuar, por
25 ndikimi tek një person i caktuar me një informacion

Dëshmitarja: Helen Fraser (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Menegon

Faqe 28

1 kontekstual dhe tekstual të gabuar mund ta bëjë shumë të
2 vështirë të jesh, të thuash me besim të plotë se ajo që dëgjon
3 është e besueshme dhe në të cilën mund të mbështetesh.

4 PY. Faleminderit.

5 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Do të doja të dorëzoj këtë
6 video, DHT1201624-0624, në prova.

7 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Prokuroria?

8 Z. HAFETZ: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

9 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Të shënohet si provë.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e
11 provës materiale të përkohshme 1200139, klasifikimi publik.

12 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

13 PY. Profesore Fraser, a mund të na e shpjegoni se cili është
14 dallimi midis transkriptimit burokratik dhe forensik që e keni
15 komentuar në faqen 9 të raportit tuaj?

16 PË. Po. Është shumë e zakonshme në shumë rrethana zyrtare dhe
17 në sisteme burokratike dhe ne përdorim transkriptet dhe
18 përkthimet shumë shpesh për të gjitha llojet e gjërave. Në
19 shumë prej këtyre situatave audioja është shumë e qartë, në
20 disa raste mund të jetë pak e paqartë. Por, kryesisht
21 përmbajtja dihet, njihet dhe kontekstin e njohin përkthyesit
22 dhe transkriptuesit.

23 Në audio forensike, më duket që e përmenda këtë -- do
24 them dhe diçka për përkthimin dhe transkriptimin burokratik.
25 Synimi është që të bëhet, të dokumentohet në formë të shkruar

1 të një përmbajtjeje të njohur atë që të gjithë kanë dëgjuar
2 për të dokumentuar këtë në mënyrë zyrtare që më vonë mund të
3 përdoret nga persona të cilët nuk kanë qenë të pranishëm apo
4 që ishin të pranishëm apo kushdo do që ta përdorë atë. Pra,
5 çështja nuk është të kuptohet ajo çka është thënë, se kjo
6 është e thjeshtë. Po që të zbardhet ajo që është thënë në një
7 formë që është e kuptueshme për përdoruesin fundor.

8 Audio forensike, qëllimi i transkriptimeve apo i
9 përkthimeve është që të përcaktojë përmbajtjen. Veçanërisht
10 fazën e transkriptimit dhe dua të theksoj dhe një herë, po
11 flasim këtu për rastet kur audio është e padeshifrueshme, ku
12 përmbajtja nuk kuptohet dot menjëherë. Synimi i transkriptit
13 është që të përcaktojë atë që është thënë dhe të zbardhet në
14 një formë që t'i shërbejë më pas dëgjuesve të kuptojnë
15 përmbajtjen. Pra, ky është qëllim i ndryshëm nga i
16 transkriptimeve burokratike.

17 PY. Atëherë si mund ta përcaktojmë ne natyrën e transkriptit
18 në transkriptin forensik? A mund të themi që është një
19 përfaqësim pasqyrimi i asaj që ka dëgjuar dëgjuesi?

20 PË. Është pasqyrim i saj, po, që synon që më pas t'i ndihmojë
21 dëgjuesit që të kuptojnë këto audio të padeshifrueshme që
22 përndryshe nuk mund të kuptohen pa pasur këtë mjet.

23 PY. Këto parime çfarë nënkuptojnë për mënyrën se si duhen
24 kryer transkriptet forensike të audiove të padeshifrueshme,
25 pra, veçanërisht, cilat janë praktikat për transkriptet

1 forensike?

2 PË. Më duhet të them se ende nuk ka ndonjë praktikë të mirë
3 që të pranohet mbarëbotërisht për transkriptimin e audiove
4 forensike. Unë personalisht dhe kolegët e mi që kanë bërë
5 hulumtime të ngjashme në vende të ndryshme, ne po punojmë që
6 ta zhvillojmë, ta përgatisim një praktikë të mirë që të
7 garantojmë se gjykatat do të ndihmohen vetëm me transkripte të
8 besueshme.

9 Por gjithashtu dëshiroj të shtoj se, ndonëse ende nuk
10 kemi praktikë që të njihet mbarëbotërisht, ne kemi praktika të
11 këqija ama që njihen mbarëbotërisht.

12 PY. A mund të na ilustroni se cilat janë këto praktika jo të
13 mira?

14 PË. Praktikrat që duhet të shmangim ne është që
15 transkriptuesit të punojnë ngushtësisht me klientin, qoftë kjo
16 prokuroria apo mbrojtja. Natyra e mënyrës se si funksionojnë
17 këto gjëra është kështu që Prokuroria merr audion forensike
18 përmes një mase apo një mase tjetër. Por i njëjti parim vlen
19 dhe për mbrojtjen dhe për prokurorinë. Kjo është e
20 rëndësishme, pikërisht për këtë kemi folur deri tani madje,
21 është se i njëjti parim për shkencat forensike në përgjithësi
22 dhe mënyra se do kuptuar perceptimi i fjalës së njeriut, i të
23 folurit të njeriut, shembujt që ju dhashë deri tani, pra,
24 ndikimi që ka njohuria nga lart-poshtë apo pritshmëria me
25 drejtim nga lart-poshtë. Kjo është vërtetuar përmes

1 disiplinave të ndryshme të shkencës forensike, jo vetëm
2 gjuhësisë, ka shumë disiplina të tjera që janë objektive, pra,
3 kur ka një lloj pritshmërie apo një lloj sinjalizimi lidhur me
4 rezultatin e pritshëm të përmbajtjes që kjo, pra, për t'u
5 kuptuar ajo përmbajtja që pritet nga një gjykim ndikon në
6 mënyrën sesi e perceptojnë personat përmbajtjen.

7 Një shembull, është një hulumtim që kemi bërë ne, kemi
8 bëra shumë anketa, shumë profesionistë. Një nga pyetjet
9 kryesore është çfarë bëni ju për të shmangur anshmëritë
10 konjunktive apo ekspozimet e papërshtatshme, dhe shumica e
11 personave na kanë treguar se si i shmangin ekspozimet e
12 njëanshme apo njëanshmëritë konjunktive.

13 PY. Në nivel botëror cila është marrëveshja apo çfarë është
14 rënë dakord? Flas gjithmonë për afërsinë që kanë hetuesit,
15 prokurorët dhe transkriptuesit. Në nivel botëror çfarë është
16 rënë dakord në këtë drejtim?

17 PË. Unë nuk mund të them për çdo profesionist në gjithë
18 botën. Por mënyra si e kuptoj unë është që njihet mbarë-
19 botërisht. Nuk ka qenë rasti më parë. Më parë edhe kur nuk
20 bëhet fjalë për policinë që i jep transkriptet, se ka situata
21 të tilla, por në situata të tjera kur transkriptet jepen nga
22 profesionistë të fushës. Dikur ishte krejt normale që klienti,
23 në këtë rast policia, në juridiksionin që njoh unë, policia u
24 jepte një raportim, kjo është situata. Ky është konteksti.
25 Këta janë folësit. Ne duam që të fokusoheni në këto aspekte.

Dëshmitarja: Helen Fraser (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Menegon

Faqe 32

1 Dhe ka pas disa gjykime që janë kryer në këtë formë dhe tani
2 kjo është një nga praktikat që shmanget gjerësisht. Shumë
3 agjenci të zbatimit të ligjit nuk e kanë më këtë praktikë.

4 PY. Këto praktika të mira apo të këqija, sipas jush, a varen
5 nga gjatësia e audios?

6 PË. Jo, aspak.

7 PY. A është e rëndësishme të bëhet dallimi mes asaj që
8 prodhohet, përgatitet për hetuesit dhe për ato që përgatiten
9 si prova për gjykatën?

10 PË. Kjo është shumë e rëndësishme. Gjatë një hetimi dhe kjo
11 ndodh rëndom më shumë për përkthimin, jo transkriptimin. Por
12 gjatë një hetimi është krejt normale që të mos bëhet asnjë
13 transkript pa dëgjuar hetuesit. Ata do të kenë ndihmën e
14 përkthyesve apo ekspertëve të tjerë të gjuhës që ta kuptojnë.
15 Por në këto raste, mund të mos ketë fare transkripte. Po bëhet
16 një përmbledhje. Sepse duhet të veprojnë sa më shpejt gjatë
17 një hetimi, të kuptojnë situatën dhe të veprojnë sipas rastit.
18 Kjo nuk ka lidhje fare me këtë. Pra, nuk do të jap rekomandime
19 se si do bëjnë punën hetuesit.

20 Por është e rëndësishme që transkriptet apo përkthimet me
21 shkrim që përdoren gjatë një hetimi, mendojmë që është problem
22 nëse përdoret i njëjti material si provë në gjykim për
23 mbështetëshmëri dhe për besueshmëri.

24 PY. Faleminderit. Tani dua të diskutojmë audiot dhe
25 transkriptet në këtë çështje gjyqësore, materialet që ne ua

1 kemi dhënë ju. Sikurse ju thamë në letrën me udhëzimet
2 përkatëse, për shkak të volumit të incizimeve dhe materialeve,
3 ju kemi dhënë materiale vetëm lidhur me dy vizita që janë bërë
4 në dhjetor, në paraburgim, që janë një kampionim dhe ju keni
5 bërë një analizë të kampioneve që kemi dhënë ne.

6 Pyetja ime është kjo: Çfarë faktorësh keni marrë ju
7 parasysh për të vendosur që kampioni që ju kemi dhënë ne është
8 përfaqësim i tërësisë apo jo?

9 PË. Unë nuk vendosa nëse kampionet ishin përfaqësim i
10 tërësisë së incizimeve. Unë u fokusova tek këto dy incizime
11 dhe ju më thatë që përfaqësojnë tërësinë. Më kërkua të
12 përcaktoj -- nëse do të më kërkoni të përcaktoja nëse
13 kampionet që më dhatë ishin përfaqësim i tërë incizimeve do të
14 duhet të fokusohesha në shumë aspekte të tjera të folurit, të
15 audios, të folësit dhe të përcaktoj deri në ç'nivel është i
16 padeshifrueshëm incizimi.

17 PY. Faleminderit. Po për transkriptet? A keni nevojë ta
18 kuptoni si janë krijuar transkriptet për të bërë një analizë?

19 PË. Lidhur me transkriptet është shumë e rëndësishme të dimë
20 procesin që është ndjekur për përgatitjen e këtyre
21 transkripteve. Është shumë e vështirë ta shohësh një
22 transkript pas faktit, pasi është bërë, pasi është zbardhur
23 dhe të japin një transkript, ta vendosin përpara, është shumë
24 e vështirë të përcaktohet besueshmëria e këtij transkripti.

25 PY. Ju nuk flisni shqip. Pra, nuk e flisni gjuhën, si e

1 vlerësuat ju cilësinë e audios në këtë çështje? Edhe si ju
2 kufizoi fakti që nuk flisni gjuhën?
3 PË. Gjuhën nuk e kuptoj. Normalisht, në qoftë se do të dëgjoj
4 audio të padeshifrueshme në anglisht, fillimisht unë mund ta
5 dëgjoj vetë pa pasur informacion kontekstual për të krijuar
6 një ide se sa e padeshifrueshme është audio, është e qartë, e
7 paqartë apo e padeshifrueshme. Kemi një grup transkriptuesish
8 që janë stërvitur, janë testuar, të cilët janë të besueshëm,
9 janë dëgjues shumë të aftë për videot e padëgjueshme apo të
10 padeshifrueshme. Ua jap atyre audion pa u dhënë informacion
11 kontekstual. Nuk është fundi i procesit. Nuk mund të bëhet i
12 gjithë procesi pa informacion kontesktual. Në një moment duhet
13 dhënë informacion kontekstual. Por fillimisht duhet kryer
14 përshtypja nga vetë dëgjuesi pa pasur kontekstin. Kjo është e
15 rëndësishme për të kuptuar sa informacion kanë sinjalet
16 akustike përkundrejt informacionit që vjen nga informacioni i
17 jashtëm kontekstual.

18 Në këtë rast, unë nuk mund ta bëja këtë sepse unë nuk
19 flas shqip dhe nuk kam qasje apo më saktë nuk kam pasur asnjë
20 transkriptues që flet shqipen. Kështu që unë përdora
21 transkriptuesin e inteligjencës artificiale dhe e kam
22 përmendur këtë në raportin tim.

23 PY. Në fakt e keni përmendur që nuk keni pasur asnjë
24 transkriptues të gjuhës shqipe për këto raporte. Do ju kishte
25 ndihmuar ju të kishit një transkriptues të stërvitur, të

1 trajnuar të gjuhës shqipe për transkriptimet?
2 PY. Të paktën dy do kisha dashur të kisha, të paktën dy
3 persona që e flasin gjuhën, jo thjesht të trajnuar për
4 përkthimet dhe për transkriptimet. Këtë dua ta bëj të qartë
5 dhe kjo është shumë e rëndësishme. Shumë persona janë të
6 trajnuar për transkriptimet dhe përkthimet në kuptimin
7 burokratik. Pra, janë shumë të aftë për të bërë transkriptimet
8 burokratike. Po kjo është një fushë tjetër, kërkohen aftësi të
9 tjera për të deshifruar audiot e padeshifrueshme.

10 Transkriptimet forensike, kjo është fusha ime,
11 transkriptimet forensike janë, për mendimin tim ky është një
12 term i gabuar në fakt. Se këtu çelësi nuk është fjala
13 transkriptim. Transkriptimi është i thjeshtë. E vështira është
14 të përcaktosh cilat janë fjalët që janë thënë. Kjo është një
15 hapësirë shumë e vështirë dhe shumë e specializuar që për këtë
16 nuk mund ta trajnosh një person apo ta marrësh në provim, ta
17 testosh, siç ndodhë rëndom për linguistikën apo për
18 transkriptimet burokratike.

19 Pra, personat që flasin gjuhën duhet ta kenë demonstruar
20 që kanë aftësinë në deshifrimin e audiove të padeshifrueshme.

21 PY. Kërkuat ju për një ndihmë, na kërkuat ju për këtë?

22 PË. Më duket se ua kam kërkuar këtë ndihmë në fillim.

23 PY. Ne ju thamë që nuk ishte e mundshme për shkak të afatit
24 të kufizuar që kishim ne?

25 PË. Saktë.

1 PY. Në faqen 7 të raportit, ju keni thënë që jeni përpjekur
2 të vlerësoni nivelin apo shkallën e padeshifrimit të një
3 audioje duke përdorur inteligjencën artificiale.

4 Mendoni ju se inteligjenca artificiale është një mjet i
5 mirë për ta bërë këtë?

6 PË. Absolutisht jo. Absolutisht jo. Nuk mund të zëvendësojë
7 aspak transkriptuesit njerëzor, aspektin njerëzor.

8 PY. Po pse menduat ju se ishte e dobishme për ju në këtë
9 rast?

10 PË. Sepse mendova -

11 PËRKTHYESJA: Ju kërkohet folësve të bëjnë një pauzë.

12 DËSHMITARJA: [Përkthim] Ju kërkohet ndjesë përkthyesve.

13 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

14 PY. Në rregull, vazhdojmë.

15 PË. Po thojë pra, që inteligjenca artificiale nuk mund ta
16 zëvendësojë aspektin njerëzor për transkriptimin, flasim për
17 audiot e padeshifrueshme. Tani, pse e zgjedha unë ta përdorja
18 në këtë rast? Është sepse thjesht doja të krijoja një ide sesa
19 informacion ishte, sa informacion kishte të disponueshëm nga
20 lart-poshtë.

21 A mund të vijoj?

22 PY. Po, në rregull.

23 PË. Pra, çfarë bëra unë është që unë përdora mjetin e
24 transkriptimit AI quhet *Whisper* 5 nga *ChatGPT-5*, ky është
25 instrumenti më i mirë për momentin. Fillimisht mora një lajm

1 në shqip, një artikull.

2 PY. Do ju ndërpres, do ju ndërpres, këtë e keni përshkruar në
3 raport. Unë po ju pyes më shumë si iu ndihmoi ju inteligjenca
4 artificiale në këtë rast?

5 PË. Dobia ishte që incizimi i inteligjencës artificiale mund
6 ta transkriptonte audion e qartë dhe ta përkthente, më dha dhe
7 përkthimin gati identik me materialin që kishin transkriptuar
8 personat. Por nga ana tjetër dhe audio, në këtë rast, nuk
9 arriti ta transkriptonte. E bëri lëmsh.

10 PY. Pra, ju dha thjesht një indicie, një ide për të
11 identifikuar cilësinë e audios?

12 PË. Po.

13 PY. Tani dua të më jepni mendimin tuaj për një test që kemi
14 bërë ne të vizitave të z. Kuçi më 3 shtator 2023. Në këtë
15 vizitë, e keni në pjesën 3 të raportit tuaj, ZPS-ja krijoi
16 dosje të ashtuquajtura dosje audio të papërforsuara, me cilësi
17 të papërforsuar edhe pati dhe dosje të tjera të cilat i kishin
18 cilësinë e audios të përforsuar, të rishikuar.

19 A mund të na thoni si e kuptuat ju këtë procesin e
20 përforsimit, ç'domethënë ky procesi i përforsimit të audios?

21 PË. Ne kemi raporte të asaj që është bërë, punës që është
22 kryer, domethënë, por nuk kemi raporte se çfarë efekti,
23 ndikimi pati kjo apo çfarë efekti pati në mënyrën e
24 perceptimit. Nuk ka një matje objektive të efektit të
25 ndikimit, por ama kemi vetëm të perceptimit.

1 PY. Në përgjithësi dhe në këtë rast, versioni i përforcuar a
2 është më i qartë se versioni i papërforcuar?

3 PË. Jo. Përforcimi i cilësisë është thjesht një teknikë e
4 ndryshueshme në të cilën ulet niveli i tingullit, i zhurmave.
5 Ky është një shembull i mirë për të treguar atë që ilustrova
6 më herët, ka njohuri që njihen në njohuri shkencore.

7 Kur ke njohuri logjike është shumë e vështirë të kuptohet
8 audio, pra, ka disa fjalë, biseda pas një velloje, pas një
9 zhurme. Ideja është që në qoftë se hiqet kjo velloja, po jua
10 them unë, apo kjo zhurmë mendojmë që mund ta dëgjojmë atë që
11 bisedohet. Kjo është e rreme. Sepse nuk funksionon kështu në
12 realitet. Ajo që i bën audiot të padeshifrueshme është
13 pikërisht mungesa e informacionit nga lart-poshtë. Përforcimi
14 nuk duhet të shërbejë për të shtuar informacion. Reduktimi i
15 zhurmave, në fakt, nuk e bën më të qartë bisedën. Dhe
16 ndonjëherë dhe unë kam punuar shumë në këtë fushë, kam bërë
17 shumë eksperimente, qoftë kjo vetëm apo me persona të tjerë,
18 ndonjëherë përpjekja për të reduktuar zhurmat, në fakt, e bën
19 bisedën nga pikëpamja objektive më pak të deshifrueshme. E di
20 që duket e habitshme, po kështu është në të vërtetë, reduktimi
21 i zhurmës do të thotë edhe heqje informacioni.

22 PY. Faleminderit.

23 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Tani do t'ju tregoj materialin
24 që përfundon me 37. Pjesa 10.

25 PY. Është një shkëmbim email midis Mbrojtjes së Thaçit edhe

1 një përkthyesi shqip të cilit iu kërkua të transkriptonte dhe
2 të përkthente dy audio të përforcuara të vizitës së Kuçit.

3 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Është prova që mbaron me 4 dhe
4 mbaron me 3, pra, 107.4 dhe 107.3, janë dy ekstrakte të
5 Mbrojtjes së Kuçit.

6 PY. Për të cilat nuk i është dhënë transkript.

7 A mund ta shihni?

8 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] I lutem Sekretares të shkojmë më
9 poshtë.

10 PY. Pra, mund ta shikoni në bazë të këtij emaili, z. Hysni
11 Recica tha që unë nuk mund t'i transkriptoj dhe përkthej këto
12 materiale për shkak të cilësisë.

13 PË. E shoh.

14 PY. Dua ta krahasoj këtë me transkriptin e ZPS-së për të
15 njëjtën pjesë.

16 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të nxjerrë
17 në ekran materialin P107.4-ET. Ky është transkripti i ZPS-së i
18 audios së përforcuar. Faleminderit. Mund të shohim dhe
19 titullin tek rreshti i parë, këtu ku thuhet, e përforcuar.

20 Shkojmë në faqen e fundit, ju lutem.

21 PY. Pra, ju e shihni që ZPS-ja ka nxjerrë një transkript me
22 pesë faqe për të njëjtën pjesë.

23 Z. HAFETZ: [Përkthim] Ju lutem, kam diçka.

24 Meqë jemi në seancë publike dhe i nxjerrim këto prova
25 publikisht. Nuk kam ndonjë kundërshtim, po mbase duhet ta

1 sjell në vëmendjen e Gjykatësit.

2 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Jo, nuk është për publikun
3 dokumenti, mund të vazhdojmë.

4 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

5 PY. Dëshmitar -- znj. Dëshmitare më saktë, dëshiroj t'ju pyes
6 për dallimin e transkriptimit midis ZPS-së dhe z. Recica për
7 të njëjtat materiale. A mund të na thoni çfarë mund të thoni
8 ju për cilësinë e audios? Si ka mundësi që z. Recica nuk
9 arriti ta transkriptonte por ZPS-ja ka arritur ta bëjë?

10 PË. Po. Nuk është një eksperiment shumë i kontrolluar. Ne nuk
11 e dimë z. Hysni dhe, personalisht, unë nuk e di dhe me gjithë
12 respektin, absolutisht me gjithë respektin si përkthyes e
13 transkriptues, unë nuk e di nëse z. Recica do të ishte pjesë e
14 kategorive të personave që unë përmenda më herët, të personave
15 që kanë demonstruar aftësinë e deshifrimit të audiove të
16 padëgjueshme. Megjithatë, në vija të përgjithshme, kjo është
17 në përputhje me atë që thashë më herët, kur thashë se mund të
18 shohim që përgatitja e një transkripti të këtij materiali
19 mbështetet shumë në informacionin nga lart-poshtë,
20 informacionin që besoj që z. Recica nuk e ka pasur. Ky është
21 skenar i njohur. Pra, është e ngjashme me teknika të tjera të
22 shenjave, teknikën e shenjave. Pra, kur dëgjon, por kur dëgjon
23 diçka pa pasur informacionin nga lart-poshtë është shumë më e
24 vështirë ta kuptosh videon. E bën videon dhe më pak të
25 deshifrueshme. Besoj që kjo është dhe ajo që po shohim dhe në

Dëshmitarja: Helen Fraser (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Menegon

Faqe 41

1 këtë rast.

2 PY. Dëshiroj t'ju tregoj një email tjetër.

3 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Ju lutem më nxirrni në ekran
4 materialin 1D121, përndryshe me numrin 11.

5 PY. Ky është një email mes Mbrojtjes së Thaçit dhe Njesisë
6 për Administrimin e Gjykatës më datën --

7 PË. Më falni, nuk po e shoh.

8 PY. -- mban datën dhjetor 2025.

9 PË. Ah, po, tani sapo e pashë.

10 PY. Njësia e Përkthimit në këtë Gjykatë, iu kërkua Njesisë të
11 bënte, të ndihmonte me transkriptimin e dosjes së Kuçit të 3
12 shtatorit 2023.

13 Në bazë të këtij email ju mund ta shihni që ka thënë që
14 nuk jemi në gjendje të bëjmë transkriptimin për shkak të
15 cilësisë së audios. Mund ta shihni në email.

16 PË. Po. Besoj kjo ka ndodhur përpara se të përfshihesha unë
17 këtë çështje.

18 PY. Po. Ta krahasojmë këtë me transkriptin e ZPS-së për të
19 njëjtin material.

20 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] I lutem Sekretarisë transkriptin
21 e plotë të vizitës së z. Kuçi të 3 shtatorit 2023, 106-ET edhe
22 të nxirrni ju lutem faqen 137. Të shohim faqen 137.

23 Këtu shohim emërtimin e dosjes rreshtin 8 dhe 9, ku
24 thuhet ky incizim është përforcuar dhe transkriptuar me një
25 transkript tjetër.

1 Shkojmë deri tek faqja 141 që të shohim sa i hollësishëm,
2 të krijojmë një ide sa i hollësishëm është transkripti.
3 Faleminderit.

4 PY. Do t'ju bëj të njëjtën pyetje. Për mendimin tuaj, si
5 shpjegohet ky dallim mes ZPS-së dhe asaj që ka thënë Njësia e
6 Përkthimit lidhur me cilësinë e audios dhe si mund ta
7 shpjegoni ju këtë dallim?

8 PË. Për rrethanat besoj se janë të ngjashme. Edhe një herë
9 theksoj, me gjithë respektin që kam për përkthyesit dhe
10 transkriptuesit, unë, personalisht, nuk e di se sa të aftë
11 janë këta persona për audiot e padeshifrueshme. Unë do të
12 kisha përdorur persona që janë të aftë për ta bërë këtë punë.
13 Megjithatë, ne këtu shohim që pa pasur informacionin
14 kontekstual është shumë e vështirë që të kuptohet audioja. Ky
15 është minimumi. Është shumë e vështirë që të kuptohet. Pra,
16 duke pasur më shumë informacion për kontekstin është më e
17 thjeshtë.

18 PY. Ne nuk e kemi aftësinë as për aftësitë e personelit të
19 ZPS-së që është përfshirë apo që ka kryer transkriptime?

20 PË. Unë nuk e kam këtë informacion.

21 PY. Po për faktin që personeli i ZPS-së ka pasur qasje në
22 audiot si të përforcuara dhe të papërforcuara, mendoni se ka
23 pasur kjo ndikim në transkriptet e tyre?

24 PË. Duhet bërë një analizë, në fakt, midis audiove të
25 përforcuara dhe të papërforcuara. Është praktikë e njohur, po

1 nuk është praktikë e mirë nga perceptimi i të folurit dhe
2 transkriptimit forensik. Sepse vërtetë përforcimi rrit nivelin
3 e audios edhe qëllimi është që të hiqen vetëm zhurmat që
4 sinjali të jetë më i qartë, tingujt të jenë më të qartë. Edhe
5 një herë, me gjithë respektin për personat që e kanë kryer
6 punën, nuk të ndihmon kjo teknikë të kuptosh më mirë bisedën
7 apo si funksionon i foluri.

8 Pra, vërtetë është bërë një përforcim i cilësisë së
9 audios, mbase kur ke një audio të përforcuar dëgjon diçka më
10 shumë që s'e ke dëgjuar tek audio e papërforcuar. Por pyetja
11 është, a po dëgjon vërtetë diçka apo je nën efektin ndikues?
12 Duhet zgjedhur një metodë apo një tjetër dhe idealisht duhet
13 të ketë persona idealisht transkriptues të aftë të cilët duhet
14 të kenë një strategji për të eksperimentuar, për të kuptuar
15 cili është efekti i audiove të përforcuara. Dhe mesa kuptoj
16 unë, nuk ka ndodhur në këtë rast.

17 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Znj. Menegon.

18 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Po, është koha e përshtatshme
19 për të bërë pushimin. Po thjesht dua të pyes Prokurorinë a do
20 t'i nxjerrin materialet, kur mendon që t'i nxjerrin
21 materialet? Sepse me sa kuptoj unë kam harruar, në fakt, ju
22 kërkoj ndjesë, se unë kur kam çuar email nuk e kisha vendosur
23 ZPS-në për dijeni.

24 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mund të na jepni përgjigjen
25 z. Hafetz?

1 Po ndërkohë i lutem Sekretarisë të nxjerrë dëshmitaren
2 nga salla.

3 Znj. Fraser, do të rifillojmë bashkë në orën 11.30.

4 [Dëshmitarja përfundon dëshminë]

5 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po, z. Hafetz.

6 Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit që na thatë në orën
7 11.02 që nuk na keni përfshirë fare në email që keni dërguar
8 ditën e enjte, as nuk jemi përfshirë në email ku jeni ankuar
9 sot në mëngjes me hollësi, jeni ankuar se nuk i kemi
10 përmbushur kërkesën e tyre për një email që s'e kemi marrë
11 fare. Dhe sot kemi marrë në një email, pasi më thanë në
12 Gjykatë që s'kemi çuar materialet, vetëm ne na çuan një email
13 ku na thanë diçka nuk ka shkuar mirë. Nuk e di çfarë nuk shkoi
14 mirë dhe s'po komentoj. Po do kishte qenë më transparente që
15 të na e bënit, t'ia dërgonit këtë email të gjitha palëve të
16 përfshira ku të theksonin që fajin e kishte Mbrojtja që s'e
17 kishte përfshirë fare Prokurorinë dhe vijnë këtu dhe na bëjnë
18 përgjegjës se nuk ju jemi përgjigjur email.

19 Përgjigja ime për znj. Menegon është që do t'ua dorëzojmë
20 këtë material sapo që të mundemi.

21 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull. Tani kemi
22 transparencë lidhur me komunikimin, e zgjidhëm këtë gjë,
23 kështu që të ndjekim hapat e nevojshëm.

24 Znj. Menegon edhe sa pyetje do të keni ju dhe sa kohë ju
25 nevojitet më saktë duke e mbajtur parasysh se ne i kemi lexuar

Dëshmitarja: Helen Fraser (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Menegon

Faqe 45

1 raportet dhe janë kërkuar për pranim sikurse dhe dëshmia. Me
2 për afërsi dhe sa kohë do ju nevojitet?

3 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Të njëjtën kohë që kisha
4 kërkuar, do të kem nevojë dhe për një orë e gjysmë.

5 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

6 Në rregull. Do të bëjmë pushimin deri në 11.30 dhe do të
7 kthehemi në sallë në orën 11.30.

8 --- Pauza fillon në orën 11.04

9 --- Seanca rifillon në orën 11.33

10 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem
11 silleni dëshmitaren në sallë.

12 [Dëshmitarja vijon dëshminë]

13 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mirë se erdhët, profesor.

14 Znj. Menegon, fjala për ju.

15 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
16 Gjykatës.

17 PY. Znj. Fraser, do të vazhdojmë me pyetjet për të paktën një
18 orë e gjysmë, me të njëjtat lloje pyetjesh.

19 Ne i kemi kërkuar dy përkthyesve të pavarur, që njëri
20 është Hysni Reçica dhe një tjetër një kompani përkthimesh, që
21 të përkthenin dhe të zbardhnin apo të transkriptonin dy pjesë
22 të shkurtra të vizitës së Kilajt të 6 nëntorit [Sipas
23 përkthimit] 2023.

24 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Dhe dëshiroj që për pyetjet e
25 radhës, së pari t'i kërkoj Sekretares të paraqesë në ekran

1 segmentin apo fragmentin e parë që ka të bëjë me vizitën e
2 Kilajt, që është P109-ET, në faqen 3. Ju lutem vendoseni në të
3 majtë të ekranit transkriptin. Faqja 3, duke filluar nga
4 rreshti 8, deri në faqen 4, në rreshtin 7.

5 Gjithashtu, do ju kërkoja që të kaloni në të djathtë të
6 ekranit një dokument tjetër që është dokumenti 1D39.1, në
7 faqen 6. Ky është transkripti që ka bërë z. Hysni Reçica në
8 përgjigje të pyetjes së bërë nga Mbrojtja e Thaçit. Në
9 përgjigje, pra, të Mbrojtjes së Thaçit që kërkonte
10 transkriptimin e të njëjtës file, të së njëjtës dosje të
11 vizitës së Kilajt me datën 6 nëntor [Sipas përkthimit]. Pra,
12 në të djathtë të ekranit do shikoni transkriptin e vizitës nga
13 z. Reçica.
14 PY. Mund të shikoni aty që ka vendosur me të kuqe fjalën
15 "Vllaznim".

16 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Dhe përsëri do i kërkoj
17 Sekretares që të paraqesë në ekran transkriptin e kompanisë së
18 përkthimit të transkriptimit të cilit i kemi kërkuar që të
19 bëjë zbardhjen e vizitës së z. Kilaj te z. Thaçi.

20 Mund të shikoni që fillon në të njëjtën mënyrë.

21 Po të kalojmë më poshtë në faqe mund ta shikojmë
22 dokumentin deri në fund të faqes, dhe ndërkohë mund të
23 vazhdojmë me faqen tjetër. Pra, në fillim të faqes thuhet:
24 "Folësi 1" -- thuhet "Vllaznim", po nuk jam tërësisht i sigurt
25 për emrin. Jepet në kllapa.

1 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Ndërkohë që do ju kërkoja që të
2 kalonim tek transkripti tjetër, tek faqja 4, tek rreshti 7.
3 Pak më sipër në faqe, nëse mundeni.

4 PY. Dhe këtu tek rreshti 4 thuhet: "Vllaznim, si je".

5 Profesore Fraser, pra kemi parë tre transkripte të
6 ndryshme të së njëjtës dosje audio që janë shumë të
7 hollësishme, ndërkohë që dosjet përfshijnë emrat të ngjashëm,
8 si për shembull, si të këtij personi.

9 Çfarë mund të thoni ju lidhur me cilësinë e dosjes në
10 audio? Domethënë çfarë ju tregojnë këto transkripte?

11 PË. Këto transkripte duken në mënyrë të arsyeshme të
12 ngjashme. Kështu që ndoshta dosja në audio në këtë rast është
13 e qartë.

14 PY. A do të thotë që me dosje më të qarta dhe me audio më të
15 qarta mund të bëhet një rishikim i kujdesshëm dhe rezultatet
16 mund të jenë më të afërta?

17 PË. Po thonit, po flisnit për "përkthyes të anshëm"?

18 PY. Jo, jo, e kisha fjalën për "disa përkthyes".

19 PË. Po, tani e kuptoj. Po, absolutisht, po.

20 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Tani do i kërkoj Sekretares që
21 të paraqesë në ekran fragmentin e parë të vizitës së Kilajt që
22 e përmendëm dhe në deklaratën hapëse. Do ju kërkoja që të
23 vendosni transkriptin e ZPS-së që mban numrin P109-RT nga
24 faqja 55, duke filluar nga rreshti 12. Faleminderit. A mund ta
25 kaloni ngadalë deri në faqen 58, rreshti 7, në mënyrë të tillë

1 që të mund ta shohim se sa i hollësishëm është ky transkript.
2 Faleminderit. Pra, shohim që është bërë një zbardhje e
3 transkriptit në rreth katër faqe.

4 Znj. Sekretare, në të djathtë të ekranit do ju kërkoja që
5 të paraqisnit një tjetër dokument që mban numrin e
6 identifikimit 1D38.1, faqja 6, që është përgjigja e dhënë nga
7 z. Hysni Reçica kërkesës së bërë prej nesh për të zbardhur të
8 njëjtin dokument. Le të shohim faqen 6.

9 PY. Atëherë, përgjigja e tij për segmentin B1 thotë: "E është
10 i paqartë, e padëshifrueshme". Nuk ka arritur të zbardhë
11 asgjë, të transkriptoje asgjë.

12 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Ndërkohë, tani do i kërkoj
13 Sekretares që të paraqesë një dokumentin tjetër që është
14 përdorur nga kompania nga Euridias në përgjigje të kërkesës së
15 bërë nga mbrojtja e Thaçit për të transkriptuar të njëjtën
16 dosje në versionin audio. Viojtmë më poshtë vazhdojmë tek
17 faqja tjetër.

18 PY. Atëherë, për ZPS-në, atëherë, zbardhja është bërë e
19 ndryshme nga pjesa e zbardhjes që kemi në të djathtë të
20 ekranit.

21 Z. Reçica nuk ia ka dalë që të zbardhë diçka. Euridita ka
22 bërë një zbardhje pak me disa fjalë të ndryshme, po prapë
23 është shumë pak në kuptimin e sasisë së prodhuar. Ndërkohë që
24 po të shikoni pjesën e ZPS-së, kjo është me shumë fjalë dhe
25 shumë e detajuar. Çfarë mund të thoni lidhur me këto dokumente

1 që sapo patë?

2 PË. I takon që ka shumë dallime, domethënë i takon që audioja
3 ka qenë më pak e qartë, në veçanti kur flitet për personat që
4 kanë bërë zbardhje pa njohuri, pa dijeni tekstuale, të cilët
5 kanë pasur mundësi që të dëgjojnë shumë më pak sesa versioni i
6 ZPS-së.

7 PY. Në rregull, faleminderit. Tani le të diskutojmë pak të më
8 tepër në përgjithësi për mbështetshmërinë e transkripteve të
9 ZPS-së. Çfarë informacioni do prisnit ju që të merrnit për të
10 konfirmuar që një transkript i caktuar është transkript i
11 besueshëm?

12 PË. Për të konfirmuar që një transkript është i besueshëm -
13 dhe përsëri dëshiroj të theksoj që e kam fjalën këtu për
14 regjistrimet forensike dhe për zbardhjet forensike që janë një
15 kategori e posaçme, e veçantë e transkripteve - pra, gjëja e
16 parë është që transkriptuesit të kenë aftësi të demonstrueshme
17 në deshifrimin e versioneve të paqarta në audio. Dhe po ashtu
18 do ishte me rëndësi që unë të siguroja që ata të kishin
19 ndjekur një metodologji ose një proces të caktuar. Ndërkohë që
20 unë personalisht kam një proces të caktuar, ndërkohë të tjerët
21 kanë t; tjera procese që ndjekin. Sepse u mundova ta shpjegoj
22 edhe pak më herët që akoma nuk kemi praktika më të mira që
23 janë gjerësisht të pranueshme. Shpresoj që të kemi zhvillime
24 pozitive në të ardhmen, por aktualisht nuk është kemi praktika
25 më të mira që janë gjerësisht të pranueshme. Pra, në rastin e

1 fjalë unë do dëshiroja që të shikoja që është ndjekur, të
2 demonstrohej që është ndjekur një praktikë e caktuar dhe si
3 minimum transkriptuesit së pari do ishte dashur që të
4 transkriptonin pa informacion kontekstual dhe pa i parë
5 transkriptet e njëri-tjetrit. Pra, thjesht të transkriptonin
6 në mënyrë të pavarur përpara sesa të bëhej krahasimi. Ky do
7 ishte hapi i parë. Kjo do na kishte dhënë ca informacion
8 lidhur me atë çfarë mund të dëgjohej nga transkriptuesit, me
9 aftësi ose profesional vetëm nga versionin në audio.

10 Më pas dëshiroj që të shikoj ca hapa të tjerë, dhe në
11 fushën tonë ne kemi disa dasi, kemi disa dallime sepse disa
12 persona dëshirojnë ose kanë dëshirën që t'i japim ca
13 informacione të përgjithshme për sa i takon natyrës së
14 transkriptimit, ca të tjerë preferojnë që të krahasojnë
15 transkriptet me kolegët e tjerë dhe të punojnë me njëri-
16 tjetrin. Por, pavarësisht qasjes ose rrugës së ndjekur është
17 shumë e rëndësishme që të vërtetohet një lloj procesi ose
18 metodologjie e punës. Po ashtu transkriptuesit duhet të jenë
19 të mbrojtur nga informacioni i hollësishëm për çështjen
20 gjyqësore që mund t'i shërbejë rezultatit të gjykimit. Dhe kjo
21 ka të bëjë me procesin dhe procedurën, metodologjinë që ndiqet
22 nga shkenca të ndryshme forensike, që ja u shpjegova pak më
23 herët. Pra, ne presim që të ketë një lloj ndarje midis palëve
24 në proces gjyqësor dhe punës për transkriptimin ose punës së
25 transkriptuesit.

1 PY. Në rregull, mirë atëherë. Në këtë rast çfarë përfundimi
2 keni ju lidhur me mbështetshmërinë dhe besueshmërinë e
3 transkripteve të ZPS-së mbështetur në informacionin që ju kemi
4 thënë ju?

5 PË. Mbështetshmëria është e ulët, jo në kuptimin që unë mund
6 të them me siguri që transkriptet janë të gabuara, se nuk mund
7 ta them dot këtë gjë, por mund të them që nuk mund të
8 mbështetemi në të si transkripte mjaftueshëm të sakta për
9 procesin gjyqësor.

10 PY. Na e shpjegoni se për cilat arsye arrini në këtë
11 përfundim ose na bëni një përmbledhje se cilat janë aspektet e
12 identifikuara në raportin tuaj. Konkretisht i referohem pjesës
13 7.4, Përshkrimi i Raportit, në faqet përkuese të raportit
14 tuaj. Si keni mbërritur në përfundimin që mbështetshmëria
15 është e ulët?

16 PË. Për arsyet që sapo ju shpjegova, për faktin që nuk kemi
17 aftësi të demonstrueshme për deshifrimin e dosjeve në audio.
18 Kjo nuk do të thotë që transkriptuesit nuk janë me përvojë.
19 Duhet ta theksoj edhe një herë që kam respekt për përkthyesit,
20 për transkriptuesit që punojnë në këtë fushë. Jam e sigurt që
21 kanë shumë përvojë në fushë, megjithatë ekspertiza dhe përvoja
22 janë dy gjëra të ndryshme. Ne kemi nevojë për ekspertizë në
23 këtë fushë, jo vetëm thjesht për përvojë. Po ashtu mungesa e
24 metodologjisë së ndjekur e një procesi të caktuar hap pas hapi
25 në mënyrën që sapo ja u shpjegova, edhe kjo në vetvete çon në

1 përfundimin që s'kemi një proces, një metodologji të
2 përcaktuar me hapa të qartë që janë të rëndësishme për
3 transkripte të besueshme. Në veçanti kur flitet për
4 transkripte që do të mbështeten -- ku do të mbështeten
5 përkthimet dhe kur përkthimet do të përdoren në një ambient
6 gjykatë, situata këtu bëhet edhe më e komplikuar.

7 Megjithatë nuk ceka temat që janë mbuluar në pjesën 7.4.

8 Megjithatë në qoftë se keni pyetje mund të mi bëni ato.

9 PY. Po vulat e kohës a mendoni që janë një prej elementëve që
10 cenojnë mbështetshmërinë e transkripteve?

11 PË. Ka më shumë aspekte sesa shihen në mënyrë të
12 drejtpërdrejtë në transkript, si për shembull, mungesa e
13 vulave të kohës, unë nuk ja them dot nuk ja shpjegoj dot me
14 fjalë se sa të vështira bën kjo procesin e vlerësimit të
15 cilësisë së këtyre transkripteve dhe të këtyre përkthimeve. Se
16 jo vetëm se është e pamundur që të ndiqet transkripti, për më
17 shumë sesa disa rreshta përkundrejt versionit në audio, por e
18 bën edhe shumë të vështirë që një transkript të krahasohet me
19 një transkript tjetër ose një transkript të krahasohet me një
20 përkthim e kështu me radhë. Unë personalisht asnjëherë nuk do
21 bëja transkriptim pa përcaktuar në hollësi dhe me saktësi
22 kohën kur janë thënë fjalët që pretendohen që të jenë zbardhur
23 në transkript. Pra, sepse e thashë që kjo është shumë e
24 rëndësishme për rishikimin dhe për krahasimin e transkriptit
25 dhe me përkthimet.

1 PY. Ju thatë që kishte shumë pikëzim ose shenja pikësimi të
2 sofistikuara. Çfarë mendoni lidhur me këtë praktikë? Mund ta
3 shpjegoni pak më tepër?

4 PË. Këto tekste duken sikur janë tekste të kohëve të fundit
5 më shumë sesa transkripte të gjuhës së folur, se gjuha e
6 shkruar është tjetër gjuha e folur është tjetër. Në gjuhë të
7 shkruar ne përdorim shumë shenja pikësimi, për shembull,
8 përdorim pika, presje, thonjëza, e të tjerë. Ndërkohë që kur
9 flasim për gjuhën e folur, që është karakteristik e zbardhjeve
10 ose e praktikë e transkripteve, të paktën praktika ime është e
11 tillë, jam e sigurt që disa kolegë bien dakord me mua ndërkohë
12 që të tjerë mund të kenë ide të tjera, domethënë ideja është
13 që shenjat e pikësimit të jenë minimale për një transkript që
14 mendohet që të ndiqet vetëm me zë, domethënë të bëhet thjesht
15 dalja e asaj çfarë dëgjohet me audio. Por nga ana tjetër
16 pikëzimi është një interpretim i ritmit të tekstit apo
17 elementë të tjerë të cilët janë të dëgjueshëm ose janë të
18 shqueshëm në veshin e atij që bën zbardhjen. Pra, shenjat e
19 pikësimit interpretohen në mënyrë të tillë që përkthyesit ose
20 transkriptuesit i japin përshtypje, pra, që bëhet fjalë më
21 tepër për një tekst të shkruar sesa një tekst të dëgjuar.

22 PY. Këto aspekte që sapo identifikuat, a lidhen me procesin e
23 duhur ose metodologjinë e duhur për sa i takon transkripteve
24 forensike? Nuk flasim këtu për transkripte burokratike apo jo?

25 PË. Po, po. Unë gjithmonë po flas në përgjithësi, domethënë

1 po flas për transkriptet forensike. Nuk e kam fjalën për
2 transkriptet burokratike që janë tërësisht tjetër çështje,
3 tjetër gjë.

4 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Do t'i kërkoj Sekretares tani të
5 paraqesë në ekran një tjetër provë materiale që është P110-ET,
6 në faqen 221, në rreshtin 1. Ky dokument është transkripti i
7 ZPS-së i vizitës së Smakajt më 7 nëntor 2023.
8 PY. Do e shohim dokumentin, pastaj do ju kërkoj që të
9 komentoni disa prej aspekteve të transkriptit. Të shohim
10 rreshtin 1, të faqes 222.

11 Besoj që e shikoni që në rreshtin e parë thuhet: "Artan
12 Behrami: [Imiton dikënd] [E padëshifrueshme]".

13 Çfarë mund të na thoni ju ne lidhur me këtë lloj komenti
14 nga transkriptuesi?

15 PË. Këto janë pyetje shumë të detajuara, shumë të
16 hollësishme. Nuk është se e kam studiuar me kaq shumë hollësi,
17 sepse po më thoni që të bëj interpretimin për gjëra të cilat
18 nuk i kam parë me kaq shumë hollësi. Megjithatë le të shohim
19 rreshtin e parë "Imiton dikë". Kur thua interpreton dikë është
20 interpretim i domethënë është një lloj interpretimi i situatës
21 që ka bërë përkthyesi apo transkriptuesi. Pra, këto
22 transkripte apo përkthimi vendosen më tepër me shkrim sesa
23 ekziston në versionin në audio, domethënë nga ta di unë që ky
24 personi po bën imitimin e dikujt. Nuk kemi nga ta dimë.

25 PY. Në raport ju gjithashtu përmendni si një çështje

1 problematike interpretimin e tingujve të ndryshëm. Edhe ju
2 thoni që interpretimi është më i gjerë sesa mund të jetë e
3 pranueshme.

4 PË. Po. Në fakt, efektet zanore janë të shtjelluara më tepër,
5 domethënë, shkojnë përtej asaj çfarë dëgjohet. Se, për
6 shembull, dëgjon diçka që mund të jetë si zhurmë letrash
7 fletësh po pastaj për çfarë bëhet fjalë? Bëhet fjalë për një
8 kthim faqeje ose, për shembull, në qoftë se jepet një
9 specifikim aty që hapet dera ose mbyllet dera, çfarë do të
10 thotë kjo që u hap dera dhe po futet dikush apo jo? Domethënë
11 shpjegimet e interpretimet janë të zgjeruara.

12 PY. Ju thoni që vini re që nuk respektohet konfidenca,
13 konfidencialiteti në pjesë të ndryshme të transkriptit. Pse
14 është problem ky?

15 PË. Duket sikur ka dy dallime, domethënë, gjërat ose janë të
16 padëshirueshme nga njëra anë ose nga ana tjetër jepen shumë të
17 hollësishme, domethënë, bëhet interpretim i hollësishëm jo
18 vetëm sa i takon fjalëve që dëgjojnë, por edhe zhurmave të
19 ndryshme ose, për shembull, pikave shenjave të pikësimit që
20 përdoren ose efekteve zanore të ndryshme që përkthehen në
21 fjalë në transkriptim. Kështu që kjo është audio e një cilësie
22 shumë të dobët. Këtë e kemi diskutuar që prej fillimi. Dhe do
23 të kishte -- do ishte dashur që të kishte një lloj dallimi sa
24 i takon besueshmërisë ose qartësisë së përkthyesit ose të
25 transkriptuesit në mënyrë të tillë që gjykata ta kuptonte se

1 kur ishte më i bindur transkriptuesi dhe kur ishte më pak i
2 bindur. Këto janë elementët vegjël por që kanë rëndësi.
3 PY. Duke marrë parasysh dokumentet që ju janë dhënë ju në
4 veçanti vizita e Kilajit dhe vizita tjetër, ju thatë që nuk e
5 kuptoni shqipen po sigurisht që jeni eksperte dhe jeni në
6 gjendje, jeni e aftë që të identifikoni audion. A mund të
7 thoni, me aq sa keni dëgjuar, që personi në audio është i
8 padëshirueshëm?
9 PË. Po.
10 PY. Tani sa i takon mbështetshmërisë, bazueshmërisë së
11 transkripteve të ZPS-së, a mund të themi që një prej disa
12 problemeve është fakti që përkthyesit kanë qenë pjesë e stafit
13 të ZPS-së për sa i takon pjesës së kontekstit?
14 PË. Po. Edhe një herë dua ta theksoj që kam respekt për
15 profesionistët. Besoj se e trajtova dhe më përpara këtë
16 element që është absolutisht me vend që gjatë hetimeve
17 hetuesit të mund të ndihmohen nga përkthyesit. Në fakt, është
18 e domosdoshme se nuk e bën dot punën pa përkthyesit.
19 Megjithatë, ndërveprimi i ngushtë midis përkthyesve dhe
20 hetuesve është praktikë e dobët në përgjithësi, dhe njihet
21 gjerësisht si praktikë e dobët në të gjitha fushat ose lëmitë
22 forensike. Dhe sa i takon provave forensike, domethënë, prova
23 forensike janë drejt fundit le të themi të një linje rreshti
24 të gjatë të shkencave forensike dhe që lidhen me përfshirjen e
25 analistëve, shkencëtarëve, pavarësisht termit, të cilët

1 punojnë drejtpërsëdrejti me hetuesit dhe është e rëndësishme
2 që të krijohet kjo lloj ndarje të cilën unë u përpoqa ta
3 shpjegoj gjatë seancës së paradites.

4 PY. Në rregull faleminderit. Që kur po flisnim herën e fundit
5 me juve ZPS-ja na ka dhënë informacion sa i takon stafit të
6 vet gjuhësor të çfarë roli kanë pasur ato për zbardhjet. ZPS-
7 ja në parashtrimin F906 shpjegon që asistentët gjuhësorë që
8 kanë zbardhur, kanë transkriptuar dokumentin janë përfshirë
9 dhe në aspekte të tjera të Çështjes 12 dhe të Çështjes 6 si
10 dhe në çështje të tjera të cilat kanë të bëjnë me krime lufte.
11 Më konkretisht, i referohem paragrafit 5 dhe 6 të raportit të
12 Prokurorisë. Nuk besoj se është e rëndësishme të paraqitet në
13 ekran.

14 Prokuroria thotë që të gjithë zbardhësit janë përfshirë
15 në zbardhjen ose transkriptimin dhe përkthimin e dëshmitarëve
16 dhe ose të provave shkresore, si në Çështjen 6 ashtu dhe në
17 Çështjen 12, domethënë çështje për krime lufte dhe çështje për
18 mosbindje gjykate. Dhe thonë gjithashtu që një prej personave
19 është i përfshirë edhe në kontrollim dhe sekuestrim në
20 ambientet e burgut [Sipas përkthimit].

21 Dhe sipas Shtojcës përkatëse të këtij parashkrimi të
22 protokolluar, dhe nuk dua që t'i përmend me emër, disa prej
23 transkriptuesve kanë punuar edhe si përkthyes të intervistave
24 të dëshmitarëve të ZPS-së dhe e kanë diskutuar -- pretendoj që
25 kanë diskutuar vizitën e z. Thaçi në paraburgim dhe disa prej

Dëshmitarja: Helen Fraser (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Menegon

Faqe 58

1 tyre kanë qenë gjithashtu të pranishëm gjatë intervistës së
2 ZPS-së së z. Thaçi në çështjen kryesore për krimet e luftës.
3 Dhe më konkretisht i referohem Shtojcës 2, faqes 2 dhe 2 të
4 parashtrimit të ZPS-së.

5 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, sapo më
6 informuan që ZPS-ja ka bërë nxjerrjen e një materiali sot
7 paradite. Kështu që do ju lutesha që të bëjmë një pushim prej
8 15 minutash në mënyrë të tillë që të rishikoj dokumentet e
9 nxjerra nga Prokuroria dhe më pas të bëj përshtatjet e
10 pyetjeve për dëshmitarin në qoftë se do jetë e nevojshme.

11 Janë dokumente të shkurtra me çfarë shoh, kështu që besoj
12 që 15 minuta mjaftojnë.

13 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Prokuroria, keni ndonjë
14 reagim?

15 Z. HAFETZ: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ju keni
16 konstatuar se kjo nuk është e nevojshme për marrjen në pyetje
17 të dëshmitares. Nuk kam ndonjë kundërshtim në qoftë se
18 avokatja dëshiron të bëjë një pushim, është në rregull nuk
19 është se ka ndonjë problem.

20 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] A mendoni që do ju bëjë më
21 efikase ky pushim prej 15 minutash, z. Menegon? Ndoshta do ju
22 ndihmojë për të shkurtuar marrjen në pyetje të dëshmitares
23 nëse do jetë e mundur?

24 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Unë nuk e di, nuk e kam qenë në
25 gjendje që të shikoj këto dokumente, por më duhet që të

Dëshmitarja: Helen Fraser (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Menegon

Faqe 59

1 rishikoj këtë dokument njëherë më pas të vendos në qoftë se do
2 ta shkurtoja apo jo. Domethënë më duhet të shikoj dokumentet
3 njëherë përpara se të vendos se cila do jetë ecuria e pyetjeve
4 për dëshmitaren.

5 Z. HAFETZ: [Përkthim] A mund të bëjë një propozim? Unë
6 propozoj që do ishte mirë që të vazhdohet me pyetjet për
7 dëshmitaren dhe pastaj të shikojë dokumentet dhe në qoftë se
8 identifikon se ka gjëra shtesë që duhet t'i bëjë pyetje
9 dëshmitares lidhur me dokumentet që ka lexuar mund ta bëjë
10 këtë pas pushimit.

11 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, unë e di
12 përmbajtjen e përgjithshme të dokumentit, një prej dokumenteve
13 shtojcave që është dhënë në listën e dokumenteve të
14 Prokurorisë, por dua që të shikoj se cilët përkthyes janë
15 përfshirë në cilat transkripte dhe mendoj që ky është
16 informacion shumë i rëndësishëm që do ketë ndikim mbi pyetjet
17 që do bëjë për dëshmitaren.

18 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Sa të konsultohen pak me
19 Zyrën Administrative.

20 [Gjykatësi i Vetëm këshillohet me Sekretaren e
21 Gjykatës]

22 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Znj. Menegon, do bëjmë
23 pushimin e drekës tani, dhe e kuptoj që për sa i përket
24 organizimit është e mundur, dhe pastaj do bëjmë dy seanca
25 pjesë pasdite. Dhe normalisht Prokuroria do të jetë do të ketë

Dëshmitarja: Helen Fraser (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Menegon

Faqe 60

1 mundësi të fillojë me pyetjet e tyre në pjesën e dytë të
2 pasdites. Duke e shpresuar që znj. Menegon të përfundojë
3 pyetjet e saj në pjesën e parë pas kthimit në sallë të gjyqit
4 në fillim të pasdites.

5 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit.

6 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Do bëjmë pushim tani. Ju
7 lutem shoqëroni dëshmitaren jashtë sallës së gjyqit.

8 [Dëshmitarja përfundon dëshminë]

9 Pushim tani dhe kthehemi në orën 1.30. Faleminderit.

10 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.31

11 --- Seanca rifillon në orën 13.31

12 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mund të sillni dëshmitarin
13 në sallë. Dhe përfitoj nga rasti të falënderoj të gjithë në
14 Gjykatë dhe jashtë saj për riorganizimin e seancës.

15 Do vazhdojmë tani deri në orën 3.00 pasdite, znj.
16 Menegon.

17 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Po.

18 [Dëshmitarja vijon dëshminë]

19 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mirë se vini, Profesor
20 Fraser. Do vazhdojmë deri në orën 3.00 të pasdites, pastaj do
21 bëjmë një pushim 15-20 minuta dhe do vijojmë deri në orën
22 4.00, që ta dini programin e pasdites. Faleminderit.

23 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit.

24 PY. Mirë se vini, Profesor Fraser. Gjatë pushimit të drekës,
25 ne morëm informacione shtesë nga ZPS-ja lidhur me procesin e

1 transkriptimit të bërë nga ata. Dhe përkatësisht ajo që kemi
2 marrë është një tabelë me transkriptet e përgatitura nga
3 përkthyesit me gojë të caktuar, për periudhën kohore konkrete,
4 dhe kemi marrë edhe gjithashtu kurrikulum vitet të redaktuar
5 të shtatë personave të përfshirë në krijimin e transkripteve
6 të ZPS-së të vizitave në qendrën e paraburgimit.

7 Tani do të paraqesim tabelën -- fillimisht, tabelën, me
8 qëllim që të shikoni mënyrën se si është dhënë informacioni
9 dhe pastaj do ta krahasojmë atë.

10 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Znj. Sekretare, a mund të
11 shfaqni në ekran SPOE00412757, pra, që të krahasojmë tabelën
12 me transkriptet.

13 PY. Kjo është informacioni i dhënë nga ZPS-ja. Do të bëj një
14 përmbledhje për juve, për pjesët me rëndësi.

15 Në këtë dokument ata kanë renditur 16 vizita të
16 zhvilluara me z. Thaçi, çështje -- të bashkëakuzuar në
17 Çështjen 06, ku një të paktën prej shtatë përkthyesve në fjalë
18 ka qenë ka qenë i përfshirë. Në tërësi, ata thonë, pra, ZPS-
19 ja, që kemi datën e fillimit dhe të përfundimit të
20 transkriptit. Pastaj kemi ato që kanë të bëjnë me vizitat për
21 të cilat janë ngritur akuzat dhe procesi i transkriptimit mesa
22 duket ka zgjatur dy vjet, pak më shumë se dy vjet.

23 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Do të doja të shfaqim në ekran
24 tani *kurrikulum vitet* të njërit prej personave të përfshirë në
25 procesin e transkriptimit. Znj. Sekretare, mund ta shfaqni në

1 ekran, është SPOE00411795, ky është *kurrikulum vite*, pra,
2 jetëshkrimi i SPO-0036-18.

3 PY. Bazuar në tabelën në djathtë që na ka dhënë ZPS-ja,
4 personi në fjalë ka punuar, pra, lidhur me transkriptet e
5 vizitës së Smakajt është rreshti 10 në tabelë.

6 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Znj. Sekretare, mund të shkojmë
7 pak më poshtë dhe dy transkripte që lidhen me vizitat e bëra
8 z. Selimi, që është i bashkëakuzuari i z. Thaçi.

9 Tani do të doja që të shikoni këtë jetëshkrim të
10 përkthyesit, ku thuhet që është shqiptar dhe pozita siç është
11 e shkruar aty është funksion mbështetës analisti. Aktivitetet
12 kryesore dhe përgjegjësitë, ka dhënë mbështetje analitike në
13 kontekst procedural të strukturuar, rishikuar dhe sintetizuar
14 informacion të ndjeshëm, bërë kërkime duke përdorur burime të
15 hapura dhe të kufizuara brenda kontekstit ligjor, ka krijuar
16 rezultatin e punimeve të tij, pra, në mënyrë të shkruar. Tani
17 sa i takon trajnimeve mund të shohim kemi, pra, titulli i
18 kualifikimit të marrë, diplomë, i diplomuar në shkenca
19 politike apo fushë që lidhet me të, dhe në fund mund të shohim
20 që gjuha amtare është shqipja.

21 PË. Po. Meqë jemi këtu a mund të më kujtoni pak cilin -- në
22 cilën pjesë në kolonë në tabelë në të djathtë ky person ka
23 punuar.

24 PY. Është rreshti 10 në vizitat e 9 shtatorit e z. Smakaj
25 dhe është dhe numri i tij është SPO-36-18. Pra, kontraktor.

1 Profesor Fraser, karakteristika e jetëshkrimit që sapo ju
2 thashë dhe theksuam çfarë përbën ky informacion për ju lidhur
3 me ndikimin e mundshëm të transkriptuesit që ka punuar në
4 incizimet nga qendra e paraburgimit për sa i përket vizitave
5 të z. Smakaj?

6 PË. Është shumë e vështirë për mua që thjesht të shoh diçka,
7 t'i hedh një shikim dhe të përgjigjem në atë çast në këtë
8 mënyrë siç më kërkoni ju. Mendoj që dy gjërat kryesore për të
9 cilat do të bëja pyetje mendoj, megjithatë nuk dua të arrij në
10 përfundime të nxituara, do pyesja a ka ndonjë mënyrë që të
11 shihet që ky person ka aftësi të vërtetuara apo aftësi në
12 lidhje me deshifrimin e incizimeve audio të padallueshme të
13 padëgjueshme. Dhe pastaj gjëja tjetër që do pyesja është sepse
14 duket nga ky dokument që ky person kishte funksion mbështetës
15 ligjor dhe kjo përfshin në shumë informacion kontekstual në
16 një mënyrë të pakontrolluar. Pra, këto do të ishin dy gjërat,
17 dy pyetje që do bëja.

18 Dua të theksoj që nuk më pëlqen me thënë të drejtën që
19 thjesht të shikoj diçka në çast dhe menjëherë të jap një
20 koment të fuqishëm lidhur me të, sepse ka gjëra që mund të
21 jenë të bazuara në atë që diskutuam sot në mëngjes dhe për të
22 cilat do të bëja pyetje.

23 PY. Për procesverbal, konstatoj në CV, vërej që kemi një
24 referencë këtu ku përmendet transkriptimi i incizimeve përmes
25 masave të fshehta apo audio e padallueshme.

1 PË. Dhe do të shtoja vetëm një gjë, sapo e pashë që hodha një
2 shikim të shpejtë.

3 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Mund të kthehemi tek faqja
4 paraprake.

5 DËSHMITARJA: [Përkthim] Faqe paraprake.

6 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Që lidhet me përvojën e punës me
7 ZPS-në.

8 DËSHMITARJA: [Përkthim] Kjo ishte -- po, është përvoja e
9 punës, aktivitetet kryesore. Pika 4, "siguroi saktësi dhe
10 konfidencialitet sipas standardeve institucionale".

11 A do të thotë kjo që saktësia e transkripteve bën fjalë
12 për saktësinë e transkripteve?

13 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

14 PY. Nuk kam informacion lidhur me këtë.

15 PË. Në qoftë se është kështu do të bëja pyetje se si, përmes
16 çfarë mënyre sigurohet që këto janë të sakta, sepse ne nuk
17 kemi si ta bazojmë të vërtetën. Pra, nuk e dimë përfundimisht
18 çfarë është thënë për të krahasuar transkriptet e reduktuara
19 për të arritur dhe për të vërtetuar, përcaktuar saktësinë e
20 tyre.

21 Pra, këto janë disa gjëra që i vërejta duke i hedhur një
22 shikim të shpejtë.

23 PY. Faleminderit. Sa i takon titullit që ky person kishte
24 brenda ZPS-së, nuk është përkthyes me gojë apo me shkrim,
25 është ka një funksion mbështetës analisti. A do të thonit ju a

Dëshmitarja: Helen Fraser (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Menegon

Faqe 65

1 *priori*, pra, në pamje të parë, që në pikat që përmenden në
2 jetëshkrim ky person duhet të jetë dikush që kishte një
3 interes në rezultatin e gjykimit apo hetimeve?

4 PË. Është e vështirë për mua ta them këtë gjë.

5 PY. Po a do të merrnit parasysh *a priori* që ky nuk është i
6 pavarur nga hetimet që të jetë në gjendje të bëjë, le të
7 themi, një transkriptim të pavarur pa qenë i ndikuar?

8 PË. Nuk marr këtë përshtypje nga ajo që shoh këtu.

9 PY. Faleminderit. Tani do t'ju bëj disa pyetje lidhur me një
10 jetëshkrim tjetër.

11 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Është SPOE00411775. Kjo është
12 jetëshkrimi i SPO-31-18.

13 PY. Bazuar në tabelën që është në anën e djathtë, ky
14 transkriptues është përfshirë në transkriptin e vizitave të
15 Fazliut, që është rreshti 1 në tabelë.

16 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Znj. Sekretare, nëse mund ta
17 shfaqni në ekran. Emri është -- kërkoj ndjesë, është rreshti 2
18 në tabelë, pra vizita e 2 korrikut e z. Fazliu. Shohim emrin e
19 tij, SPO31-18.

20 PY. Në bazë të dokumenteve të nxjerra nga ZPS-ja më herët, po
21 i referohem parashtimit të protokolluar F906-A03, ky
22 përkthyes ishte i pranë -- ka qenë i pranishëm gjatë 31
23 intervistave të ZPS-së apo kontakteve me dëshmitarët. Dhe
24 bazuar në parashtimin F906-A02, faqe 4, ai gjithashtu ka qenë
25 i përfshirë në shtatë intervista të tjera të ZPS-së apo

1 kontakte me personat, me dëshmitarët. Pra ai është -- ka
2 njohuri, njihet me dëshmitarët dhe në çështjet gjyqësore
3 kryesore -- në çështjen gjyqësore për krime lufte.

4 Tani mund të shohim se kombësia e tij është holandez dhe
5 pozicioni apo pozita e tij në ZPS është, punon në ZPS që nga
6 viti 2018 dhe është ekspert rishikues i dokumenteve,
7 përkthyes. Për shembull, pika e dytë përfshin përmbledhjen e
8 dokumenteve, përditësimin e bazës së të dhënave të ZPS-së,
9 identifikimin, krahasimin e origjinaleve me versionin e
10 përkthyer për të shmangur dyfishimet apo dokumentet e
11 dyfishuara, kërkimi dhe marrja e menjëhershme e materialeve
12 nga ZPS-ja që janë nga burimet e jashtme të dhënash.

13 Pajtoheni që detyrat e këtij personi duken më shumë si
14 analist sesa thjesht përkthim dhe transkriptim?

15 PË. Mesa jam në gjendje të kuptoj, nga ky shikim i shkurtër,
16 po.

17 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Znj. Sekretare, mund të kalojmë
18 në faqen 6 tani të jetëshkrimit.

19 PY. Dhe këtu mund të shohim se shkollimi dhe trajnimi
20 profesionalist i tij janë pjesë të redaktuara. Ne shohim aty
21 që shqipja është gjuha e tij, gjuha nënës. Për nevoja të
22 procesverbalit nuk përmendet në jetëshkrim, nuk ka asnjëherë
23 përmendje të transkriptimeve të mëparshme të incizimeve përmes
24 masave të fshehta apo audiove, audioincizimeve të padalluara.

25 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Tani mund të kalojmë tek faqja e

Dëshmitarja: Helen Fraser (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Menegon

Faqe 67

1 parë e CV-së.

2 PY. Bazuar në përmbledhjen e paraqitur për këtë staf dhe
3 përfshirjen e tij në përkthime me gojë por edhe rishikimin e
4 dokumentave çfarë mund të thuhet për ndikimin e mundshëm që ai
5 mund të ketë patur në punën e tij?

6 PË. Edhe këtu bazuar në këto informacione të shkurtra apo
7 këtë paraqitje të shkurtër të shumë gjërave që jam në gjendje
8 të kuptoj në mënyrë të kufizuar atë që por duket që konfirmon
9 ajo që ishte atë që është rasti mëparshëm që është, që ka
10 patur shumë ndërveprime midis punës lidhur me këtë çështje dhe
11 punës me materiale gjuhësore.

12 PY. Faleminderit. Tani do t'ju tregoj një jetëshkrim tjetër
13 të fundit.

14 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Znj. Sekretare, mund të shfaqim
15 në ekran SPOE00411417. Ky është jetëshkrimi i LA-3.

16 PY. Bazuar në tabelën që na u dha nga ZPS-ja, që është akoma
17 në anën e djathtë të ekranit, ky person ka qenë i përfshirë në
18 krijimin apo rishikimin e 13 transkripteve të vizitave në
19 qendrën e paraburgimit bërë z. Thaçi apo të bashkëakuzuarve të
20 tij. Në veçanti vizita e z. Fazliu e 2 korrikut; vizita e
21 Smakajt e 9 shtatorit, rreshti 10; vizita e Smakajt me 7
22 tetor, rreshti 16. Emri i tij është LA-3 dhe siç e shihni, për
23 shembull, në rreshtin e dytë ai është njeri prej personave
24 përgjegjës për rishikimin e tërësishëm përfundimtar.

25 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Znj. Sekretare, mund të shkojmë

1 pak më poshtë më ngadalë që të shohim sa shpesh paraqitet emri
2 i tij në "Rishikimin, në vlerësimin përfundimtar".

3 PY. Pra, mund ta shikoni që ky person është përgjegjës në
4 pjesën më të madhe të rasteve për rishikimin përfundimtar.

5 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Për informacion tuaj dua t'ju
6 informoj se bazuar në parashtimin e nxjerrë nga ZPS-ja më
7 herët, po i referohem këtu parashtimit F906803, faqe 24, ky
8 përkthyes ka qenë i pranishëm gjatë 64 intervistave me
9 dëshmitarë apo kontakte me ta, thirrje telefonike, dhe sipas
10 parashtimit F906802, faqe 23, ka qenë po ashtu i pranishëm
11 gjatë 17 intervistave apo kontakteve me dëshmitarë thirrje
12 telefonike e tjera.

13 Mund të rishikojmë jetëshkrimin, të shohim jetëshkrimin e
14 tij. Mund të shohim se në shtetësia e tij, kombësia e tij
15 është shqiptar. Gjuha gegë dhe toskë shqip. Ka më shumë se 25
16 vite përvojë.

17 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Mund të kalojmë në faqen tjetër,
18 ju lutem, në fund, rreshti i fundit i jetëshkrimit.

19 PY. Përvoja, përvoja ndërkombëtare i referohet
20 "transkriptimit përkthimit të qindra orëve të incizimeve në
21 gjuhën shqipe, përfshirë ato në qendrën e paraburgimit,
22 incizime të tjera, përgjime, pra, përgjime të incizuara" dhe
23 kemi, pra, ka punuar për KSC, ZPS-në dhe kemi informacion për
24 detyrat e tij.

25 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Tani kalojmë në faqen e fundit.

1 Si diplomë ka një diplomë përkthimi me shkrim dhe përkthimi me
2 gojë dhe shqipja është gjuha e tij amtare.

3 PY. Tani do të doja t'ju bëj një pyetje të ngjashme me atë që
4 bëra më herët. Duke patur parasysh se ky person ka qenë i
5 përfshirë në a *priori* në krijimin apo rishikimin, vlerësimin e
6 disa transkripteve të disa vizitave, ka qenë i pranishëm në më
7 shumë se 70 intervista apo kontakte me dëshmitarë, a mund të
8 na thoni diçka lidhur me ndikimin e mundshëm që ky person mund
9 të ketë patur?

10 PË. Mendoj që është e ngjashme me atë që thashë më herët,
11 pra, shohim këtë lloj ndërveprimi midis informacionit
12 kontekstual dhe punës së bërë me transkripte dhe përkthime, që
13 kemi diskutuar. Dhe siç e thamë më herët kjo nuk është
14 praktikë e mirë. Shohim gjithashtu theks të vënë në aftësitë e
15 përkthimit me gojë dhe me shkrim dhe nuk pashë ndonjë saktësim
16 apo informacion për aftësi të vërtetuara të transkriptimit të
17 incizimeve audio të padallueshme, të cilësisë të dobët. Mendoj
18 që pashë diku diçka për rishikimin për saktësi, verifikimin e
19 saktësisë, por edhe këtu do të theksoja se njerëzit që kanë
20 punuar në këtë fushë nuk flasin për verifikim saktësie kur nuk
21 kemi versionin bazë të vërtetë, pra, me fjalë të tjera të
22 njohur, transkriptin e saktë faktualisht, të njohur për ta
23 krahasuar me transkriptin, me transkriptet aktuale.

24 Pra, mendoj që më e afërta që mund të bëjmë në terma të
25 praktikës së mirë në këtë lloj pune, dhe ne do të kërkonim në

1 këtë rast që të bënim një testim të transkriptuesve në
2 materiale duke u mbështetur, duke përdorur materiale të
3 njohura, pra, materiale të vërtetuara faktike dhe
4 transkriptuesit bëjnë transkriptin sipas udhëzimeve tona, dhe
5 në këtë mënyrë ne jemi në gjendje të vlerësojmë ata duke
6 përdorur transkripte të njohura të vërtetuara. Në këtë mënyrë
7 vlerësohen aftësitë e tyre, saktësia lidhur me transkriptet e
8 njohura dhe pastaj kemi më shumë besim për t'ju besuar atyre
9 që të punojnë në situatën konkrete, pra, sipas përkufizimit të
10 kontekstit forensik. Por ne nuk e kemi këtë përmbajtje të
11 njohur, kjo është e gjithë çështja, pra, pika kyçe e
12 transkriptit.

13 PY. Lidhur me këtë, sipas njohurisë suaj, a ka ndonjë formë
14 trajnimi për transkriptim forensik?

15 PË. Në këtë jetëshkrim?

16 PY. Jo. A ekziston?

17 PË. Mendoj që zakonisht bëhet nga njësi të ndryshme që
18 punojnë. Nuk jam e sigurt që mund të bëhet në mënyrë të
19 pavarur dhe të gjendet një certifikatë e transkriptimit
20 forensik. Por pjesa më e madhe e njësive për të cilat unë di
21 bëjnë këtë lloj pune dhe kanë një lloj trajnimi fillestar,
22 proces trajnimi për transkriptuesit e tyre.

23 PY. Faleminderit.

24 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, do të doja
25 të paraqes këtë tabelë si dhe jetëshkrimin si provë materiale.

1 Dhe doja të thoja që tani se synoj të paraqes të gjitha
2 jetëshkrimet, sepse vlerësoj që janë relevante për qëllim të
3 vërtetimit sepse tregojnë ngjashmëri *a priori* të përfshirjes
4 me dëshmitarët e ZPS-së. Nuk e di nëse dëshirojnë të vendosni
5 lidhur me pranueshmërinë e tyre që tani por do t'i paraqisja
6 parashtrimet e mia apo argumentet e mia jo në prani të
7 dëshmitares.

8 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ndonjë koment nga
9 Prokuroria?

10 Z. HAFETZ: [Përkthim] Mbështesim pranimin e të gjitha
11 jetëshkrimeve, për aq sa ato janë relevante deri tani të
12 paraqitura. Nuk kemi ndonjë kundërshtim.

13 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Do sugjeroja atëherë që për
14 tani meqë ky dokument u përdor dhe dokumentet e tjera të
15 përdorura të jepet një numër prove materiale provizor dhe
16 merremi me çështjen e pranimi pastaj më vonë.

17 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Në rregull.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
19 Gjykatës. Dokumenti i parë SPOE004127 deri në 0021760 do të
20 marrë numrin e provës materiale provizore 1D00140.

21 Dokumenti tjetër SPOE00411795 deri në 00411797 dhe ai do
22 marrë numrin e provës materiale të përkohshme 1D00141.

23 Dokumenti i tretë është SPOE00411775 deri në 00411781. Do
24 marrë numrin e provës materiale 1D00142.

25 Dhe në fund dokumenti i fundit SPOE E00411417 deri në

1 00411420 ky do të marrë numrin e provës materiale provizore
2 1D00143.

3 Të gjitha janë të klasifikuara konfidenciale.
4 Faleminderit.

5 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit.

6 PY. Profesor Fraser, duke pasur parasysh profilin dhe
7 përfshirjen e mëparshme të transkriptuesve që ju tregova në
8 hetimet e ZPS-së, për shembull, kemi parë që njëri ishte
9 rishikues dokumentesh, tjetri kishte një funksion mbështetës
10 analisti, a tregojnë këto njëlloj afërsie midis këtyre
11 përkthyesve dhe hetuesve të ZPS-së? A tregon kjo një -- përbën
12 një arsye për të dyshuar lidhur me mbështetshmërinë apo
13 besueshmërinë e transkripteve që janë krijuar nga këta
14 transkriptues?

15 PË. Në kuptimin që -- atë që kam shkruar unë në raport dhe
16 nuk po them që ata janë të pasakta. Unë po them që janë të
17 pambështetshme në kuptimin që nuk mund të mbështetesh në to si
18 të sakta.

19 PY. Faleminderit. Tani dua të flas për atribuimin e zërit,
20 pra, se i kujt zë ishte. Për aq sa keni mundësi dhe jeni në
21 gjendje ta bëni, çfarë mund të na thoni për mënyrën se si ZPS-
22 ja ka bërë këtë?

23 PË. Mendoj që fola shkurtimisht për identifikimin e folësit
24 dhe atribuimin e zërit.

25 PY. Folët për folësin, pra, lidhur me identifikimin e folësit

1 dhe atribuimin.

2 PË. Pra, atribuimi i zërit i një folësi të caktuar është i
3 ngjashëm me transkriptimin, në kuptimin se mbështetet shumë më
4 shumë sesa njerëzit arrijnë ta kuptojnë në kontekst. Të gjithë
5 e pranojmë në mënyrë konfidenciale dhe të saktë çdo ditë ne
6 bëjmë këtë në mënyrë -- çdo ditë në jetët tona të përditshme,
7 Kjo na jep një përshtypje të fuqishme që ne po identifikojmë
8 ata përmes zërit, pra, persona të ndryshëm, por pothuajse në
9 çdo rast ne identifikojmë pjesërisht përmes zërit por
10 kryesisht atë identifikim e bëjmë falë kontekst.

11 Dhe kur marrim identifikimin e folësit e zgjedhim jashtë
12 kontekstit, për shembull, duke krijuar një incizim me audio
13 duke testuar aftësinë e njerëzve për të identifikuar zërat,
14 edhe këtu kemi bërë eksperimente të tilla, dhe kur kam bërë
15 vetë eksperimente të tilla, ka eksperimente të famshme të
16 shumta lidhur me këtë temë edhe këtu bëhet fjalë për zëra që
17 janë të afërt me anëtarët e familjes, shokë, miq, kolegë,
18 njerëz që janë të njohur për të dëgjuesin, ata bëjnë gabime të
19 shumta. Mendoj që kemi në të John Smith, eksperiment, pra,
20 njeri mund të mendojë që për shembull, me besim që të thoja
21 është John Smith, tjetri një emër, kështu po themi dhe pastaj
22 një dikush tjetër mund të thojë që nuk është ai. Dhe kemi një
23 lidhje të qartë këtu.

24 Kjo, pra, ka dekada dhe më herët që është bërë si
25 eksperiment. Studimi i parë që është bërë gjerësisht vjen nga

1 vitet '30 dhe lidhet me karakteristikat e veçanta të kësaj
2 çështje. Nuk ka informacion që unë e kam pasur çastin
3 informacion për mënyrën se si është bërë. Më duket që është
4 bërë më shumë në mënyrën intuitive. Dhe supozoj nuk jam e
5 sigurt që e shoh këtu, a thuhet në pjesë që ju mund të lexuat
6 ndoshta mund të më orientoni pak. Një gjë që vërejta
7 veçanërisht ishte koncepti në njërin prej dokumenteve që më
8 është dhënë mua se juve, i nderuar Gjykatës, duhet të ishit në
9 gjendje dëgjimit incizimet telefonike ku zërat janë të njohur
10 dhe krahas të krahasoheshin këto zëra me zërat e materialit --
11 e incizimeve, pra, materialit të incizimit të kësaj çështje.
12 Dhe kjo është diçka që njerëzit mendojnë që ne mund ta bëjmë,
13 që mund të dëgjojmë, pra, një zë në një incizim dhe pastaj ta
14 identifikojmë atë në një incizim tjetër. Kjo është edhe më pak
15 shumë më pak e besueshme apo diçka në të cilën mund të
16 mbështetesh sesa identifikimi i zërave të njerëzve që ju i
17 njihni ose që personi i njeh. Dëgjimi i një incizimi ku
18 njerëzit janë -- mendoj që kanë qenë incizimet telefonike në
19 burg, pra, nga brenda strukturës së burgut, ambientit të
20 burgut drejt jashtë, pr,a telefonave të bëra jashtë -- jashtë
21 burgut, pra, incizimet telefonike është në këtë rast janë të
22 qarta dhe këto incizime tepër të paqarta, kam shumë, e them me
23 shumë besim se po të testonim njerëz që të dëgjojnë këto
24 incizime nga burgu besoj dhe se të shohim se sa mirë mund t'i
25 njohin zërat në këto incizime, kam shumë besim se ata duhet të

1 kishin aftësi shumë të ulët për ta bërë një gjë të tillë,
2 përveç në raste kur kanë një kontekst apo janë të ndikuar
3 natyrisht, dhe në këto raste saktësia dhe besueshmëria duhet
4 të ishte më e ulët.

5 PY. Faleminderit. Tani do të flasim për rishikimet e
6 transkriptit të ZS-së. Sipas jush si duhet t'i analizojë Trupi
7 Gjykues këto transkripte të rishikuara? A janë këto versione,
8 versione të ndryshme të të njëjtës provë apo duhen trajtuar si
9 prova të ndryshme

10 PË. Nuk jam 100% e sigurt se si i kanë përkufizuar
11 transkriptuesit dhe përkthyesit "versionet". Nga përvoja ime
12 me transkriptimet dhe nga përvoja e të tjerëve, në thelb, sa
13 herë që shikon transkriptin del me një version të ri. Është
14 një proces i vazhdueshëm redaktimi dhe rishikimi. Nuk mund të
15 dëgjosh një transkript e thjeshtë të shkruash çfarë ke
16 dëgjuar, por duhet ta dëgjosh disa herë një audio të
17 padëshifrueshme, edhe gjithnjë e më shumë konteksti bëhet më i
18 qartë. Ndonjëherë ndodh që të dëgjon pjesën e fundit të
19 incizimit, i kthehesh fillimit të incizimit e kështu me radhë.
20 Pra, është e vështirë ta përkufizosh fjalën "version". A është
21 fundi i një dite, është fundi i procesit të transkriptimit,
22 nuk e di se si është përkufizuar fjala "version" në këtë rast.

23 Sidoqoftë, unë nuk e kam të qartë se çfarë duhet të bëjë
24 Trupi Gjykues në këto versione. Personalisht do rekomandoja që
25 Trupi Gjykues të kishte një version të fundit përfundimtar që

1 të jetë produkti përfundimtar i gjithë procedurës. Sepse nuk e
2 kuptoj dot se si mund të veprojnë ndryshe Trupi Gjykses. Të
3 shoh -- në rastin tuaj më duket se ka qenë tre versione, mbase
4 dhe dy. Si mund ta vendosë Trupi Gjykses cili version është më
5 i miri.

6 PY. Faleminderit. Do të shohim disa nga versionet e
7 rishikuara. Do t'ju tregoj dy versione të një transkripti të
8 vizitës së z. Smakaj të 9 shtatorit 2023. Transkriptet janë të
9 ZPS-së, dhe do ju lutesha të më komentoni lidhur me
10 mospërputhshmëritë në këto transkripte.

11 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të vendosë
12 në ekran materialin 1D113-ET, faqen 201. Ky është versioni i
13 dytë i një transkripti të përgatitur prej ZPS-së. Bëhet fjalë
14 për të njëjtën vizitë, pra. Të shikojmë faqen -- dhe një herë,
15 më falni të shohim materialin 113, faqja 201, rreshtat 6 deri
16 në 25. Faleminderit.

17 Në të djathtë, ju lutem, vendosni, P108-ET, në faqen 213,
18 rreshti 17. Është versioni i gjashtë i përgatitur nga
19 Prokuroria për të njëjtën vizitë. Përfundon me *Revise-ET*. Nga
20 rreshti 17.

21 PY. Rreshti 6 në të majtë, shohim që thotë "të gjithë ishin
22 fshatarë". Në rreshtin 6 në të djathtë -- më falni, 17, 17 në
23 të djathtë, fillon duke thënë "të gjithë fshatarët ishin
24 vullnetarë", thotë, versioni në të djathtë, rreshti 17.

25 Në rreshtin 9 në të djathtë, shohim fjalën "në male --

1 dhe në bjeshkë" -- më falni, dhe në të djathtë, rreshti 19

2 thotë "[e padëshifrueshme]". Në fund --

3 PË. Më falni, që të jem e qartë, po flasim rreshtin 19 në të

4 djathtën që thotë "[e padëshifrueshme]".

5 PY. Është ajo ku thotë "në bjeshkë", rreshti 9. Pra, rreshti

6 9 në të majtë që bëhet më pas 19 në të djathtë.

7 PË. Pra ky është versioni tjetër.

8 PY. Kështu e kuptojmë ne, sepse nuk e dimë saktë kur janë

9 krijuar këto transkripte. Na është kërkuar prej përkthyesve të
10 ngadalësojmë.

11 Shembulli i fundit, shohim rreshtin 18 në të majtë,

12 thotë, "Mund të flas /?singerisht/".

13 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Shkojmë tek faqja 214, ju lutem,

14 në të majtë.

15 PY. Rreshti 10, thotë "po flas për /?nder/".

16 PË. Në rregull.

17 PY. Ju tregova, ju ilustrova disa ndryshime në këto dy

18 versione të transkriptit. Tani si mund të vendosim ne se cili

19 prej versioneve është më i saktë?

20 PË. Mendoj që kjo është e pamundur. Në këtë fazë është e

21 pamundur. Mbase gjatë procesit, nëse do të ndiqej procesi i

22 rekomanduar, mendoj se do të kishte forma për ta zgjidhur këtë

23 përmes procesit dhe të dilej me një produkt fundor të

24 besueshëm. Po tani duke parë këto versionet e të vendosësh

25 cili version është më i mirë se tjetri është pikërisht një

1 ilustrim i asaj që thashë më herët kur ju thashë që është
2 tepër e vështirë që të vlerësosh transkriptet dhe sidomos
3 përkthimet e transkripteve pas faktit. Kur shikon një copë
4 letër me disa shkronja, ke dy versione, si mund të thuash cili
5 është më i miri? Dhe me një version. Si mund të vendosësh nëse
6 është i besueshëm apo jo? Duhet të kesh më shumë informacion
7 lidhur me atë çka është hedhur në atë letër.

8 PY. Në rreshtin 18 në të majtë, është një pikëpyetje përpara
9 fjalës "singerisht". Sipas jush çfarë do të thotë kjo shenjë
10 pikësimi?

11 PË. Nuk e di. E kuptoj, për mua këto janë thjesht shembuj
12 rastësorë që ju keni marrë nga transkripti për arsyet tuaja.
13 Nuk e di, nuk më kujtohet të kem parë ndonjëherë ndonjë
14 udhëzim apo informacion lidhur me simbolet, për shembull, se
15 ç'do me thënë viza, pikëpyetjet. Mendoj, si e kuptoj unë, që
16 pikëpyetja tregon që personi s'ka qenë shumë i sigurt lidhur
17 me deshifrimin aty, me zbardhjen. Nuk e di.

18 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] I lutem Sekretarisë --

19 PY. Fillimisht do ju tregojë dy versione të z. Kilaj, po
20 ashtu të transkriptuara prej ZPS-së, dhe të më jepni mendimin
21 tuaj lidhur me mospërputhshmëritë mes këtyre dy transkripteve.

22 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të vendosë
23 në ekran në të majtë materialin 1D116-ET, faqja 4. Ky është
24 transkripti i parë, versioni i parë i përgatitur prej ZPS-së.
25 Rreshtat 7 deri në 11. Faqja 44. Faleminderit.

1 Në të djathtë, materialin me P109, faqja 47, rreshtat 21-
2 25. Është versioni i tretë i përgatitur prej ZPS-së për të
3 njëjtën audioincizim. Këtë e kuptojmë nga fjala që thotë
4 "Revised 1-ET", e rishikuar, pra. materialet.

5 PY. Dua të krahasojmë rreshtat 7-11 në të majtë dhe rreshtat
6 21-25 në të djathtë. Në të majtë nuk thotë gjë lidhur me diçka
7 me -- futur diçka në xhep. Ndërsa në të djathtë thotë "e vura,
8 e futa në xhep, e vendosa në xhepin tënd".

9 Si mund t'i shpjegojmë ne këto ndryshime, dhe si të
10 vendosim ne secili prej versioneve është më i besueshmi?

11 PË. Nuk mundem të jap përgjigje.

12 PY. Po për faktin që këto transkripte nuk kanë as data, ne
13 nuk e dimë kur janë krijuar.

14 PY. Kjo është një befasi për mua. Nuk e kisha kuptuar deri
15 tani.

16 PY. Faleminderit. Kjo është tema e fundit. Dua të flas për
17 procesin e verifikimit prej Njësisë së Përkthimit. Pyetja ime
18 është kjo: Kur një transkript është krijuar, cili është
19 procesi që duhet ndjekur për të verifikuar nëse produkti është
20 i besueshëm apo jo dhe cilat praktika duhen apo nuk duhen
21 ndjekur?

22 PË. Në momente që një transkript është përgatitur dhe duam ta
23 vlerësojmë në një situatë si kjo ku ndodhemi, dhe dua
24 gjithmonë të theksoj po flasim për audio forensike të
25 padeshifrueshme, për kategoritë e tjera audio sigurisht që

1 mund t'i dëgjosh edhe një herë duke dëgjuar dhe audio dhe t'i
2 redaktosh apo t'i përshtatësh. Për audiot e padeshifrueshme,
3 të padëgjueshme procesi i vlerësimit të transkriptit duke e
4 rishikuar përkundrejt audios ka kuptim si proces, duket si një
5 proces shumë i thjeshtë dhe ajo çfarë duhet bërë afërmendsh.
6 Por, rreziku është që kur rishikohet një transkript ndërkohë
7 që dëgjohej dhe audio transkripti të jep ekspozim tekstual.

8 Dhe unë besoj që e vetmja mënyrë për ta vlerësuar një
9 transkript ekzistues në kohën që ka filluar një gjykim është
10 të krijohet një transkript i ri bazuar në proceset e
11 besueshme, kuptohet.

12 Mund t'ju tregoj një rast që mbase e ilustron më mirë.
13 Bëhet fjalë për një çështje ku jam përfshirë në retrospektivë.
14 Ishte një rast rigjykimi kohët e fundit. Bëhej fjalë për një
15 gjykim që fillimisht ishte zhvilluar në vitet '90. Në vitet
16 '90, në ato vite ishte një transkript i policisë, po ju them
17 që ishte komplet në anglisht ky transkript. Kishte një
18 transkript prej policisë pastaj erdhi një ekspert i
19 prokurorisë që e rishikoi transkriptin e policisë duke e
20 redaktuar. Ata i thanë "Mos krijo transkript të ri që të
21 kursejmë kohë e para, thjesht redakto transkriptin e
22 policisë". Ky ishte eksperti i prokurorisë dhe më pas i mori
23 një ekspert i mbrojtjes që po ashtu bëri një redaktim, një
24 rishikim të versionit që kishte rishikuar eksperti i
25 prokurorisë.

1 Gjithçka shkoi fjollë. Në atë kohë ekzistonin akoma
2 fakset makinat, aparatet faks. Pra, ishte dërguar transkripti
3 dhe u vu re që mungonte një nga faqet në transkript. Kërkoi që
4 t'i dërgohej me faks kjo faqe. U desh shumë kohë, kështu që
5 atëherë personi tha, unë po bëj -- dhe vendosi që ta bënte dhe
6 një herë atë faqe të transkriptit.

7 Po kur erdhi versioni i prokurorisë u pa se kur e kishte
8 redaktuar kishte bërë disa ndryshime, por ama krahasuar me
9 transkriptin që ishte krijuar nga e para, edhe kur u krahasua
10 me versionin e prokurorisë, versioni i fundit ishte krejt
11 ndryshe. Flasim për ekspertë të fonetikës që më shumë
12 analizojnë fjalën, tingullin, jo perceptimin. Dhe ky ishte
13 rasti i parë kur eksperti u ballafaqua me këtë efekt të
14 ekspozimit.

15 Në atë rast, sigurisht, pati edhe shumë ekspertë të
16 përfshirë, shumë dëshmitarë ekspertë, dhe ky ekspert i thirri
17 të gjithë dhe tha, "Transkriptojeni këtë audio në mënyrë të
18 pavarur dhe do të bëjmë krahasim". Dhe ndryshimet ishin shumë
19 të mëdha.

20 Tani çfarë mund të themi? Mund të themi që kjo tregon që
21 mbrojtja nuk pati ekspertë shumë të mirë apo ekspertë të tjerë
22 po ashtu nuk ishin shumë të mirë. Megjithatë, kur u bë
23 rigjykimi, pas shumë vitesh, në fakt shumë prej këtyre
24 transkripteve që ishin pranuar nga ekspertët e prokurorisë
25 dhe më pas pjesërisht, dhe më pas pjesërisht pranuar edhe nga

1 ekspertët e mbrojtjes kur po bënë rishikimin e transkripteve,
2 u pranua gjatë rigjyimit që në fakt transkriptet kishin shumë
3 gabime dhe nuk u pranuan si prova gjatë rigjyimit. Ky ishte
4 thjesht një ilustrim për t'ju treguar se sa e vështirë është
5 të jesh i sigurtë, se i evidenton të gjitha gabimet dhe se po
6 i korrigjon këto gabime siç duhet.

7 PY. Faleminderit. Në këtë çështje në këtë rast ju kërkuam
8 njësi të përkthimit të verifikonte ndër të tjera saktësinë e
9 transkripteve të ZPS-së të vizitës së Kuçit të shtatorit 2023,
10 duke dëgjuar si audioincizimet, por në të njëjtën kohë duke
11 lexuar transkriptet e ZPS-së. Dhe të bënë komente kur ishte
12 nevoja. Këtu po i referohem vendimit të Gjykatës me numër
13 F745, ku thuhej se:

14 "Praktika standarde e krijuar nga profesionistët e
15 Njësisë së përkthimit duhet të vijojë të zbatohet. NJP-ja mund
16 t'u referohet audiove forensike të ZPS-së, pra mund t'u
17 referohet audiove forensike të ZPS-së dhe transkripteve të
18 ZPS-së, qoftë në shqip apo në anglisht, në kuadër të procesit
19 të vlerësimit të saktësisë të transkripteve në gjuhën
20 angleze."

21 Pra në praktikë, Njësi e Përkthimit dëgjoi audion dhe
22 verifikoi dhe transkriptet dhe bëri -- dorëzoi versione të
23 rishikuara të transkripteve si të dosjeve -- si të audios së
24 përforcuar dhe të audios së papërforcuar, të vizitës së z.
25 Kuçi që folëm pak më herët.

1 Do ua tregoj më konkretisht.

2 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Ju lutem të vendosim në ekran
3 materialin që përfundon me 866. Faleminderit.

4 PY. Kjo memo përmban korrigjimet që i ka bërë Njësia e
5 Përkthimit transkriptit të ZPS-së të dosjeve të papërforcuara
6 audio të vizitës së zotit Kuçi të 3 shtatorit 2023. Sikurse e
7 përmendëm dhe sot paradite, kur ia dërguan fillimisht këtë
8 audio Njësisë së Përkthimit, fillimisht thanë ne nuk jemi në
9 gjendje ta transkriptojmë.

10 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Shkojmë në poshtëshënimin numër
11 2 tek faqja e parë.

12 PY. Ju lutem, lexojeni. Lexojeni me mendje. Ky është
13 poshtëshënimi që tregon se për cilin audio incizim bëhet
14 fjalë.

15 PË. Kjo që thotë përpara se ta merrnim? Atëherë po e lexoj.

16 Pra, përdorën vetëm origjinalin, jo versionet e
17 përforcuara.

18 PY. Po fillimisht kishin qasje në të dyja versionet, po këtu
19 thonë që kanë dëgjuar vetëm origjinalin.

20 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Ju lutem Sekretarisë të shkojmë
21 në faqen 67 të dokumentit. Më poshtë.

22 PY. Këtu thuhet:

23 "Pas verifikimit të transkriptit në shqipe përkundrejt
24 audios origjinale u konstatuan disa mospërputhje mes porcionit
25 relevant të audios dhe transkriptimit përkatës. Duhet

1 ndryshuar transkripti..."

2 Dhe më poshtë kanë bërë me shkronja të errëta korrigjimet
3 e tyre.

4 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Shkojmë tani tek faqja 72. Më
5 poshtë.

6 PY. Këtu thonë: "Për të reflektuar origjinalin në shqip,
7 përkthimi në anglisht duhet të ndryshohet si më poshtë".
8 Ndryshimet e tyre janë me shkronja të errëta.

9 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Shkojmë në fund të transkriptit
10 ju lutem, që të shohim se sa korrigjime janë bërë nëse ka
11 ndonjë korrigjim.

12 DËSHMITARJA: [Përkthim] Pra, vetëm fjalitë që janë në
13 shkrime të errëta janë ndryshuar?

14 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

15 PY. Po. Faleminderit.

16 Pra, me sa duket Njësia e Përkthimit ka bërë shumë pak
17 korrigjime në transkriptin e ZPS-së.

18 PË. Më jepni një çast, ju lutem. Në rregull. Gati jam. Më
19 falni.

20 PY. Pra duke e marrë parasysh pjesët që pamë është e saktë të
21 themi që Njësia e Përkthimit ka bërë shumë pak korrigjime?

22 PË. Po, ka relativisht pak fjali me shkronja të errëta.

23 PY. Faleminderit, profesore. Sipas jush kur Njësia e
24 Përkthimit tha që nuk e transkriptojmë dot vizitën e Kuçit, si
25 ka mundësi që në një kërkesë tjetër e rishikoi duke përdorur

1 si bazë transkriptin e ZPS-së dhe ishin në gjendje të
2 dorëzonin një transkript të rishikuar ku kanë mbajtur të
3 pandryshueshëm pjesën më të madhe të transkriptit të ZPS-së?
4 PË. Tani unë do të përgjigjem në mënyrën që mendoj se është
5 më e përshtatshme. Në lidhje me diskutimin që kemi pasur deri
6 tani mendoj që këtu po shohim ekspozim tekstual. Jemi në një
7 rastin e ekspozimit tekstual. Unë nuk e di a e kam thënë, se
8 mbase mund ta kam harruar, a ka qenë i njëjti person që ka
9 bërë versionin e mëparshëm? Kush e ka bërë?

10 PY. Nuk kemi informacion për këtë.

11 PË. Në rregull. Kjo është relevante atëherë, do të ishte
12 relevante ta kishim këtë informacion. Sikurse ua thashë më
13 herët, me gjithë respektin, ky nuk është një eksperiment i
14 kontrolluar siç duhet. Do kishim dashur që të ishin -- të
15 kishim më shumë kontroll në pjesën më të madhe të faktorëve,
16 me përjashtim të një apo dy faktorëve. Prandaj do të duhet do
17 të ishte ideale që të kishim pasur transkriptues të
18 mirëfilltë.

19 Megjithatë e kemi thënë disa herë sot edhe në këtë rast
20 po shohim ekspozim ndaj tekstit, tekstual. Po është situata e
21 kundërt e asaj që përshkrova unë në vitet '90. Fillimisht
22 personi bëri redaktimin dhe më pas u bë transkriptimi në
23 mënyrë krejt të pavarur duke dëgjuar nga e para dhe konstatoi
24 se ishte më e vështirë. Në këtë rast është bërë e kundërta,
25 fillimisht është bërë transkriptimi në mënyrë të pavarur pa

1 pasur tekstin, dhe më pas e ka ndjekur me tekst në këtë rast.

2 PY. Faleminderit. Procesi i realizuar prej Njësisë së

3 Përkthimit e rrit besueshmërinë e transkripteve të ZPS-së apo

4 jo, sipas jush?

5 PË. Me siguri që jo. Më lejoni të shtoj diçka tjetër.

6 Pikësëpari unë nuk jam e sigurt se cili version është

7 përdorur. A kanë përdorur versionin përfundimtar apo jo?

8 PY. Mendoj që kanë përdorur versionin përfundimtar. Atë që ka

9 dorëzuar ZPS-ja, versionin më të fundit të rishikuar. Por ne

10 nuk kemi datë se kur ka ndodhur.

11 PË. Është e habitshme, në fakt, që këto paqartësi kanë dalë

12 edhe në rastin e Njësisë së Përkthimit. Unë mendoj që kjo

13 është një detyrë shumë, shumë e vështirë edhe janë shumë pjesë

14 që duhen trajtuar. Pra, është befasuese që të njëjtat pasiguri

15 nuk kanë dalë këtu.

16 Por më e rëndësishme është të themi që mënyra më e

17 thjeshtë për ta kuptuar këtë është që, në fakt, duket sikur

18 janë pajtuar me gjithçka që është zbardhur këtu përveç këtyre

19 pjesëve të theksuara. Dhe kjo të jep përshtypjen se po të

20 ishin ulur të njëjtët persona -- këta persona ta bënë nga e

21 para do të kishin dalë me diçka gati identike. Kjo është krejt

22 gabim. Edhe me një audio të qartë dhe në qoftë se do të dilnin

23 me një produkt të ngjashëm me siguri do të kishim pasur

24 dallime në transkripte e më shumë në përkthime. Këtë e pamë më

25 herët me transkriptet që dorëzuat nga organizata e pavarur.

1 Edhe për këto që thamë është audio e qartë dhe dalin me
2 interpretim të ngjashëm, ishin të ngjashëm por nuk kishin
3 identikë. Rrallë herë ndodh që të dalësh me produkt krejt
4 identik, përkthim apo transkriptim, sidomos për audiot e
5 padeshifrueshme. Fakti që këto janë pothuajse identike, në
6 fakt, nuk është në favor të besueshmërisë në rastin e tyre.
7 Nuk e favorizon besueshmërinë ndaj tyre.

8 Mendoj se shumica e profesionistëve apo personave që
9 punojnë në këtë fushë, në fushën e transkriptimit të audiove
10 të padeshifrueshme dhe që e kuptojnë rrezikun e ekspozimit apo
11 të besueshmërisë, mendoj se këta persona nuk do të pranonin që
12 ta bënin punën në këtë formë, sepse ata e dinë që nuk mund të
13 dalësh në këtë formë me transkripte të besueshme. Këtë e kam
14 thënë dhe në raportin tim. Mungesa e ndërgjegjësimit lidhur me
15 të gjitha problematikat që kemi diskutuar sot, për mua është
16 disi shqetësuese.

17 PY. Pyetja ime e fundit. Ju thatë që për të vlerësuar
18 besueshmërinë e një transkripti duhet krijuar një transkript i
19 ri nga përkthyes të tjerë bazuar në një proces bazuar në
20 prova. Pyetja ime është: Si duhet të dokumentohet ky proces?
21 Çfarë informacioni duhet të marrim ne për ta bërë këtë
22 vlerësim?

23 PË. Mendoj se e shtjelluam gjerë e gjatë sot para dite këtë,
24 he besoj që unë demonstrova nivelin e aftësive që janë të
25 nevojshme për transkriptuesit. Domethënë, transkriptuesit

1 duhet që të demonstrojnë që nuk janë në dijeni të ekspozimit
2 të kontekstual, sepse kjo mund të çojë në orientim të gabuar
3 të tyre. Të paktën nga perspektiva ime dhe sikurse e kam
4 përmendur disa herë sot. Ka menaxherë të ndryshëm çështjesh që
5 mbase i bëjnë paksa ndryshe proceset, megjithatë të gjithë
6 besoj që bien dakord se të paktën duhet të ekzistojnë ose
7 duhet që të jenë në dispozicion dy zbardhës, dy transkriptues
8 me përvojë, dhe këta dy persona duhet që zbardhjen apo
9 transkriptimin e dokumentit në audio ta bëjnë pa ekspozim ndaj
10 çështjes. Dhe më pas duhet të bëhet edhe një transkript
11 tjetër, pra të prodhohet apo të shkruhet një transkript
12 tjetër, dhe të shikohet me shumë hollësi dhe të bëhet vlerësim
13 i gjërave të cilat janë më të rëndësishme dhe gjërat të cilat
14 janë më pak të rëndësishme brenda tekstit të zbardhur.

15 PY. Faleminderit, nuk kam pyetje tjera.

16 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, znj. Menegon.

17 A ka pyetje nga ekipet e tjera?

18 Z. REES: [Përkthim] Jo, faleminderit, nuk kemi pyetje.

19 Z. EDWARDS: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje as ne, por
20 përderisa jam në këmbë, thjesht dua të them për procesverbal
21 që z. Holmes po ashtu po na ndjek përmes videolidhjes.

22 Z. YOUNG: [Përkthim] Nëse më lejonit, kam disa pyetje.

23 Pyetje të palës tjetër nga z. Young:

24 Z. YOUNG: [Përkthim]

25 PY. A mund t'ju bëj disa pyetje tjera shtesë? Unë jam

1 përfaqësuesi i z. Fazliu, që është një prej të bashkëakuzuarve
2 të tjerë të çështjes gjyqësore.

3 Profesore, ju na thatë shumë qartazi sot se ndërkohë që
4 ekzistojnë disa praktika të mira, pavarësisht kësaj, zbardhës
5 apo transkriptues të ndryshëm funksionojnë në mënyra të
6 ndryshme dhe nuk ka një mënyrë universale të të funksionuarit
7 ose të të bërit kësaj pune, apo jo?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe mendohet që disa vite më përpara situata ka qenë edhe
10 më keq sesa sot, apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Ju thatë që gjatë hulumtimeve tuaja ju keni punuar me
13 transkriptues të besueshëm dhe që presumohet që kanë qenë të
14 trajnuar, apo jo?

15 PË. Po.

16 PY. Kam dy tema për të shtjelluar me juve. Atëherë, së pari,
17 janë proceset të cilat kanë të bëjnë me transkriptin aktual në
18 gjyq.

19 Kështu që do të doja që të shikonim bashkë disa prej
20 praktikave ose mënyrave se si mund të bëhet transkriptimi. Në
21 një situatë ideale, a do ishte e drejtë të thuhej që
22 transkriptuesi duhet të ishte i trajnuar, duhet të kishte
23 përvojë për deshifrimin e transkripteve dhe fjalëve të
24 padëshifrueshme dhe të mos kishte informacion kontekstual, apo
25 jo?

1 PË. Nuk do thoja që nuk duhet të kishte qasje në asnjë
2 informacionin kontekstual fare, por duhet të mbroheshin nga
3 informacioni mundësisht i anshëm i tyre.

4 Nuk e di në qoftë se më lejoni të bëj diçka, të shtoj
5 diçka tjetër.

6 Ju thatë "eksperiencë", kështu që thjesht do doja të
7 thoja që ka dallim midis eksperiencës dhe ekspertizës. Kështu
8 që në rastin tim unë do isha i interesuar të shikoja
9 ekspertizën më shumë sesa eksperiencën. Eksperienca është më e
10 gjerë.

11 PY. E keni fjalë për ekspertizën në biografite të tyre, apo
12 jo?

13 PË. Po, do të doja që të kishte një lloj vërtetimi ose një
14 lloj baze, të themi, të ekspertizës së tyre.

15 PY. Domethënë, ju doni që të gjeni kompetencë dhe vlefshmëri,
16 apo jo?

17 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ju lutem, bëni një pauzë
18 midis pyetjeve dhe përgjigjeve, sepse në të kundërtën është
19 shumë e vështirë t'ju ndjekur.

20 Z. YOUNG: [Përkthim] E kisha unë fajin, ju kërkoj ndjesë.

21 PY. Atëherë, në një skenar ideal, në një shembull të caktuar
22 sa për ilustrim ose një shembull ilustrues ideal, pra ne do
23 kishim të bënim me një transkriptues që ishte i trajnuar për
24 këtë punë, kishte përvojë dhe të mos kishte informacion të
25 ngushtë me çështjen në fjalë, apo jo?

1 PË. Jo, nuk duhej të kishte informacion për hetimin.

2 PY. Në rregull. Megjithatë, ka edhe raste tjera, apo jo, të
3 transkripteve ose të proceseve të transkriptit që realizohen
4 ndryshe.

5 A ju ka ndodhur në përvojën tuaj që personi që mundohet
6 që të bëjë transkriptimin e dëgjon videoregjistrimin e
7 përkthimeve të mëparshme të regjistrimit të mëvonshëm?

8 PË. Nuk e kuptova. E thoni dhe njëherë?

9 PY. Po, po e them dhe njëherë se nuk isha i qartë. Në qoftë
10 se dikush po dëgjon versionin e audios, ndërkohë që e dëgjon
11 në audio, pra, transkriptuesi ka një version të përkthyer
12 përpara.

13 PË. Nuk ju kuptoj. Domethënë, "të përkthyer" çfarë doni të
14 thoni.

15 PY. Jo, të përkthyer nga një gjuhë në një tjetër.

16 PË. E kisha fjalën për transkriptin në gjuhën origjinale, për
17 këto po flasim ne sot. Nuk po flasim për përkthim. Pra, për të
18 bërë transkriptim në gjuhën origjinale nuk do të kesh një
19 transkript përpara.

20 PY. Nuk duhet ta bësh, po a ndodh ndonjëherë kjo si mundësi?

21 PË. Po.

22 PY. A është kjo praktikë e keqe?

23 PË. Po.

24 PY. Është praktikë edhe më e keqe, apo jo, që personi që
25 dëgjon versionin në audio të ketë një dokument përpara që e

1 kanë përgatitur vetë?

2 PË. Është situatë shumë hipotetike. Nuk di si t'i përgjigjem
3 kësaj.

4 PY. Do ta bëj ndryshe pyetjen, në mënyrë më pragmatike, më
5 konkrete. Disa transkriptues apo përkthyes mund të kenë
6 prodhuar versionin e parë të transkriptimit dhe i kthehen
7 përsëri versioneve të tyre të para, por a ndodh ndonjëherë që
8 transkriptuesi që përdoret në gjykatë të transkriptojë një
9 dokument që është transkriptuar fillimisht nga një
10 transkriptues tjetër?

11 PË. Mund të ndodhë. Nuk e di që se ju kuptoj siç duhet, por
12 kjo, edhe në qoftë se ndodh, domethënë, ky do ishte praktikë e
13 keqe.

14 Pra, në fillim praktika e mirë është që transkriptuesi të
15 bëjë transkriptimin mbështetur në atë çfarë dëgjon në audio.
16 Dhe pastaj, më pas, domethënë, mund të bëjnë krahasime, po
17 fillimisht, domethënë, duhet që të bëhet dëgjimi në audio.

18 PY. Po në qoftë se kjo ndodhte, do ishit të shqetësuar për
19 integritetin e procesit?

20 PË. Në qoftë se dikush do bënte transkriptim mbështetur në
21 një transkriptim tjetër ekzistues, atëherë kjo do më
22 shqetësonte lidhur me cilësinë e procesit.

23 PY. A ndodh që transkriptuesi normalisht të jetë i njëjtit
24 person si përkthyesi?

25 PË. Kjo është pyetje e mirë. Me sa di unë normalisht ndodh

1 kështu. Megjithatë, unë njoh më mirë realitetin e Australisë,
2 skenarin në Australi.

3 PY. E kuptoj.

4 PË. Megjithatë, thuajse në të gjitha rastet që unë kam
5 trajtuar apo që kam qenë e përfshirë, zakonisht kështu ndodh.

6 PY. Në Australi e keni fjalën?

7 PË. E kam fjalën dhe në Itali.

8 PY. Po me çështje shqiptare jeni marrë më përpara?

9 PË. Jo.

10 PY. Flasim për raste hipotetike, për skenarë idealë. A mund
11 të ndodhë që dikush, i njëjti person që është përkthyes, që
12 shikon një transkript të një versioni të mëparshme, dëgjon
13 versionin në audio dhe ndërkohë që dëgjon të ketë edhe një
14 video një version me videoregjistrim? A ndodh kështu apo jo?

15 PË. Po, ndodh zakonisht kështu. Domethënë, sepse mund të
16 ndodhë, për shembull, që versioni i regjistruar në video të
17 ketë cilësi të dobët ndonjëherë jo.

18 PY. Në përmbledhje, a është e drejtë të thuhet që palët në
19 një proces gjyqësor që përdorin transkripte të transkriptuara
20 duhet të kenë transparencë sa i takon proceseve ose
21 metodologjisë që janë -- që është përdorur për rastet
22 individuale ose për transkriptet individuale?

23 PË. Po, mendoj që duhet të ketë garanci, megjithatë ajo çfarë
24 nuk dua të shoh unë, dhe nuk jam e sigurt në qoftë se do ta
25 nënkuptonit apo jo, po e ndjej me vend që ta sqaroj situatën.

1 Ndonjëherë njerëzit thonë që ju duhet që të vendosni çdo
2 version t'ia dërgoni përpara gjykatës, çdo version çdo hap.
3 Por, vlerësimi i transkriptit është një proces i vështirë, nuk
4 është kaq i thjeshtë. Kështu që unë personalisht dua që
5 transkriptet forensike të trajtohen në të njëjtën mënyrë si
6 dhe shkenca të tjera forensike, ku bëhet vlerësimi, kontrolli,
7 kur bëhet procesi, metodologjia e caktuar. Dhe pastaj në fund
8 procesit i thua ose nuk ka fare transkript, sepse ë versioni
9 në audio ishte shumë i vështirë dhe nuk mund të zbardhet në
10 mënyrë të besueshme ose vijoni me llojet e tjera të pistave që
11 mund të jenë, për shembull, gëzhgojat e armëve të zjarrit ose ë
12 shenjat e gishtave, ose fusha të tjera forensike të cilat të
13 ndihmojnë për të vendosur procesin. Pra, nuk mund të thuash
14 për shembull, në qoftë se ti nuk e ke i sigurt 100% që ke një
15 gëzhgojë përpara dhe në qoftë se gëzhgoja nuk vjen nga një armë
16 për të cilën ti je i sigurt, nuk mund të thuash që nuk jam
17 plotësisht i sigurt për origjinën, megjithatë, po ja lë
18 përpara trupit gjykues dhe të vendosë ai.

19 PY. Pra, ju po thoni që transparenca maksimale është kritike,
20 është e domosdoshme apo jo?

21 PË. Unë nuk mendoj që është e nevojshme për gjykatën për të
22 pasur disa versione, por gjëja më e rëndësishme është që të
23 kemi llogaridhënie.

24 PY. A mund të na thoni se cila do të ishte praktika minimale
25 që mund të prisnit për një çështje të caktuar? Të paktën sa i

1 takon dokumentacionit nga transkriptuesi, domethënë, përveç
2 trajnimit dhe ekspertizës apo ose të përvojës, a mund të na e
3 shpjegoni në qoftë se pritet që ë transkriptuesi të bëjë
4 ndonjë raport të punës vet?

5 PË. Nga menaxheri i çështjes, po, por jo nga transkriptuesi.
6 Jo aq shumë. Besoj që këtë si konstatim e kam nënvizuar dhe në
7 raportin tim. Dhe këtë e kam zbuluar që nuk ekzistonte,
8 domethënë, një raport i tillë nga menaxheri i çështjes, gjë e
9 cila m'u bë e qartë kur i bëra pyetjen znj. Menegon.

10 PY. Domethënë, ky është procesi që ju prisni për çdo
11 transkript që dërgohet përpara gjykatës, apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Tema e dytë ka të bëjë me informacion jo për procesin e
14 transkriptimit, të cilin ju e shtjelluat, por lidhur me
15 transkriptuesit. Kështu që dua t'ju bëj disa pyetje lidhur me
16 transkriptuesit.

17 Pse është e rëndësishme të kuptosh se cili transkriptues
18 ka bërë transkriptimin e transkriptimeve ekzistuese?

19 PË. Ndoshta nuk ndodh në çdo rast kështu që të identifikohet
20 transkriptuesi për çdo transkriptim, por është e nevojshme që
21 të ketë transparencë dhe të ketë llogari dhënie. Pra, të ketë
22 transparencë për çdo hap të procesit në mënyrë të tillë që ti
23 të shohësh shkencat e tjera forensike dhe të shohësh se çfarë
24 procedurash apo çfarë metodologjie ata përdorin. Për shembull,
25 të bëhet krahasimi me fusha të tjera të forensikës. Pra, është

1 e rëndësishme që të ketë transparencë të plotë për procesin,
2 në mënyrë të tillë që, për shembull, sa për ilustrim të dimë
3 se cila mund të çojë në një analizë të besueshme të gjurmëve
4 të gishtit.

5 PY. Edhe pse nuk është e nevojshme që të kemi emrat e
6 personave që kanë bërë transkriptimin, mendoj që është e
7 nevojshme që të verifikohet përvoja, eksperiencia e tyre lidhur
8 me transkriptimin.

9 PË. Përvoja nuk është kaq shumë e rëndësishme. Ekspertiza,
10 duhet të jenë ekspertë në fushë, personat që bëjnë
11 transkriptime. Ne nuk kemi standarde të detajuara. Nuk është
12 se i ndjekim në mënyrë të konsistente gjatë gjithë kohës.
13 Megjithatë, është e rëndësishme që të kemi profesionistë të
14 trajnuar, të testuar, të kemi gjithashtu edhe metoda të cilat
15 janë të mbështetura në prova dhe janë të përditësuara mbi
16 bazën e kërkimeve dhe hulumtimeve në fushë.

17 PY. Në disa shkenca puna e një eksperti rishikohet nga një
18 ekspert tjetër. A mendoni që kjo është diçka që nevojitet edhe
19 për transkriptuesit forensikë?

20 PË. Rishikimi në këtë fushë është një koncept jo shumë i
21 përdorur. Megjithatë, do t'i kthehesha dhe një herë
22 llogaridhënies dhe procesit të punës që mbështetet në prova.
23 Pra, rishikimi nga kolegët e tjerë mund të bëhet në mënyra të
24 ndryshme, ndonjëherë mund të rezultojë në procese më të mira,
25 ndonjëherë në procese jo dhe aq të mira.

1 PY. Tani, në qoftë se kuptohet se cilët janë transkriptuesit,
2 besoj që pjesë e këtij procesi ka të bëjë me verifikimin dhe
3 garantimin e pavarësisë dhe profesionalizmit dhe neutralitetit
4 të tyre, apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. Ne duhet të jemi të sigurtë që transkriptuesi X nuk ka
7 lidhje të drejtpërdrejtë me hetimin ose me çështjen për të
8 cilën ato transkriptojnë, apo jo?

9 PË. Po, duhet të sigurohemi që personat nuk kanë interes në
10 rezultatin e gjykimit.

11 PY. Dhe prezumohet që kjo të verifikohet përmes pyetjeve, pra
12 formimit të tyre profesional e të tjera, apo jo?

13 PË. Ne e bëjmë gjatë gjithë kohës këtë si proces me
14 përkthyesit apo me transkriptuesit.

15 PY. Për shembull, në qoftë se do shohim biografinë e tyre si
16 vitet e tyre, jetëshkrimet e tyre, në qoftë se, për shembull,
17 aty lexojmë që nuk ka ndonjë lidhje të personave me çështjet
18 në fjalë, a do ishit e shqetësuar ju që për shembull një
19 transkriptues i caktuar nëse ka punuar për një kohë të gjatë
20 për zyrat e Prokurorisë, për shembull, në të shkuarën, a do
21 ishte kjo diçka që do e bënte të mendonit pak më tej?

22 PË. Pyetja është hipotetike. Nuk jam e sigurt që do ketë
23 mundësi që t'i përgjigjem dhe më duhet të them që nuk kam
24 punuar asnjëherë me një çështje gjyqësore të ngjashme me këtë
25 çështje. E kuptoj që janë shumë gjëra në pikëpyetje, dhe nuk

Dëshmitarja: Helen Fraser (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Young

Faqe 98

1 jam e sigurt në qoftë se mund t'i përgjigjem pyetjes, apo jo.
2 Por në përgjithësi unë absolutisht që mund të them që duhet që
3 të siguroni pavarësinë, ashtu siç bëjmë edhe me lëmitë tjera
4 dhe me profesione të tjera.

5 PY. Faleminderit. Do e lë me kaq. Ju falënderoj për
6 përgjigjet.

7 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Admiraal.

8 Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Deklarata e profesorit ishte
9 shumë e qartë, kështu që nuk kam pyetje të tjera.

10 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Dua të sjell në vëmendje disa
11 dokumente, për shembull, Njoftimi sipas rregullit 103 të
12 Prokurorisë së disa Shtojca të cilat unë i citova gjatë
13 pyetjeve për dëshmitaren. Gjithashtu fola dhe për numrin e
14 intervistave të cilat janë bërë ose janë realizuar nga disa
15 prej përkthyesve të ZPS-së të përfshirë gjithashtu dhe në
16 transkriptimin e vizitave. Kështu që dëshiroj që t'i caktoj
17 një numër i provave -- për këto prova provizore të këtyre
18 dokumenteve. Domethënë konkretisht e kam fjalën për
19 parashtrimin F906 dhe dy Shtojcat që sapo i përmenda. Shtojca
20 2 dhe Shtojca 3 e këtij parashtrimi.

21 [Gjykatësi i Vetëm dhe Sekretarja e Gjykatës
22 këshillohen]

23 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Znj. Menegon bëhet fjalë
24 për parashtrimin e protokolluar, apo jo?

25 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Po. Por sugjeroj që të

1 regjistrohët si provë materiale sepse kjo ka është diçka që
2 është bërë për ZPS-në. Domethënë ZPS-ja ka bërë të njëjtën
3 kërkesë në të shkuarën. Dhe dua që të kërkoj gjithashtu dhe dy
4 shtojcat që të pranohen në prova materiale sepse janë dy
5 shtojca të cilat mbajnë informacion të detajuar lidhur me
6 përkthyesit që kanë bërë intervista të caktuara. Janë në duart
7 tua për të vendosur. Megjithatë, unë dëshiroj që ky
8 informacion të regjistrohët në prova. Nëse jo, do ta
9 parashtrojmë në dosjen tonë përfundimtare.

10 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ndoshta do ishte e mirë që
11 të bënin një listë të gjithë dokumenteve MFI ose të gjitha
12 dokumentet që dëshironi që t'i caktoj një numër provizor prove
13 dhe unë do të trajtoj pranimin e këtyre dokumenteve në një
14 vendim të caktuar. Domethënë pasi t'i japi dëshmi dëshmitarja.
15 Do ju sugjeroja që të bënit një listë, pra, bëni një
16 përmbledhje të gjithë dokumenteve që ju propozoni që të marrin
17 një numër të provës materiale, çojeni Zyrës Administrative dhe
18 pastaj do marrim vendim.

19 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Në rregull.

20 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Hafetz.

21 Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

22 Pyetje të palës tjetër nga z. Hafetz:

23 Z. HAFETZ: [Përkthim]

24 PY. Mirëdita. Profesor Fraser, ne pajtohem apo jo që
25 regjistrimet e gjykatës përmbajnë informacione të rëndësishme?

1 PË. Regjistrimet e gjykatës? Ma sqaroni pak?

2 PY. Jo, jo regjistrimet e fshehura.

3 PË. Po.

4 PY. Edhe ju e keni pranuar këtë në shumë artikuj që keni
5 shkruar në të shkuarën, apo jo?

6 PË. Po.

7 PË. Ju në fakt thoni shpesh që regjistrimet e fshehura të
8 marra në mënyrë të ligjshme mund të japin informacion ose mund
9 t'i kapin personat që kanë folur duke bërë parashtrime të
10 cilët përndryshe nuk janë të gatshëm që të bëjnë hap ta zënë
11 në gjykatë. E keni thënë këtë apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Për kontekst, ju e keni shkruar në një artikull të 2017-
14 s, diçka të tillë pra që ka të bëjë me regjistrime të
15 fshehura. Domethënë, është një rast studimor që e keni
16 përgatitur dhe e keni shkruar në 2017-ën. A ju kujtohet ky
17 artikull?

18 PË. Ky artikull i veçantë nuk më kujtohet. Por pajtohem me
19 atë çfarë thatë ju.

20 PY. Në buletin 2018-s, në korrik të 2018-ës ju thoni që
21 regjistrimet e fshehta japin prova forensike të fuqishme dhe i
22 lejojnë gjykatat për pranueshmërinë e gjërave të thëna në një
23 mjedis të tillë. Pra, përderisa në regjistrime të tilla mund
24 të përfshihet informacion i rëndësishëm, gjykata dhe palët
25 janë të interesuara që këtë informacion të pasqyrojnë sa më

1 qartë dhe sa më korrekt të jetë e mundur, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Po kjo është jeta juaj, apo jo?

4 PË. Nuk mund të jem e sigurt për këtë, po thjesht punoj për
5 këtë temë.

6 PY. Ju jeni drejtore e një qendre të dedikuar në
7 Universitetin e Melburnit për këtë çështje specifike, apo jo?
8 Dhe keni shkruar shumë artikuj, mbi 20 artikuj.

9 PË. Po.

10 PY. Dhe kur themi që ju -- atëherë dhe një herë. Gjykatat
11 kanë procedura që synojnë që të sigurojnë saktësinë e
12 transkripteve të regjistrimeve të fshehura që lidhen me
13 faktmbledhësin, apo jo?

14 PË. Po.

15 PY. Këtë e keni dhe në Australi, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. Në fakt kjo Gjykatë ka procedura për të siguruar
18 saktësinë e transkripteve dhe përkthimeve që i paraqiten
19 gjyqtarit, gjykatësit në këtë rast.

20 PË. Kjo është e natyrshme.

21 PY. Dhe ju jepet një përmbledhje e parashtrimit apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. Pra, ju thoni që ju prisni që të jetë e vërtetë,
24 domethënë, në kuptimin që të jetë e saktë. Çfarë doni të thoni
25 me këtë?

1 PË. Atëherë në qoftë se i referoheni politikave të gjuhës, e
2 kam lexuar diku unë, nuk di të them se ku.

3 PY. Besoj që është Vendimi për Gjuhën, apo jo? Besoj që jua
4 ka dhënë Mbrojtja e Thaçit, apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. A u ka dhënë më vonë sesa t'ju ketë dhënë informacionin
7 paraprak, apo jo?

8 PË. Po.

9 PY. Ju kanë dhënë gjithashtu dhe mendimin e këtij gjyqtari
10 për kërkesën për verifikim. A është e saktë kjo?

11 PË. Po.

12 PY. Keni marrë gjithashtu dhe parashtrimin F00745? Është
13 numri i parashtrimit, nuk pres që ta mbani mend atë. Që
14 përmban vendimin e Gjykatësit lidhur me një kërkesë të
15 Mbrojtjes për sqarim dhe rishqyrtim të procesit të verifikimit
16 në këtë lëndë gjyqësore.

17 PË. Sikurse e thatë dhe ju, numri nuk më kujtohet përmendësh.
18 Nuk e di ka ndonjë titull vendimi, se mbase mund të më thotë
19 diçka titulli.

20 PY. Titulli është Vendim mbi Sqarimet e Kërkuara nga Mbrojtja
21 - Kërkesë për Rishqyrtim.

22 PË. Po, po, më kujtohet.

23 PY. Nëse është e dhënë në raportin tuaj, ne prezumojmë që
24 këto janë dokumente të cilat ju i keni lexuar, sepse në faqet
25 e para të raportit ju keni dhënë një listë të dokumenteve ku

1 jeni mbështetur për të shkruar raportin, apo jo?

2 PË. Po. Unë i kam lexuar të gjitha dokumentet që janë
3 renditur në fillim të raportit tim.

4 PY. Me aq sa kuptoj unë nga pyetjet që ju bëre bëri znj.
5 Menegon, nga raporti dhe nga artikujt tuaj, është që ju mund
6 të mos pajtoheni me disa procedurave që përdoren në këtë
7 institucion, por edhe në institucione tjera. Pavarësisht
8 kësaj, ju pajtoheni se synimi pas këtyre rregullave dhe
9 procedurave është që të garantohet saktësia e transkripteve
10 dhe përkthimeve që kanë të bëjnë me faktmbledhjen, apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Një prej arsyeve se pse keni qenë kritike lidhur me
13 procedurat për transkriptimet forensike në juridiksionin e
14 vendit tuaj, domethënë juridiksionin e Australisë, është se
15 mbështetja te mbrojtja për sa i takon kundërshtimit të
16 saktësisë së transkripteve, sipas mendimit tuaj, është
17 problematike, apo jo?

18 PË. Po. Pajtohem me çdo gjë. Në çdo rast, unë pajtohem me
19 faktin që mbrojtja duhet të ketë ca rol, por ndonjëherë jepet
20 shumë rol më i madh se ç'duhet mbrojtjes për të kundërshtuar.

21 PY. Dhe mbështetja te mbrojtja për të kundërshtuar
22 transkripte është pjesë e kritikës tuaj ndaj garancive
23 ekzistuese. A është e drejtë të thuhet kjo?

24 PË. Po.

25 PY. Një prej këtyre kritikave konkrete është që të pandehurit

- 1 në proceset gjyqësore penale ndonjëherë nuk kanë sofistikimin
2 për të rishikuar siç duhet dhe me saktësi regjistrimet dhe
3 transkriptet në mënyrë të tillë që të ngrenë probleme ose
4 pretendime që kanë të bëjnë me saktësinë. A është kështu?
- 5 PË. Po. Unë do thoja kryesisht, në pjesën dërmuese të
6 rasteve.
- 7 PY. Unë kam përshtypjen që më përpara ju përshkruat që
8 rishikimi i transkripteve, në veçanti i materialit të
9 padëshifrueshëm dhe të gjatë është në vetvete një detyrë që
10 shkon përtej aftësisë së të akuzuarve, apo jo? Të të
11 pandehurve.
- 12 PË. Po. Shumë prej tyre, të paktën, megjithëse nuk jam e
13 sigurt nëse bëhet fjalë për të gjithë ato.
- 14 PY. Këto janë fjalët tua të dëshmitare.
- 15 PË. Unë thashë shumë dhe jo të gjithë.
- 16 PY. Po këto janë fjalët tua dhe besoj që ju e dini dallimin
17 midis disave dhe shumë.
- 18 PË. Po, po e di dallimin, por thjesht po bëjmë një lojë
19 fjalësh këtu. Unë thashë shumë, disa, *many*, në anglisht.
- 20 PY. Megjithatë, në qoftë se përfshihen të gjitha palët ose më
21 shumë palë, atëherë ky mund të jetë një proces shterrues ose
22 mund të jetë një proces i lodhshëm.
- 23 PË. Ndonjëherë, po.
- 24 PY. Ose ndoshta i pandehuri nuk mund të lexojë.
- 25 PË. Mund të ndodhë dhe kështu.

1 PY. Një tjetër kritikë specifike apo konkrete e juaja është
2 që mbrojtësit e të pandehurve ndonjëherë mbase mund të ndodhë
3 të mos kenë kohët e nevojshme ose burimet e nevojshme për të
4 rishikuar siç duhet regjistrimet në audio dhe transkriptet në
5 mënyrë të tillë që të ngrenë probleme me saktësinë. A është
6 kështu?

7 PË. Pjesërisht nuk kanë burimet e nevojshme dhe kohën e
8 nevojshme. Por, pjesërisht, sikurse e kam thënë dhe gjatë
9 ditës sot, nuk është ideale që të jepen transkripte të pasakta
10 potencialisht dhe më pas mbi bazën e këtyre transkripteve të
11 pasakta të bëhet rishikimi. Se kjo nuk është punë fare e
12 thjeshtë.

13 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ka shkuar ora 3.00 thuajse,
14 kështu që duhet të bëjmë një pushim.

15 Ju lutem nxirreni dëshmitaren nga salla.

16 Profesore, do bëjmë një pushim të shkurtër për 15
17 minutësh.

18 Z. Hafetz, do bëjmë pushim për 15 minuta tani. Do të
19 vazhdojmë në tej në orën 3.15, dhe do të vazhdojmë deri në
20 orën 4.00 sot.

21 Z. HAFETZ: [Përkthim] E kuptova, Gjykatës. Faleminderit.

22 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit juve.

23 Tani mund të bëjmë pushimin.

24 --- Seanca ndërpritet në orën 3.00

25 --- Seanca rifillon në orën 15.19

1 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mund të sillni dëshmitaren
2 në sallë.

3 [Dëshmitarja vijon dëshminë]

4 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mirë se vini, Profesore. Do
5 vazhdojmë deri në orën 4.00, jo më tej.

6 Z. Hafetz.

7 Z. HAFETZ: [Përkthim]

8 PY. Mirë se vini përsëri, Profesore.

9 Përgjigja e fundit që i dhatë pyetjes time dhe do ta
10 lexoj, kishte të bënte me pikën konkrete të burimeve të
11 Mbrojtjes.

12 Dhe përgjigja juaj ishte se:

13 "Atyre pjesërisht u mungonte koha dhe burimet, por
14 pjesërisht të gjitha gjërat që kemi thënë më herët sot në
15 mëngjes. Nuk është ideale për të dhënë, për të krijuar një
16 transkript që mund të jetë i pasaktë potencialisht dhe uroj që
17 të këto pasaktësi do të zbulohet, sepse, siç thamë, rishikimi
18 i transkriptit ekzistues nuk është detyrë, punë e lehtë."

19 Dhe kjo u kuptua.

20 Njëra prej vështirësive që ju keni identifikuar që me të
21 cilën të pandehurit përballëshin ishin burimet, apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. Dhe një tjetër ishte numri i mjaftueshëm, i duhur apo
24 burimet e mbrojtësve të të pandehurve?

25 PË. Po.

1 PY. Një tjetër ishte materiali që është dhënë goftë në mënyrë
2 të paqartë apo të çorganizuar?

3 PË. Po.

4 PY. Dhe kjo është ajo që keni thënë në Dhomën e Lordëve në
5 2025, vitin e kaluar?

6 PË. Ndoshta e kam thënë.

7 PY. Edhe besoj që e keni thënë në Dhomën e Lordëve, keni
8 dëshmuar se kjo është veçanërisht rasti në çështjet ku personi
9 i pandehur ka nevojë për ndihmën e shtetit sepse mungojnë
10 burimet financiare të mjaftueshme dhe shpesh Mbrojtja është
11 kaq e zënë sa që vlerësimi i audiove forensike është minimal.
12 A është e saktë?

13 PË. Po.

14 PY. Tani, Profesore, ju jeni në dijeni të kësaj çështjeje, të
15 akuzuarit për të cilët keni shkruar raportin, i akuzuari ishte
16 ish-presidenti i vendit të tij?

17 PË. Po.

18 PY. Me një ekip ligjor mbrojtës që përbëhet nga shumë
19 anëtarë?

20 PË. E pres një gjë të tillë.

21 PY. Ju dini disa, ju njihni disa prej tyre?

22 PË. Po.

23 PY. Dhe gjithashtu jeni në dijeni të incizimeve në fjalë në
24 këtë çështje që janë bërë dhe këta i kanë patur këto incizime,
25 Mbrojtja e Thaçit, z. Thaçi vetë dhe ekipi i Mbrojtjes së tij

1 që nga të paktën shkurti i vitit 2025?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe, në këtë çështje, ai ka qenë në zotërim të këtyre
4 incizimeve që nga viti 2023, pjesa e fundit e atij viti?

5 PË. Po.

6 PY. Në rregull. Dhe jeni në dijeni sepse i keni marrë edhe ju
7 të paktën disa prej tyre, se të gjitha këto përmbajtje audio
8 gjenden -- që t'i shoh pak dosjet, një sekondë.

9 PË. Po.

10 PY. Dhe ato janë të organizuara sipas datës së vizitave?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe ju keni parë kur i keni marrë ato se janë të
13 organizuara sipas datës dhe pastaj kemi një shtesë pesë
14 minutëshe në cilat kur ka ndodhur?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe nuk është saktësisht ajo që ju thoni kur flisni për
17 burimet e pamjaftueshme apo mungesë kohe apo burimesh për të
18 rishikuar incizimet e bëra, incizimet e fshehta, pra,
19 regjistrimet e fshehta?

20 PË. Po.

21 PY. Dhe kur ju pyeta para pak minutash lidhur me rëndësinë e
22 të kuptuarit të tyre në mënyrë të drejtë, janë fjalët që
23 përdora, apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Më herët gjatë marrjes në pyetje nga Mbrojtja, besoj që

1 ju e quajtet procesin e verifikimit të LSU-së, pra, të Njesisë
2 Linguistike këtu si "eksperiment". Ju kujtohet kjo?

3 PË. Mendoj që po referohesha kur znj. Menegon ua ka dhënë
4 njerëzve paraprakisht personit në fjalë. Mendoj që po thoja që
5 kjo nuk ishte eksperiment.

6 PY. Mendoj që ju thatë që nuk ishte eksperiment i mirë, por
7 do të gjej transkriptin. Ju kujtohet kjo?

8 PË. Mund të ketë qenë që nuk është eksperiment i mirë, po.

9 PY. Por nuk është eksperiment fare në fakt. Në fakt është
10 procesi që ka ndodhur, apo jo?

11 PË. Në rregull.

12 PY. Kjo është pyetje që meriton përgjigje me po ose me jo,
13 apo jo? Fjalët e tua të sakta këtu janë në faqen 71 të
14 transkriptit, "jo eksperiment shumë i mirëkontrolluar".

15 PË. Po.

16 PY. Nuk është eksperiment, pra? Është procesi i verifikimit
17 të Gjykatës, apo jo?

18 PË. Nuk jam e sigurtë a pajtohem me këtë, por pranoj, e
19 pranoj atë që po thoni.

20 PY. Unë po ju pyes, ju kërkoj që ta shpjegoni. A mendoni se
21 procesi i verifikimit të Gjykatës në këtë rast është
22 eksperiment që kanë bërë?

23 PË. Kërkoj ndjesë, nuk mund t'i përgjigjem këtyre pyetjeve.

24 PY. Profesoreshë, ju thatë që "nuk ishte eksperiment i
25 mirëkontrolluar" dhe unë po ju pyes sepse duket që ju

1 pajtoheni me këtë. Në fakt, nuk është eksperiment që Gjykata e
2 ka bërë?

3 PË. Ju po bëni të tingëllojë sikur ishte pjesë e procesit të
4 Gjykatës. Me sa kuptova unë kjo ishte diçka që znj. Menegon ka
5 bërë si një lloj eksperimenti për të parë se çfarë do të
6 ndodhte po t'i kërkohet, në qoftë se ajo do t'u kishte kërkuar
7 këtyre transkriptuesve të pavarur për të shikuar këtë
8 material.

9 PY. Do t'i kthehem kësaj.

10 PË. Kërkoj ndjesë.

11 PY. Mbarojeni përgjigjen tuaj.

12 PË. E kisha mbaruar.

13 PY. Besoj që znj. Menegon shfaqti në ekran, në qoftë se ka
14 nevojë, është në faqen 71 ajo që ju pyeti, ishte për procesin
15 e verifikimit të LSU-së i cili përfshinë një proces për të
16 cilin ju folët gjerësisht?

17 PË. Po. Tani po ju ndjek, po e kuptoj.

18 PY. Dhe fjalët e tua ishin se "ky nuk ishte eksperiment i
19 mirëkontrolluar". Më ndiqni?

20 PË. Po. Mendoj që po i referohesha atij të mëparshmit kur ne
21 nuk dinim për kualifikimet e personave në fjalë.

22 PY. Pra, ju po flisni jo për një eksperiment -- po flisni për
23 "një eksperiment që nuk ishte i mirëkontrolluar", kur folët
24 për këtë ju nuk e kishit fjalën fare për Njësinë e Shërbimeve
25 Gjuhësore në këtë çështje, apo jo?

1 PË. Mendoj që Njësia e Shërbimeve Gjuhësore ka bërë në këtë
2 rast ato versionet përfundimtare, ata kanë bërë procesin e
3 verifikimit që është sugjeruar nga Gjykatësi. Gjërat e
4 mëparshme, mesa kam kuptuar unë, janë të filluara nga znj.
5 Menegon. Dhe ato ishin pak më ndryshe, me sa kuptoj.

6 PY. Pra, për aq sa të mos ketë mëdyshje ju nuk po sugjeroni
7 se LSU-ja ka bërë -- ajo që LSU-ja ka bërë në këtë çështje
8 ishte ndonjë lloj eksperimenti?

9 PË. Jo.

10 PY. I mirëkontrolluar apo ndryshe?

11 PË. Ajo që LSU-ja ka bërë me rishikimin e këtij transkripti
12 është rishikimi i transkriptit ekzistues. Nuk ka qenë
13 eksperiment. Mendoj që ajo që znj. Menegon po bënte është bëra
14 e një eksperimenti për të parë se çfarë do të ndodhte po të
15 kërkohej nga transkriptues të pavarur që të shikonin të
16 njëjtin material.

17 PY. Kuptoj. Në rregull. Tani më herët gjatë marrjes në
18 pyetje, u pyetët gjithashtu dhe dhatë disa përgjigje lidhur me
19 transkriptuesit në këtë çështje duke dhënë komentet tuaja
20 lidhur me tingujt që dëgjoheshin. Ju kujtohet kjo?

21 PË. Më kujtohet.

22 PY. Tani ju vetë keni bërë disa punë transkriptimi, apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Dhe ju e keni bërë këtë në çështje penale në gjykatë, apo
25 jo?

1 PË. Po.

2 PY. Dhe një prej tyre ka qenë çështja Eastman, apo jo?

3 PË. Nuk kam bërë transkriptet fillestare në atë çështje. Kam
4 komentuar transkriptet ekzistuese.

5 PY. Kërkoj ndjesë për pyetjen e pasaktë. Ju keni rishikuar
6 dhe keni dhënë mendimet tuaja mbi transkriptin e audios në atë
7 çështje?

8 PË. E saktë.

9 PY. Dhe kur gjykata e ka bërë përmbledhjen e konstatimeve,
10 përfundimeve tuaja në atë çështje.

11 Z. HAFETZ: [Përkthim] Dhe referenca për këtë dhe për
12 Gjykatën dhe për palët është 00410930 deri në 401961 dhe kjo
13 është 2018 ACTSC 186.

14 PY. Është mënyra që ndjekin australianët për të mbajtur të
15 dhënat dhe shënimet e dokumentacionit të gjykatës?

16 PË. E saktë.

17 PY. Në atë çështje gjykata i bëri një përmbledhje të
18 komenteve të ndryshme, të disa komenteve që keni bërë ju
19 lidhur me regjistrimet e ndryshme të shumta të cilat u
20 përdorën dhe përmenden në faqen që do t'ju jap pas pak në
21 tabelë. Ato janë të emërtuara dhe të numëruara, ku janë
22 numëruar regjistrimet.

23 PË. Po. Aty janë, u është dhënë numër regjistrimeve.

24 PY. Dhe gjykata pasqyroj se ju kishit konstatuar ndër të
25 tjera se njëri prej regjistrimeve, incizimeve të cilat keni

1 dëgjuar ku në sfond kishte komente sportive apo një televizion
2 apo radio, në një tjetër audio kishte zhurmë në sfond dhe
3 tinguj të tjerë që ndërhyjnë me fjalë me fjalimin dhe në këtë
4 dosje kishte episode të ndryshme të pëshpëritjeve që mund të
5 interpretoheshin si stil ankues apo dikush që ankohej për
6 procesin burokratik edhe pse ishte fare pak e qartë.

7 Dr. Fraser, ju vetë keni dhënë mendim, me sa duket, për
8 një mënyrë fjalimi për të cilën jeni ankuar?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe kjo del jashtë, është përtej audios apo ishte e
11 perceptueshme për ju apo që ta vëzhgonit, e saktë, njëra prej
12 të dyjave?

13 PË. Ishte e perceptueshme për mua apo e kam konstatuar një
14 gjë të tillë, e kam vëzhguar pra.

15 PY. Ju keni qenë në gjendje të përcaktoni vetëm thjesht nga
16 audio, nga regjistrimi në audio që ishte një mënyrë të foluri
17 ku personi ankohej për diçka?

18 PË. Po.

19 PY. Dhe ju keni bërë dhe një punë në çështjen Michael Clark?

20 PË. Po.

21 PY. Dhe keni nxjerrë një raport në atë çështje në mars të
22 vitit 2014?

23 PË. Po.

24 Z. HAFETZ: [Përkthim] Do t'ju jap numrin SPOE. Kjo në
25 provat që kemi paraqitur ne në listë.

1 PY. Është raporti juaj 37 faqe, ju vetë keni vërejtur aty
2 disa dosje, pra, incizime audio kishin në sfond zhurmë
3 televizioni të një ndeshje futbolli komentare, njerëz që
4 diskutonin një ndeshje futbolli dhe disa tema që lidhen me
5 televizionin dhe në një rast që ju e keni vëzhguar më tej nga
6 mikrofoni, pëshpëritjet, mesa duket në një mënyrë sekrete
7 urgjente dhe në një tjetër, pra, personi tjetër afër
8 mikrofonit përgjigjej herë pas here "mm-hm".

9 A ju kujtohet kjo?

10 PË. Po.

11 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Më fal, po kërkoj ndjesë. A mund
12 të na jepen referencat për dokumentet e mëparshme, numri SPOE,
13 nuk doja t'ju ndërpres, po thjesht që t'i kemi në
14 procesverbal.

15 Z. HAFETZ: [Përkthim] Sigurisht. Është SPOE00412606 deri
16 në 412645 dhe ky material është në faqen 23 të dokumentit 37
17 faqesh.

18 PY. Pra, ju vetë keni dalluar ndeshje futbolli, tema
19 televizioni dhe ku njerëzit ishin afër mikrofonit, një mënyrë
20 urgjente sekrete të folurit?

21 PË. Po.

22 PY. Kur ju pyetën më herët për pjesën ku ndiheshin zhurmat e
23 kthimit të faqeve, ju kujtohet kjo sot në mëngjes?

24 PË. Po.

25 PY. Dhe më korrigjoni në qoftë se gaboj, por mesa kuptoj unë,

1 e asaj që thatë ju transkripti që keni parë i shkonte përtej
2 asaj që një transkriptues duhet të bëjë apo që bën kur ka
3 konstatuar që zhurmën e kthimit të faqeve?

4 PË. Ky do të ishte një prej shembujve, po.

5 PY. Dhe më herët në këtë përgjigje ju thatë që mund të
6 dëgjohej kthimi i faqeve, zhurma që shkakton kthimi i faqeve,
7 i fletëve?

8 PË. Po.

9 PY. Ju kujtohet kjo?

10 PË. Po.

11 PY. Që të jemi të saktë, ajo që ju kuptova unë nga
12 transkripti, në faqen 45 të transkriptit, është se këto
13 transkripte, këto përkthime venë më shumë në letër sesa
14 dëgjohet në audio?

15 PË. Po. Në disa raste.

16 PY. Pra, një prej rasteve bëhej fjalë për kthimin e faqeve?

17 PË. Po.

18 PY. Por ju thatë në raportin tuaj kur Menegon ju pyeti ju:

19 "Faleminderit. Në raportin tuaj, si, për shembull, kthimi
20 i faqeve që shkon përtej asaj që është, që mund të rezultojë
21 në mënyrë objektive nga një audio, nga vetë një audio."

22 PË. Po.

23 PY. Para se të kthehemi tek dy shembujt nga Eastman dhe
24 Clark, ajo që ju keni vërejtur në ato dy audio, përfshirë
25 synimin në sekret ishte i vëzhgueshëm nga ju duke dëgjuar

Dëshmitarja: Helen Fraser (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Hafetz

Faqe 116

1 audion?

2 PË. Po.

3 PY. Pra, ishte diçka që mund të vërehej në mënyrë objektive?

4 Po ose jo?

5 PË. Po.

6 PY. Dhe zhurma e bërë nga kthimi i faqeve në një incizim

7 është, sipas pikëpamjes tuaj, diçka që mund të deduktohet në

8 mënyrë objektive nga audio, mund të vërehet?

9 PË. Po.

10 PY. Pra, kthimi i faqeve është diçka që mund të deduktohet,

11 të nxirret në mënyrë objektive nga disa raste nga një audio?

12 PË. Nuk më pëlqen shumë termi që mund "të nxirret, të

13 deduktohet në mënyrë objektive", por vazhdojmë, pajtohem me

14 atë që po thoni.

15 PY. Këto ishin fjalët e znj. Menegon që ju tha juve dhe ju u

16 përgjigjët po kësaj pyetjeje.

17 Cilat fjalë do të preferonit në vend që mund "të nxirret

18 në mënyrë objektive" nga audio?

19 PË. Nuk e di. Duhet të kthehem dhe të shoh të gjithën

20 përsëri.

21 PY. Që të jemi të qartë, ju nuk po kundërshtoni se një

22 transkriptues për Prokurorinë në këtë çështje mund të ketë

23 dëgjuar siç duhet dhe të ketë shkruar në transkript zhurmën e

24 shkaktuar nga kthimi i faqeve në njërin prej incizimeve të

25 fshehta?

1 PË. E saktë.

2 PY. Dhe se ata mund të kenë dëgjuar këtë gjë në shumë
3 regjistrime audio, incizime audio?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe që kjo varet nga dëgjimi i incizimit dhe sesa e qartë
6 është ajo për t'u dëgjuar?

7 PË. Po.

8 PY. Pra, kthimi i faqeve mund të jetë ndryshe, mund të jetë
9 më konkret, më specifik. Është ajo që po thoni?

10 PË. Po.

11 PY. Por nëse çështja, pika që po ngremë apo pyetja është që
12 personi po përpiqet të kuptojë nëse letra ishte, fleta ishte
13 në dhomë apo përdorej gjatë diskutimit, kjo do të ishte e
14 dobishme për ta ditur po të kishim një audio nga ku mund të
15 nxirret në mënyrë objektive se po bëhet fjalë për kthim
16 faqesh, apo jo?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe dua t'ju bëj disa pyetje për pëshpëritjet.

19 PË. Në rregull.

20 PY. Në raportin tuaj në këtë çështje keni vërejtur, vënë në
21 dukje se:

22 "Në disa pjesë zërat janë të lartë, mjaftueshëm të lartë
23 dhe se do të prisja që përmbajtja të jetë kryesisht e
24 kuptueshme për dëgjues të aftë dhe të trajnuar që njohin edhe
25 gjuhën". Ju kujtohet kjo?

1 PË. Po.

2 PY. Që të jemi të qartë, në faqen 17 të raportit tuaj.

3 Dhe pastaj në pjesë të tjera thoni se:

4 "Në pjesë të tjera ka një amplitudë të ulët apo fjalim
5 pëshpëritës të cilin pres që të jetë i paqartë edhe për
6 dëgjues të aftë ..."

7 Dhe ju më tej shpjegoni se çfarë doni të thoni me këtë.

8 PË. Po.

9 PY. Pëshpëritja e një audio të fshehtë është diçka normale
10 për njerëzit, për qeniet njerëzore?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe nuk kërkon detyrimisht që të flasë -- nuk duhet
13 detyrimisht të flasësh gjuhën e folësit i cili po pëshpërit
14 për të dalluar këtë gjë?

15 PË. Për të dalluar që ata po përsërisin.

16 PY. E saktë. Fakti që po pëshpëritin është diçka që kuptohet
17 qartë nga qeniet njerëzore me aftësi dëgjuese normale të
18 mesme?

19 PË. Po.

20 PY. Në këtë çështje në audion që ju keni rishikuar, keni qenë
21 në gjendje të dalloni faktin se pëshpëritja ka ndodhur edhe
22 pse nuk flisni shqip?

23 PË. Po.

24 PY. Tani aftësia e dëgjuesit për të kuptuar se çfarë po
25 pëshpëritet qoftë në një bisedë që bëhet në mënyrë personale

- 1 apo të regjistruar në mënyrë të fshehtë, varet nga disa
- 2 faktorë, apo jo? Dua të dëgjojmë përgjigjen.
- 3 PË. Mendoj -- nuk dija që kishit përfunduar pyetjen.
- 4 PY. Po, po. Kisha përfunduar.
- 5 PË. Pra, cila ishte pyetja?
- 6 PY. Pyetja ishte: Aftësia e një dëgjuesi për të kuptuar --
- 7 PË. Faktin që dikush, pra, po pëshpërit?
- 8 PY. Po, varet nga disa faktorë?
- 9 PË. Mendoja që do të rendisnim faktorët për të cilët ju po
- 10 flisnit.
- 11 PY. Do të kalojmë aty.
- 12 PË. Nuk jam e sigurtë se sa faktorë duhet që të dimë që
- 13 dikush po pëshpëritë.
- 14 PY. Nuk po ju kërkoj një numër të saktë. E kam fjalën, kjo
- 15 varet më shumë se nga një faktor.
- 16 PË. Nuk kam faktorë konkretë në mendje tani, por po.
- 17 PY. Më lejoni t'ju pyes atëherë. Një faktor është intensiteti
- 18 apo amplituda, volumi i pëshpëritjes?
- 19 PË. Mendoj që kjo ka të bëjë më shumë me cilësinë e zërit.
- 20 PY. Por volumi në të cilin po flas duhet të jetë një faktor
- 21 për sa i përket aftësisë së personit për të dalluar
- 22 pëshpëritjen?
- 23 PË. Po, mund të jetë faktor.
- 24 PY. Ka pëshpërima të shkallëve të ndryshme, apo jo?
- 25 PË. Po.

1 PY. Siç thatë, dikush pëshpëritë me zë shumë të lartë, nuk
2 mund ta bëj se jam në Gjykatë, po ka pëshpërima të larta, ka
3 dhe pëshpërima që janë shumë të ulëta?

4 PË. "Pëshpërima" është një lloj vibrimi i kordave vokale që
5 lëshon tinguj.

6 PY. Dhe pëshpërimat dhe nivelin e qartësisë e kanë të
7 ndryshëm, apo jo?

8 PË. Po.

9 PY. Një faktor tjetër për të shquar atë që thuhet gjatë
10 pëshpërimave është dhe zhurma në sfond, apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Sa më shumë zhurmë të ketë në sfond aq më e vështirë
13 është, apo jo?

14 PË. Po.

15 PY. Ndërkohë kur flasin dhe persona të tjerë paralelisht, apo
16 jo?

17 PË. Po.

18 PY. Një faktor tjetër që shërben për të kuptuar gjuhën që po
19 pëshpëritet është aftësia për të folur dhe për të kuptuar
20 gjuhën, apo jo?

21 PË. Po.

22 PY. Pra, një folës, një folës i gjuhës shqipe, që ka shqipen
23 si gjuhë amtare, mund të jetë më në gjendje ta shquajë
24 pëshpërimën krahasimisht me ju, apo jo?

25 PË. Po.

1 PY. Në fakt, probabiliteti është më i lartë që ata të

2 nxjerrin më shumë informacion sesa ju, apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Dhe për cilësinë e pëshpërimave, apo jo?

5 PË. Këtë nuk e di.

6 PY. Nuk e dini, a jeni po aq e mirë sa një folës i gjuhës
7 shqipe?

8 PË. Po flisnim për "cilësinë e pëshpërimave" më duket?

9 PY. Po, për cilësinë e pëshpërimave.

10 PË. Jo të gjithë folësit janë të zotë të deshifrojnë audiot e
11 padëgjueshme, por sigurisht që një person që e flet gjuhën
12 është në një pozicion më të mirë sesa një person që nuk e flet
13 gjuhën. Unë nuk e di çfarë nënkuptoni ju me "cilësinë e
14 pëshpërimave". Çfarë doni të thoni e keni fjalën për
15 përmbajtjen e pëshpërimave apo çfarë? Nuk e kuptoj çfarë po
16 përpiqeni të më thoni.

17 PY. Do jem pak më i saktë. Do përdorim tre kategoritë që keni
18 përdorur ju që i keni bërë, i keni ndarë në kategoria e qartë,
19 e paqartë dhe e padëgjueshme.

20 Një folës i gjuhës shqipe do të jetë në pozicion më të
21 mirë për të kategorizuar një audio në gjuhën shqipe
22 krahasimisht me ju që nuk jeni folëse e gjuhës?

23 PË. Ta kategorizoj thoni e qartë, e paqartë, e padëgjueshme?

24 PY. Po.

25 PË. Kjo është një temë tjetër për të cilën kemi punuar, është

1 supozimi se folësit e gjuhës janë në gjendje të deshifrojnë
2 përmbajtjen e audiove me cilësi të dobët, por nuk është kështu
3 në realitet. Jo të gjithë anglishtfolësit janë në gjendje të
4 deshifrojnë audio që janë të padëgjueshme. Kjo është një
5 aftësi që shkon përtej gjuhës. Megjithatë, vlen sigurisht, që
6 të flasësh gjuhën është një parakusht në mënyrë që të kuptosh
7 përmbajtjen e audios qoftë kjo me pëshpërime apo jo.

8 PY. Jo vetëm përmbajtjen, po flasim për kategorizimin siç e
9 keni bërë ju, ndarjen në tre kategori?

10 PË. Aftësia për të kuptuar përmbajtjen është ajo që të
11 ndihmon që të bësh kategorizimin.

12 PY. Në faqen 70 dhe 90 të raportit tuaj ju flisni për faktin
13 që keni përdorur *ChatGPT*?

14 PË. Po.

15 PY. Besoj se e keni në fund të faqes 70 në fillim të faqes
16 80, apo jo?

17 PË. Po.

18 PY. Fakti që keni përdorur *ChatGPT*, në këtë rast e keni bërë
19 pikërisht që të kategorizoni kampionët e audiove që ju dhanë?

20 PË. Po.

21 PY. Sepse ju si person që nuk flisni gjuhën nuk jeni në
22 gjendje ta bëni ndryshe, apo jo?

23 PË. Jo tërësisht. Isha në gjendje të bëja disa vlerësime, por
24 po, kështu është. Të jesh folës, jua thashë, është avantazh ta
25 flasësh gjuhën. Nuk po e diskutoj aspak këtë. Por nuk po

1 thellohem më tej sepse thjesht të flasësh gjuhën nuk garanton
2 që do kesh një version të besueshëm të transkriptimit edhe
3 kategorizimi i bisedave apo i të folurit është një dimension
4 krejt ndryshe. Po përpiqem të jap një përgjigje të saktë sepse
5 nuk e di ku duam të dalim.

6 PY. Profesore Fraser, unë e di se ku dua të dalim, ju thjesht
7 përgjigjuni pyetjes.

8 PË. Po bëj të pamundurën, por po përpiqem të jem e saktë në
9 përgjigjet e mia, sepse mund të më citojnë më vonë nëse nuk e
10 kam dhënë përgjigjen e saktë.

11 PY. Atëherë unë po jua bëj edhe një herë pyetjen që ta
12 kuptojmë se çfarë kam dashur të them.

13 PËRKTHYESJA: Na është kërkuar prej përkthyesve të
14 ngadalësojmë.

15 Z. HAFETZ: [Përkthim]

16 PY. Do t'jua bëj dhe një herë pyetjen meqë jemi këtu, a e
17 dini se cilin version të *ChatGPT* keni përdorur?

18 PË. Versionin më të fundit të asaj kohe. Nuk më kujtohet
19 saktë cili numër ishte.

20 PY. Nuk e dini cilin model të *Whisper* keni përdorur apo jo?

21 PË. Nuk mendoj se është model *Whisper*. Më duket se kanë një
22 opsion atje *Whisper* dhe thonë modeli më i madh, mesatar apo i
23 ulët. Mendoj që kam përdorur modelin më të madh.

24 PY. Kur e keni bërë këtë, se ka kaluar kohë nga momenti që
25 keni marrë materialin dhe deri nga përfundimi i raportit?

1 PË. Nuk më kujtohet saktësisht data.

2 PY. A ju kujtohet nëse mos keni përdorur programin në
3 versionin *online* apo e keni shkarkuar fillimisht?

4 PË. Kam dy versione. Kam një version *online* dhe një version
5 që e kam në kompjuter, besoj se i kam përdorur të dy
6 versionet.

7 PY. Pse i keni përdorur të dy?

8 PË. Për të parë dallimet dhe ndryshimet

9 PY. Ishin të ngjashëm apo të ndryshëm?

10 PË. Për artikullin në gazetë ishin të ngjashëm. Për pjesën
11 tjetër të ndryshëm.

12 PY. Pse ishin të ndryshëm?

13 PË. Nuk më kujtohet. Po më duket se nuk e kishin, nuk e
14 kishin zbardhur siç duhet audion.

15 PY. Edhe versioni *online* edhe versioni *offline*?

16 PË. Po.

17 PY. Domethënë, nuk kishin kuptim?

18 PË. Po.

19 PY. A e keni dokumentuar gjëkundë se cilin version keni
20 përdorur?

21 PË. Më kujtohet vetëm që kam përdorur versionin më të fundit,
22 po data nuk më kujtohet.

23 PY. Mos keni përdorur modelin *OpenAI*?

24 PË. Po, po.

25 PY. Pra, shkuat në faqen e internetit të *OpenAI*?

1 PË. Jo.

2 PY. Po ku?

3 PË. Përmes programeve që kanë qasje në *OpenAI*, modelet e
4 *OpenAI*.

5 PY. Cilat programe janë këto?

6 PË. Do të doja të mos e thoja emrin nëse është e mundur.

7 PY. Janë të mbrojtura?

8 PË. Po.

9 PY. Janë, domethënë, objekt i të drejtave të autorit?

10 PË. Është, mendoj, që është informacion personal, të dhëna
11 personale. Vetëm në qoftë se më kërkon Gjykatësi unë mund t'ua
12 jap përgjigjen po nuk mendoj se ka vlerë për ju. Janë programe
13 që kanë qasje në modelet e *ChatGPT Whisper*.

14 PY. Do ju bëj dhe disa pyetje që ta kuptoni pse është e
15 rëndësishme për ne dhe do ju lutesha të përgjigjeshit.

16 Profesore Fraser, besoj se pajtoheni me mua se fakti që
17 keni përdorur *Whisper* të *ChatGPT* ka qenë i rëndësishëm për
18 raportin tuaj?

19 PË. Jo, shumë. Ishte thjesht për ilustrim.

20 PY. Ky ilustrim është ilustrimi që keni përdorur ju për të
21 dalë në përfundimet tuaja në raportin tuaj, apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. Madje e keni shumë të rëndësishëm për përfundimet tuaja,
24 apo jo?

25 PË. Do më duhet të shoh çfarë kam thënë.

Dëshmitarja: Helen Fraser (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Hafetz

Faqe 126

1 PY. Mund ta vendosim në ekran.

2 PË. Po e kam këtu.

3 Z. HAFETZ: [Përkthim] Të shohim ju lutem raportin faqen
4 17. DHT1201286 deri në 1309.

5 PY. Është faqja 17, te pika 7.2.

6 Z. HAFETZ: [Përkthim] E shohim në ekran. Është në ekran
7 tani. Jam unë pak më mbrapa.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal,
9 dokumenti ka marrë një numër provizor prove me numër 1D00136.

10 Z. HAFETZ: [Përkthim] Më duhet thjesht për të bërë
11 pyetjen Profesores Fraser.

12 PY. Dr. Fraser, shohim në fund të faqes ku keni thënë
13 "Vlerësimi i nevojës për kontekst të jashtëm për të kuptuar
14 këtë audio".

15 PË. Po.

16 PY. Ky vlerësim, nevoja për kontekst të jashtëm është
17 themelor për konstatimin në raportin tuaj, apo jo?

18 PË. Po.

19 PY. Dhe paragrafi i parë në këtë pjesë thotë, meqenëse nuk
20 flas gjuhën dhe nuk kam qasje në përkthyes të aftë të gjuhës
21 shqipe keni vlerësuar padëshifrimin e audios apo paqartësinë e
22 audios duke e futur në një mjet apo instrument transkriptimi
23 të Inteligjencës Artificiale. Fjalja e parë që është themelore
24 për raportin tuaj fillon me përdorimin e *ChatGPT 5*, apo jo?

25 PË. Po.

1 PY. Në fund të këtij paragrafi keni thënë që:

2 "Ky është një proces që është bërë thjesht për të
3 vlerësuar shkallën e informacionit kontekstual që nevojitej
4 për të transkriptuar këtë audio."

5 PË. Po. Po. E kam komentuar dhe këtë bazuar në cilësinë e
6 audios më herët. Por pajtohem me atë që po thoni ju.

7 PY. Në shënimin përgatitor që është dorëzuar javën e kaluar,
8 që keni pasur javën e kaluar me Mbrojtjen --

9 PË. Po.

10 PY. -- ju keni thënë kur ju bënë pyetje për këtë temë, ju
11 thatë që vlerësimi juaj që sapo përmendët ishte i kufizuar për
12 shkak se nuk kishit në ekip shqiptarë?

13 PË. Po, e kam thënë dhe në raport.

14 PY. Shohim faqen 18.

15 PË. Po.

16 PY. Edhe një herë, përdorimi i *ChatGPT* 5 për këtë vlerësim,
17 që ju vetë nuk e bënit dot, ka qenë thelbësor për raportin
18 tuaj?

19 PË. Po.

20 PY. Prandaj po ju pyes cilin version apo versione të
21 programit keni përdorur?

22 PË. Versionin 5.

23 PY. Ju më thatë që për arsye personale apo për shkak të të
24 drejtave të autorit s'ma jepnit dot emrin e programit?

25 PË. Jo. Këtu nuk bëhet fjalë për një version tjetër të

1 *Whisper*. Janë programe që përdornin *Whisper* përmes *ChatGPT*.

2 PY. Po ju bëj një pyetje shumë të thjeshtë. Saktësisht si i
3 testuat këto pjesë të audios?

4 PË. Përdora programe që unë përdor në programet e mia në
5 kompjuterët e mi, shumë procese, jo vetëm këtë gjë, janë
6 programe që hyjnë në *ChatGPT* pa qenë nevoja që të fus unë
7 dosjet në *ChatGPT*.

8 PY. Që të kuptojmë cilësinë e këtij programi dhe çfarë është
9 në të vërtetë, për ne është e rëndësishme që të kuptojmë se si
10 është performanca e këtij apo rendimenti i këtij programi?

11 PË. Unë nuk e kam parë me hollësi. Unë thjesht doja të
12 kuptoja se çfarë bënte me audiot e qarta dhe me audiot e këtij
13 rasti.

14 PY. Do t'ju pyes edhe një herë atëherë, cilat programe apo
15 *software* keni përdorur?

16 PË. Ju garantoj që nuk kanë asnjë ndikim në faktin që kam
17 përdorur *ChatGPT*.

18 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Të kalojmë në seancë të
19 mbyllur, ju lutem.

20 DËSHMITARJA: [Përkthim] A duhet të largohem unë?

21 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Përdora termin e gabuar.

22 Jo, ju mund të qëndroni.

23 Do kalojmë në seancë private.

24 [Seancë private]

25 [Seancë private teksti i fshirë]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Helen Fraser (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Hafetz

Faqe 129

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Helen Fraser (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Hafetz

Faqe 130

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25 [Seancë e hapur]

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

2 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Profesore Freser,
3 përfunduat dëshminë tuaj vetëm për sot. Dhe duhet të vini
4 nesër paradite në orën 9.30. Ju lutem mos diskutoni me askënd
5 dëshminë tuaj. Shihemi nesër paradite.

6 DËSHMITARJA: [Përkthim] Faleminderit.

7 [Dëshmitarja përfundon dëshminë]

8 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ka ndonjë aspekt që duhet
9 të trajtojmë përpara se ta mbyllim ditën e sotme?

10 Në rregull. Faleminderit. Shihemi nesër në orën 9.30.

11 Seanca mbyllet këtu.

12 --- Seanca mbyllet në orën 16.01

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25